



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 4 TETOR 2021**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 04. OKTOBRA 2021. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR
2021**

Rendi i ditës

1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
2. Pyetjet parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-030 për ratifikimin e amendamentimit të Marrëveshjes së bashkëfinancimit për Projektin “Programi mbështetës për ujësjellës dhe kanalizim në zonat rurale faza (dalëse) VI”, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës,
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-031 për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit “Projekti Emergjent i Kosovës për COVID-19 - Financim shtesë”, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-029 për punimet nga metalet e çmuara,
8. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2021 - 2025,
9. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për zbatimin e fazës së dytë të prioritetëve politike të dakorduara ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës - Agjendës për Reforma Evropiane,
10. Shqyrtimi i raportit me rekomandime në lidhje me raportin e auditimit të performansës “Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave joqeveritare”,
11. Shqyrtimi i raportit me rekomandime në lidhje me raportin e auditimit të performansës “Parandalimi dhe reagimi i situatave emergjente: Vërshimet”,
12. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Ankesave të Mediave.

Dnevni red

1. Izjave van dnevnog reda,
2. Poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-030 amandamentiranje Sporazuma o sufinansiranju projekta “Program podrške za vodovod i kanalizaciju u ruralnim zonama faza (izlazna) VI, između Vlade Republike Kosovo i Vlade Švajcarske,
5. Razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-031 o ratifikaciji Sporazuma o finansiranju “Kosovski hitni projekat za COVID-19 - dodatno finansiranje” između Republike Kosovo i Međunarodnog Udruženja za Razvoj,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-003 o izmenama i dopunama Zakona br.06/L-057 o disciplinskoj odgovornosti sudija i tužilaca,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-029 o radovima od plemenitih metala,
8. Razmatranje Nacionalnog programa za sprovođenje Sporazuma o stabilizaciji i pridruživanju (NPSSSP) 2021 - 2025,
9. Razmatranje Akcionog plana za sprovođenje druge faze političkih prioriteta dogovorenih između Evropske unije i Republike Kosovo - Agenda za evropske reforme,
10. Pregled Izveštaja sa preporukama u vezi sa Izveštajem revizije učinka “Transparentnost i odgovornost u procesu finansiranja nevladinih organizacija”,
11. Razmatranje Izveštaja sa preporukama, u vezi sa Izveštajem revizije učinka “Sprečavanje i odgovor u vanrednim situacijama: Poplave”,
12. Formiranje ad hoc komisije za izbor kandidata za jednog (1) člana Borda za žalbe za medije.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Para se të fillojmë me pikat e rendit të ditës, ju njoftoj se me kërkesë të Kuvendit, presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Vjosa Osmani-Sadriu, ka nxjerrë Vendimin nr. 56/2021, të datës 21 shtator 2021, për zëvendësimin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës si në vijim:

Deputeti Hysen Berisha, kandidat nga Partia Demokratike e Kosovës, e zëvendëson ish-deputetin Uran Ismajli.

E ftoj deputetin Hysen Berisha ta bëjë betimin.

Mirë se erdhe, zoti Berisha!

Tekstin e betimit e keni para vetes, nëse po e shihni, për ta përmbushur këtë detyrim, e lus deputetin që të ngrihet në këmbë, ta dëgjojë tekstin që do ta lexoj dhe në fund, ju lutem, ta shqiptoni fjalën “Betohe!”.

“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane”. Betohe! Faleminderit!

E lus deputetin që ta nënshkruajë tekstin e Betimit.

1. Deklarimet jashtë rendit të ditës

Nga Lëvizja Vetëvendosje, fjalën e ka deputetja Fatmire Kollçaku.

FATMIRE KOLLÇAKU: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës.

Më 30 shtator 2021 në Bruksel u arrit marrëveshja, përmes së cilës Kosova arriti përfundimisht të vendosë principin e reciprocitetit në raport me Serbinë, edhe atë si raport i marrëdhënieve mes dy shteteve, tani më të pranuar edhe nga vetë Bashkimi Evropian, si palë ndërmjetësuese në dialog. Marrëveshja i sjell Kosovës disa përfitime.

Si fillim, që nga dita e djeshme më nuk ka barrikada në rrugët e Kosovës. Njësia Speciale e Policisë së Kosovës, pas 12 ditëve angazhim të shkëlqyer në mbrojtjen e vendkalimeve kufitare dhe stafit doganor e policor, mund t'u përkushtohet detyrave të tjera.

Veturat që hyjnë nga Serbia do të trajtohen në bazë të reciprocitetit të plotë, duke u vendosur afishe ngjitëse që mbulojnë elementet shtetërore të vendit që nuk e njohin.

Veturave që shkojnë nga Kosova në Serbi, me targa RKS, më nuk do të mund t'u kërkohet ndërrimi i targave të tyre, zëvendësimi me targa të përkohshme, po do të trajtohen njësoj si veturat e Serbisë, pra do të pajisen me afishe ngjitëse.

Për herë të parë veturat me targa të lëshuara në Serbi me shkurtesa të qyteteve të Kosovës do të trajtohen si targa të një shteti që nuk e njohin dhe do të detyrohen të pajisen me afishe ngjitëse.

Sa për rikujtim, në kohën e Qeverisë Mustafa, duke përjashtuar këto targa në marrëveshjen për afisheet të nënshkruar më 27 tetor 2015, kishte pranuar t'i legalizojë ato dhe t'i trajtojë si targa të rregullta të Kosovës. Me marrëveshjen e 30 shtatorit, kjo më nuk do të ndodhë.

Përmes krijimit të grupit punues që ka për detyrë gjetjen brenda gjashtë muajve të ardhshëm një zgjidhje përfundimtare për problemin e targave, sagës 10-vjeçare të maltretimit të qytetarëve tanë gjatë kalimit nëpër Serbi, përfundimisht do të mund t'i vijë fundi.

Sipas marrëveshjes, është detyrë e grupit punues që të dalë me një zgjidhje që përkon me standardet dhe praktikën e Bashkimit Evropian, me që nuk ka asnjë shtet në BE që aplikon afishe për vetura e vendeve të tjera, kjo nënkupton që zgjidhja përfundimtare do të jetë më e avancuar se kjo aktualja dhe, me që nuk ka asnjë shtet në BE që lëshon targa me denominimet të qyteteve të shteteve të tjera, përmes zgjidhjes përfundimtare nuk do të mund të ketë më targa të lëshuara ilegalisht në Serbi, e me denominimet e qyteteve të Republikës së Kosovës.

Duke u vendosur KFOR-i në vendkalimet kufitare, sigurohet ruajtja e sigurisë edhe atë nga partnerët më konstantë dhe më të fuqishëm të Republikës së Kosovës përgjatë 20 vjetëve të pasluftës.

Forcat e KFOR-it janë vendosur në vendkalimet kufitare mes Kosovës dhe Serbisë për të qartësuar edhe një herë që nuk do të lejohet asnjë provokim nga ana e politikës së papërgjegjshme e konfliktnxitëse të Beogradit.

Për ata që kanë pritur zgjidhjen e të gjitha problemeve mes Kosovës dhe Serbisë përmes kësaj marrëveshjeje, më duhet të them se kanë arsye të ndjehen mbase të zhgënjyer. Kjo marrëveshje as nuk është e as nuk pretendon të jetë historike, siç prezantohej secila marrëveshje e arritur deri

më tani në Serbi. Kjo marrëveshje as nuk e sjell e as nuk pretendon të sjellë njohjen de fakto nga Serbia, siç trumbetohej pas secilit kompromis të dhimbshëm në 23 marrëveshje paraprake. Kjo marrëveshje nuk është as nuk pretendon të jetë gjithëpërfshirëse, as nuk mund t'i shmangë të gjitha marrëveshjet e dëmshme të nënshkruara në qeveritë paraprake.

Ajo që kjo marrëveshje pretendon të ketë arritur është shtensionimi i situatës në vendkalimet kufitare Jarinjë e Bërnjak, largimin e barrikadave të organizuara, të dirigjuara nga Vuçiqi dhe mbajtjen e avancimin e principit të reciprocitetit.

Kjo marrëveshje ka vetëm një të metë, pra që është dashur të arrihej dhe të zbatohet shumë vjet më herët. Po, Kosova ka pasur të drejtë dhe ka mundur të kërkojë vendosjen e targave të përkohshme për veturat nga Serbia që në vitin 2011.

Kosova ka mundur dhe është dashur të fillojë vendosjen e afisheve që nga 15 shtatori i vitit 2016 dhe po, Kosova është dashur të trajtojë vetura me targa KM si targa ilegale që nga 15 shtatori i vitit 2016, por ja që nuk u bë.

Të nderuar deputetë,

Nëse edhe për ju është me rëndësi që Kosova të vazhdojë me përfaqësimin e suksesshëm në procesin e dialogut në Bruksel, atëherë do t'i bënit mirë vendit nëse vendimet do t'i mbështetnit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe pak sekonda, deri sa ta përfundojë fjalën e vet deputetja.

FATMIRE KOLLÇAKU: Pra, atëherë do t'i bënit mirë vendit nëse vendosni të mbështesni, jo të pengoni, angazhimin e vendit tonë në proces. T'u gëzoheni më shumë sukseseve, e të mos luteni për dështime, t'i gëzoheni bashkëpunimit dhe me miqtë ndërkombëtarë, në vend të thirrjeve për konfrontim me ta. Faleminderit!

KRYETARI: Tash fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot dy javë më parë Qeveria e Republikës së Kosovës vendosi reciprocitet në targa me Republikën e Serbisë.

Vendimi ky i pakonsultuar me askënd, as me ne si parti opozitare, as me miqtë tanë, partnerë tanë ndërkombëtarë dhe, në këtë rast me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe, megjithatë, ne si parti opozitare pa dyshim që vendosëm ta mbështesim.

Çdo vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës karshi Qeverisë së Republikës së Serbisë ne pa dyshim që e përkrahim, sepse mbi të gjitha, kur jemi përballë Serbisë, gjithmonë e kemi dërguar mesazhin se duhet të jemi të bashkuar.

Mirëpo çka ndodhi dy javë prapa, dy javë prapa jemi në një situatë krejt tjetër, në një situatë, të cilën nuk do ta kishte dëshiruar asnjë qytetar i Republikës së Kosovës.

Për dy dekada rresht Qeveria e Serbisë ka lëshuar tabela, targa ilegale për qytetarët serbë që jetojnë në Republikën e Kosovës. Asnjëherë nuk janë pranuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe tashmë kemi pas arritur në një përfundim që këto më të eliminohen të tëra. Dhe Qeveria jonë arriti të përfundojë në një marrëveshje jashtëzakonisht të dëmshme në Bruksel, marrëveshja kjo e parë e Qeverisë Kurti e arritur me Serbinë, marrëveshje e cila i legalizoi targat KM, PR, PZ, e të tjera që i lëshon Qeveria e Republikës së Serbisë për qytetarët e Kosovës.

Ju kujtohet para dy jave shou i kryeministrit me ato tabela që s'i zgjatën më shumë se dy javë, ku përfunduan sot, sot jemi me këto targa. Pra, këto targa lëshohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës për Kosovën, tashmë legale, tashmë Qeveria e Kosovës ka pranuar që këto targa të lëshohen për Kosovën.

Unë si qytetar i Kosovës, kur e regjistroj veturën dhe vendos targa, i paguaj tatim Qeverisë së Republikës së Kosovës, pra kush kujt i paguan tatim këta qytetarë të Kosovës që i marrin këto targa, kujt i paguajnë? Qeverisë së Republikës së Serbisë, ky është hapi i parë, ky është hapi i parë që keni filluar të implementoni Zajednicën me kompetenca ekzekutive. Ky është dëmi më i madh që i keni bërë Republikës së Kosovës. Për dy dekada nuk ka pasur marrëveshje më të dëmshme se sa kjo që sot e kemi dhe a e dini çka ka ndryshuar prej të kaluarës, është edhe stikers, se e keni pas filluar moti me ata stikersa diqysh t'i merrni 5 euro prej qytetarëve të Kosovës. Pra, këtu Vuçiqi në Serbi i merr 5 euro, edhe Albini, bashkë me ministrat e vet të Transportit i merr 5 euro që u vendosin stikersat këtyre veturave.

Pra, vërtet duhet të ndiheni të turpëruar, të gjithë ne, jo vetëm ju, sepse na ka turpëruar të gjithëve. Kjo marrëveshje është bërë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Prandaj, i kërkojmë kësaj Qeverie ta ndalë këtë të hov të dëmshëm, të cilën është duke e vazhduar, duke e dëmtuar subjektivitetin tonë ndërkombëtar.

Tashmë kjo Qeveri është shumë e lënduar përballë Vuçiqit, sepse Vuçiqi ka shënuar një fitore të madhe karshi nesh, ndërsa ne një humbje të madhe, fatkeqësisht, të cilën nuk do ta kishim dëshiruar.

Dhe e fundit, ajo që është më e dhembshmja, dje KFOR-i lëshon një komunikatë dhe thotë se në bazë të Rezolutës 1244 i merr në mbrojtje pikat kufitare. Është hera e parë prej shpalljes së pavarësisë së Kosovës që përmendet Rezoluta 1244. Pse? Si rezultat i asaj marrëveshjeje të dëmshme. Pra, nuk ka pasur marrëveshje që e ka dëmtuar më shumë subjektivitetin tonë ndërkombëtar. Kjo marrëveshje e cenon sovranitetin tonë shtetëror. Kjo marrëveshje tashmë e ka futur Serbinë brenda. Me këtë marrëveshje Republika e Serbisë lëshon targa për katër qytete në Republikën e Kosovës. A jeni të vetëdijshëm?

Pra, Republika e Serbisë lëshon targa për qytetarët e Republikës së Kosovës, për territorin tonë. Ne i kërkojmë kësaj Qeverie dhe këtyre ministrave të papërgjegjshëm dhe të padijshëm që të arrijnë ta ndalin dëmin që janë duke ia shkaktuar Republikës së Kosovës.

Siç po e shohim, shpresoj që mjetet demokratike të na mjaftojnë neve si opozitë për të ju ndalur, por po frikohem që jo. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe nëse bëni protesta, edhe ato duhet të jenë demokratike. Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Të nderuar kolegë deputetë,

Pas shout të para dy javësh, kur kryeministri i vendit doli në këtë foltore me pompozitet duke deklaruar aksionin në veri, rezultatet sot janë të dhembshme.

Më kujtohet kur i thashë kryeministrit se po bën shou dhe kur i thashë se veprimet e Policisë duhet të jenë institucionale dhe shtetërore, e jo politike e me agjenda zgjedhore dhe kur i thashë se duhet të jetë e përgatitur dhe e njoftuar Policia në kufi se duhet të zbatojë një urdhëresë shtetërore për t'i zbatuar ligjet e këtij vendi, deputetët këtu përballë bënin zhurmë dhe çaravesheshin. Sot, fatkeqësisht, mund të konstatoj se nga kolegët e mi deputetë mungon një numër kritik i njerëzve që mund të guxojnë të mendojnë dhe të deklarohen ndryshe në këtë Kuvend. Por, kjo është pak e rëndësishme, për të mos thënë aspak e rëndësishme, sepse kjo është gjendja në të cilën ju jeni.

Ajo që po shohim ne sot, kemi një marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Serbisë për tërheqjen e forcave policore të Kosovës nga veriu. Pse duhet Qeveria e Kosovës të bëjë marrëveshje për t'u tërhequr nga pjesë të territorit të vet? Është një pyetje legjitime. Problemi im më madhor që lind këtu është: Cila është strategjia e Qeverisë së Kosovës në raport me Serbinë?

Përderisa Qeveria paraprake ka pasur një plan-strategji në të cilën ka qenë orientimi strategjik, se me Serbinë nuk do të merremi vesh asgjë nëse nuk merremi vesh për çdo gjë dhe kjo “për çdo gjë” ka vetëm një qëllim - njohjen e pavarësisë së Republikës së Kosovës, Qeveria aktuale marrëveshjen e parë që e bën me Republikën e Serbisë është marrëveshja për pranimin e strukturave, targa ilegale, si targa zyrtare në Kosovë. Pra, për ta sqaruar pak më shumë, unë po e citoj zëvendëskryeministrin e Kosovës i ngarkuar me këto bisedime në Serbi, i cili një ditë para se të nënshkruhet marrëveshja thotë: “Ne kemi dakordim me për të gjitha pikat. E vetmja pikë ku pala serbe nuk e ka dhënë pëlqimin ka të bëjë me veturat KM, për të cilat ata mendojnë se nuk do të duhet të aplikoheshin stikersat. Ne mendojmë që kjo është absurde, sepse ato targa janë ilegale dhe nuk mund të nënshkruajmë marrëveshje që i favorizon ata”.

Tash, a mendon zëvendëskryeministri se këto targa janë ilegale apo legale, sepse e ka nënshkruar një marrëveshje në të cilën këto targa i njeh si targa të Serbisë dhe targa që identifikohen me territorin e Kosovës. Pra, KM është Kosovska Mitrovica, GL është Gjilani, PZ është Prizreni, e kështu me radhë.

Zoti zëvendëskryeministër, ju e keni nënshkruar një marrëveshje ku këto targa që lëshohen në territorin e Serbisë njihen si targa të Serbisë për territorin e Kosovës, pra e njihni legjitimitetin e institucioneve të Serbisë në territorin e Kosovës. Asnjë qeveri më parë nuk e ka bërë këtë punë, asnjë hiç, ju e keni bërë. Ky është rezultati i asaj që keni bërë, ky është rezultati i asaj euforie dhe sjelljeje të papjekur dhe të pakoordinuar.

Gjithsesi, ne si opozitë ju kemi thënë që në ditën e parë, se ne nuk do të sillemi si ju. Kur janë interesat shtetërore të vendit, ne do të sillemi si institucionalistë dhe do t'i mbrojmë interesat e vendit. Ne kemi vepruar me përgjegjësi institucionale duke e mbrojtur interesin e vendit dhe duke kërkuar që interesi i shtetit të mbrohet, por kjo çfarë keni bërë ju si rezultat i një sjelljeje euforike, të pakoordinuar mirë dhe të paplanifikuar, është humbje për Kosovën. Sot, Qeveria e Republikës së Serbisë lëshon zyrtarisht të pranuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës targa për Kosovën, për territorin e Kosovës. Çka është kjo? A është “Zajednica”? Çka është!?

Këtu ka nevojë të sqarohet çka është kjo, çka keni pranuar ju? Pra, i keni zyrtarizuar institucionet kriminele dhe paralele të Serbisë në Kosovë. Keni zyrtarizuar për herë të parë në Kosovë, keni nënshkruar një marrëveshje ku pranoni që Serbia të lëshojë dokumente për Kosovën. Jeni kthyer dhjetë vjet mbrapa, të paktën. Ju që keni hedhur gaz lotsjellës këtu, ju që keni ushtruar dhunë në këtë Kuvend për marrëveshje, e cila ka qenë shumë më e mirë sesa kjo që e keni nënshkruar ju pas dhjetë vjetësh, sepse ajo marrëveshje i ka trajtuar si ilegale këto targa. Ndërsa, ju sot i pranoni si targa të lëshuara nga Qeveria e Republikës së Serbisë për Qeverinë e Republikës së Kosovës, për territorin e Republikës së Kosovës. Ky është një krim që ju e keni bërë.

KRYETARI: Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Bekë Berisha.

BEKË BERISHA: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ne posa kemi dëgjuar për këtë operacion, duke menduar që është me të vërtetë në të mirë të Kosovës, menjëherë kemi dalë në përkrahje të Policisë së Kosovës, shtetit të Kosovës, të Kosovës. Dhe, çfarë doli nga kjo? Serbia ka dalë nga kjo situatë shumë mirë, sepse për një koncesion nëse herën e parë ka marrë privilegje të tjera, tash për të njëjtin koncesion të moçëm po merr koncesione të reja. Serbia u tregua në sy të BE-së si faktor i ruajtjes së paqes pa dhënë asnjë gjë, e tash topi është në anën e Kosovës për koncesion. Në këtë kontest janë riaktivizuar çështja e asociacionit, mungesa e çelësit etnik në rastin e dënimit të ish-ministrit serb për çështjen e Reçakut dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese për implementimin e vendimit gjyqësor në pronat e Kishës së Deçanit.

Serbia e mati pulsën e një intervenimi të mundshëm ushtarak në komunat veriore të Kosovës. Serbia ua bëri me dije, edhe NATO-s, edhe çdokujt, se një intervenim i ri i njësisve speciale në Kosovës do të ketë kundërpërgjigje. Po ashtu, janë riorganizuar strukturat paralele dhe do të marrin veprime shumë më të koordinuara, sepse ndihen fituese dhe është ngritur besimi i tyre ndaj Vuçiqit.

Kosova mund ta konsiderojë fitore të Pirros implementimin e Marrëveshjes së 2015-tës, sepse e ka fjalën “reciprocitet” në të dhe kjo i duhet Albin Kurtit për zgjedhje lokale. Kosova e ka fituar një përkrahje të butë dhe të vonshme publike nga Eskobar se Kosova ka të drejtë në reciprocitet në targa. Kosova e ka thëlluar besimin e BE-së, e posaçërisht të SHBA-ve, se ne jemi partner i paparashikueshëm dhe i pabesueshëm. Është e paqartë se çfarë ka ndodhur me targat tjera, RKS, KM, PR, PZ, e tjera. Mbi të gjitha, Njësia Speciale e Kosovës pa fajin e saj është humbësi më i madh në këtë tregim, sepse misioni për të cilin janë dërguar atje ka dështuar në tërësi. Së pari është ekspozuar në tërësi potenciali i saj, kanë duruar fyerje dhe poshtërim verbal si asnjëherë më parë dhe kjo e dobëson në masë të madhe ndikimin e saj dhe frikën si mekanizëm ligjor i forcës.

Sikur të ishte kryeministri këtu, por s’po i bëj pyetje këtij, Policia Speciale a ka nevojë për leje nga KFOR-i për të shkuar në veri apo jo? Tani, pas fitores a shkon Policia e Kosovës në veri sa herë që ka nevojë që të zbatohet ligji? Dhe, a ka operacione të tjera më shpejt? Faleminderit!

KRYETARI: Tash, nga Grupi Multietnik e ka fjalën kryetari i këtij grupi, Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar!

Çok değerli vatandaşlar, veliler ve sevgili öğrenciler

Ertelenmelerin ardından geçen hafta yeni eğitim-öğretim yılımız başlamış oldu.

Eğitim-öğretim yılına başlarken, geleceğimizin teminatı çocuklarımızın, onlara en iyi imkanları sağlamaya çalışan ailelerin ve büyük fedakarlıklarla Kosovanın her köşesinde hizmet veren öğretmenlerimizin heyecanını ve coşkusunu yürekten paylaştığımı belirtmek isterim.

Ancak eğitim-öğretim yılının Kosovada yaşayan her topluluk için eşit şartlarda başlamaması bizleri derinden üzmektedir. Bugün Prizren, Mamuşa, Priştine, Gilan-Dobriçan ve Mitroviçada Türkçe eğitim görülen okullarda çocuklarımızı okul sıralarında Türkçe kitaplar maalesef karşılamadı. Eğitim Yasamız tüm çocukların eşit şekilde eğitimine hak tanısa da, bugün Türkçe okuyan çocuklarımızın kitap sorunu devam etmektedir.

Yeni müfredata göre, onca girişimimize rağmen maalesef tek bir kitap basılmadı. Fakat çocuklarımızın kitapsız kalmamaları için geçici süreliğine eski müfredata göre var olan kitaplarımızın dağıtımını gerekmektedir.

Geçen hafta çocuklarımıza Türkçe olarak birinci-beşinci sınıf öğrencilerimiz için sadece kimi ana ders kitapları dağıtımını gerçekleştirmiş ve bunlarda tüm öğrenci sayısına göre yetersizdir. Öğrencilerimizin çoğu yine kitapsızdır. Altıncı-dokuzuncu sınıflar için her neredeyse hiçbir kitap dağıtımını gerçekleştirilmemiştir.

Bütün bu eksiklikleri gözönünde bulundurarak, Eğitim Bakanından derhal bu konuda hızlı bir şekilde gerekeni yapmaya davet ediyorum. Teşekkür ederim!

KRYETARI: Nga Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes, fjalën e ka deputeti Ardian Gola.

ARDIAN GOLA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës, e veçanërisht fëmijë, nxënës, prindër dhe mësues, Tashmë kemi hyrë në javën e dytë të procesit mësimor, në vitin e ri shkollor. Ishte një vonesë pothuajse njëmuajore, por duket se vonesa ka qenë sa e arsyetuar mirë, aq edhe e arsyeshme, për shkak se fillimi i procesit po reflekton edhe gjendjen pandemike, me ç'rast kemi të bëjmë me rënie drastike të numrit të infeksioneve, e po ashtu edhe rasteve me fatalitet. Përjashtimisht shkollave kontestuese që i kemi si një ngërç institucional në komunën e Kamenicës dhe një shkolle në Rahovec, që është në ndërtim e sipër si shkollë e re, në të gjitha shkollat tjera të Kosovës tashmë procesi mësimor ka filluar.

Sido që të jetë, sado që duket se është një fillim i mbarë, me skenar të kombinuar, A, B dhe C, pandemia tashmë e ka dëshmuar se di të jetë goxha e paparashikueshme me valët e infeksionit, andaj Qeveria duhet të jetë maksimalisht e përgatitur, sidomos me modelet e mësimin online, ashtu që të bëhet e pamundura për të mundësuar një proces aq sa është e mundur në rrethana pandemike. Një proces mësimor është fjala.

Nga këtu, unë do ta lus edhe kryetarin e Komunës që të përpiqet maksimalisht, që në bashkëpunim me prindërit dhe aty ku ministria mund të ushtrojë autoritetin ligjor të saj, ta bëjnë të pamundurën që ta zgjidhin këtë ngërç institucional, ashtu që fëmijët të mos pësojnë prapë nga

mungesa e mësim. Unë uroj që ky vit shkollor të jetë një vit i mbarë, suksese dhe qoftë një vit i suksesshëm edhe efektiv për të gjithë mësuesit, prindërit dhe nxënësit. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Partia Demokratike fjalën e ka deputeti Ferat Shala.

FERAT SHALA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Fjalimin tim do ta orientoj te një vendim i pazakontë, i veçantë, me pasoja të mëdha jo vetëm politike, por edhe ekonomike. Është çështja e projektit dhe e vendimit të Qeverisë për të anuluar apo për të shtyrë çështjen e projektit të gazsjellësit të MCC-së.

Nga ajo që kemi parë, kemi një mungesë të madhe të informacionit që Qeveria për këtë projekt na jep. Krejt çka dimë dhe çka shohim nga institucionet e qeverisë dhe nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik është që nuk kemi informacion. Si ka mundësi që një qeveri e tërë, me gjashtë muaj jetë parlamentare dhe qeveritare, nuk ka informacion për projektin më kapital strategjik të energjisë në Kosovë, që ka filluar tash e disa vjet nga një agjenci shtetërore amerikane, MCC. Si ka mundësi që Qeveria nuk paska ekspertë, grupe të interesit që ta vendosin në prioritet këtë projekt dhe të na japë një informacion bazë, mbi cilën arsyeje e ka anuluar këtë projekt.

Projektet ekonomike janë të matshme, të njohura, janë të qasshme, kanë kosto, kanë kritere dhe standarde. Cilat janë arsyet që Qeveria e ka anuluar këtë projekt, asnjë informacion nuk e kemi zyrtar. Pse nuk kemi informacion? Kush duhet të komunikonte me institucionet e MCC-së për të pasur një informacion të nevojshëm sot? Qeveria është defenitivisht e paaftë, apo ka marrë një vendim politik, të cilin duhet edhe atë të na sqarojë. Nëse është vendim politik për t'u hapur hapësira tregjeve të tjera energjetike dhe për të krijuar linja të tjera të gazsjellësit verior, jo nga jugu, por nga veriu, edhe këtë duhet ta bëjë transparente, e ka obligim kushtetues që të jetë transparent veçanërisht për sektorët ekonomikë. Nëse nuk është transparent për sektorët e sigurisë, siç ishte rasti në ditët që shkuan.

Pra, a mund të na thotë qeveria cilat janë 3-4 arsye, të cilat ka ardhur në përfundim për ta refuzuar një gazsjellës amerikan të financuar dhe mbështetur nga MCC-ja. Pra, a është arsyeja ekonomike, politike, sociale, apo mjedisore. Asnjë sqarim nuk e kemi dhe, për më keq, ne e dimë gjendjen e sektorit të energjisë që në Kosovë kur në të njëjtën kohë ne importojmë qindra milionë euro nga kompanitë energjetike sllave. Në të njëjtën kohë ne e mbyllim një arterie të rëndësishme ekonomike të zhvillimit të vendit, duke i thënë jo një projekti të MCC-së që vjen nga pjesa jugore. Unë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Më lejoni të potencoj një fakt, i cili përkundër gjendjes së vështirë pandemike, të cilën e ka kaluar Kosova dy vjetët e fundit dhe po kalon, por ngritjen edhe të vigjilencës së vazhdueshme që duhet ta kemi sa i përket ruajtjes dhe mbajtjes në jetë të sa më shumë njerëzve nga ky virus i tmerrshëm.

Ne jemi në muajin e sensibilizimit që ka të bëjë me luftën kundër kancerit të gjirit. Vitin e kaluar, në fund të vitit është miratuar një rezolutë, e cila e ka obliguar Qeverinë e Republikës së Kosovës që të përmbushë disa specifika, të cilat fillojnë nga identifikimi dhe parandalimi i hershëm, por edhe ngritja e kapaciteteve të domosdoshme dhe të nevojshme që motrat dhe nënat tona në Kosovë të ndihmohen në aspektin shëndetësor. Numri i personelit në Onkologji mendoj që është i pamjaftueshëm dhe qeveria duhet ta ketë në vëmendje, sidomos tash kur të fillojë edhe hartimi apo draftimi i buxhetit për vitin e ardhshëm, sepse nuk e kemi dëgjuar këto ditë fare një qasje produktive, ta quaj, sa i përket kësaj sëmundje të vështirë. Është thënë dhe është kërkuar që duhet të kemi mamograf për të gjitha qendrat e mjekësisë familjare dhe do ta ngremë këtë çështje dhe si deputetë të kësaj legjislature, njëherësh të sigurohen edhe medikamente për trajtim të kancerit të gjirit dhe ajo që është tepër e domosdoshme, sigurimi i protezave për shumë nga ato nëna dhe motra, të cilat nuk mund t'i sigurojnë.

Esenca mbetet gjithmonë te edukimi dhe identifikimi i hershëm, nuk po e dëgjojmë dhe duhet një bashkëpunim edhe me shoqëritë, organizatat që merren me këtë temë, por mbi të gjitha ka të bëjë me sensitivitetin që ka shoqëria jonë dhe absolutisht Kuvendit duhet ta luajë rolin e rëndësishëm që ka. Unë thërras Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ministrinë e Shëndetësisë, Kryeministrin që ta trajtojë në mënyrë të veçantë këtë pjesë, por besoj që edhe deputetët, sidomos këta që merren me pjesën buxhetore që kjo rezolutë ta gjejë implementimin e saj jo vetëm në këtë muaj, si muaj i ndërgjegjësimit, por si diçka e domosdoshme për t'i ndihmuar shoqërisë tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetit të fundit për këtë pjesë, i cili e merr fjalën, para se të kalojmë te anëtarët e Qeverisë, që po ashtu kanë dashur që të diskutojnë, është nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj.

RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Qeveria Kurti ka marrë dy vendime të dëmshme, të rrezikshme për Kosovën, njëra njihet si marrëveshja për targa. Dëmet e saj do t'i përjetojmë dhe do të përballemi me to në të ardhmen dhe tjetri vendim është refuzimi i projektit të gazit. Duke e refuzuar projektin e gazit, Qeveria Kurti, përveç që u ka thënë 'jo' Shteteve të Bashkuara të Amerikës, u ka thënë 'jo' edhe

partnerëve të tjerë, siç është BERZH-i, të cilët aktualisht janë duke punuar në master planin e gazit të Kosovës.

MCC ka shpenzuar tre vjet dhe mbi 10 milionë dollarë në studime të ndryshme të fizibilitetit të gazit. Për këto studime MCC gjithashtu angazhoi inxhinierë të ushtrisë amerikane, së bashku me kompani të tjera kontraktuese dhe, të gjithë këtyre ekspertët e mëdhenj të Qeverisë Kurti u thanë “jo”, këta u thanë “jo” edhe inxhinierëve të ushtrisë amerikane, u thanë se studimet tuaja nuk janë bindëse. Pra, Kurti po u thotë “jo” 200 milionëve amerikanë, të alokuar nga Presidenti Biden për Kosovë në maj të këtij viti, për të cilin lajm Qeveria Kurti nuk e tha asnjë fjalë të vetme, as nuk u lodhën për të mirëpritur kërkesën e Presidentit Biden. Kurti po i thotë “jo” një projekti gjeostrategjik për vendin që do të hapte rrugën për aleanca të re dhe të rëndësishme për vendin. Kurti po i thotë projektit amerikan ‘projekt rus’, pra mbi të gjitha, aspekti më shqetësues është njollosja e projektit nga kjo qeveri. Kurti përmes zëvendëskryeministrit, përveç se i tha ‘jo’ Amerikës, i parapriu vendimit për refuzim dhe e njollosoi duke e cilësuar projektin e gazit pra si rus përmes zëvendësit të tij, Bislimi.

Pra, të nderuar, ky qëndrim dhe refuzim i Qeverisë është shumë shqetësues dhe si kurrë më parë Kurti lëkund i miqësinë tonë me Amerikën, lëkundje që do të ketë pasoja për vendin. Prandaj, thirrja për dorëheqje e kësaj qeverie është legjitime dhe njëkohësisht para dorëheqjes ta rikthejnë vendimin për gazin. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën nga Qeveria e ka zëvendëskryeministri Besnik Bislimi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BESNIK BISLIMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeverisës,

Të nderuar deputetë dhe qytetarë të Kosovës,

Para se fillimisht të jap komentet e mia në lidhje me disa deklaratatë të pavërteta dhe tendencioze në lidhje me marrëveshjen e datës 30 shtator, më lejoni që fillimisht të falënderoj thellë Njësinë Speciale të Policisë së Kosovës për punën e shkëlqyer që kanë bërë për 12 ditë radhazi në mbrojtjen e vendkalimeve kufitare, në Jarinjë dhe Bërnjak, dhe në mbrojtjen e stafit doganor dhe policor atje.

Aftësia e tyre për t’i kryer detyrat me përgjegjshmëri të plotë, pa rënë në provokimet e vazhdueshme të huliganëve nëpër barrikada, meritojnë çdo lëvdatë dhe kjo më është thënë edhe nga vetë eksponentë politikë në Bruksel.

Tre diskutantë u morën më intensivisht me marrëveshjen dhe secili prej tyre përhap i pavërteta dhe shpifje rreth saj. Po filloj me diskutantin e parë, i cili tha që vendimi për reciprocitetin i datës 20 shtator ishte i pakonsultuar as me opozitën, e as me bashkësinë ndërkombëtare. Ky vendim i është komunikuar si bashkësisë ndërkombëtare, ashtu edhe opinionit vendor që më 9 shtator

2021, do të thotë 12 ditë para fillimit të zbatimit të tij, domethënë deri më sot nuk e kam ditur që Ministria e Punëve të Brendshme duhet të konsultohet me kryetarin e Grupit Parlamentar të PDK-së para se të marrë ndonjë vendim operativ.

Diskutanti i parë po ashtu tha se për dy dekada Serbia ka lëshuar targa ilegale dhe nuk janë pranuar kurrë nga Kosova. Kjo është gjysmë e vërtetë. E vërteta është, se po për dy dekada kanë lëshuar targa ilegale, por e pavërtetë është që nuk janë pranuar nga Kosova. Ato janë pranuar, janë toleruar, janë lejuar dhe ato janë parkuar edhe para ndërtesës së Qeverisë për vite me radhë dhe sa për informimin tuaj, ja çka shkruan në marrëveshjen e datës 27 tetor 2015 në kohën e qeverisjes së zotit Isa Mustafa. Në këtë marrëveshje, ku operacionalizohet liria e lëvizjes, në pikën e katërt thotë, ka të bëjë për çështjen e stikersave thotë: “Kjo nuk do të aplikohet për qytetarët e Kosovës që mbajnë targa të Serbisë me denominimet regjionale të Kosovës”.

Do të thotë, kjo marrëveshje targat KM i ka trajtuar si targa të Kosovës. Kjo zhurmë është argumenti i vetëm intelektual i juaji sot. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, çka është futur nga Serbia në Kosovë është dashur të pajisjet me afişe, por jo edhe targat me KM, sepse ato qeveria i ka trajtuar si targa të Kosovës, do të thotë targa të Republikës së Kosovës. Për herë të parë kjo marrëveshje këto targa i trajton si targa ilegale, targa të një shteti që ne nuk e njohim dhe rrjedhimisht i mbulojmë me stikers. Këto targa nuk mbulohej me stikers në Serbi, por në Kosovë dhe është për një marrëveshje gjashtëmujore.

Diskutanti i parë po ashtu tha, kujt i paguajnë tatim këta qytetarë me këto targa? I paguajnë Serbisë, ashtu është, për atë arsye i trajtojmë si targa ilegale dhe në Kosovë pajisjen me stikers. Diskutanti i parë po ashtu tha si vijon, po më pëlqen shumë zhurma juaj, nuk ka pasur tha marrëveshje...

KRYETARI: Ju lutem qetësi! Mbajeni qetësinë!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BESNIK BISLIMI: Kjo marrëveshje u cilësua edhe si më e dëmshme se marrëveshja e Zajednicës, më e dëmshme se marrëveshja për energjinë, se marrëveshja për drejtësinë, se bisedimet për ndarje të Kosovës.

Një e vërtetë e madhe është në këto marrëveshje, kjo marrëveshje është krejt ndryshe prej marrëveshjeve paraprake. Ata, të cilët marrëveshjet paraprake i shohin si të mira, nuk kanë se si ta shohin këtë marrëveshje si jo të keqe. Ata, të cilët marrëveshjet paraprake i shohin si të këqija, nuk kanë se si të mos e shohin këtë marrëveshje si të mirë. Prandaj, ju jeni përcaktuar.

Një e pavërtetë tjetër që u tha nga personi, i cili detyrë shtëpie e ka të shpërndajë të pavërteta, tha se ju merrni pesë euro për vendosjen e stikersave. Gënjeshtër e kulluar, i nderuar diskutant, stikersat janë pa pagesë dhe këtë e keni ditur... *(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Shtojani edhe një minutë zëvendëskryeministrit derisa të përmbyllë fjalën e tij.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BESNIK BISLIMI: Shkojmë te diskutanti i dytë, i cili tha: Zoti Kurti po bën shou me këtë marrëveshje. Unë pajtohem që ju reciprocitetin e shihni si shou. Po të mos kishte qenë shou do ta kishit bërë edhe më herët. Po ju thellë në vete me të vërtetë besoni se Kosova nuk është dhe nuk duhet të ndihet si e barabartë në raport me Serbinë. Kjo juve ju gërryen shumë, nuk ju lejon as të merrni frymë.

Ju thatë: Sot Serbia lëshon targa me denominime të qyteteve të Kosovës. Jo, i nderuar, Serbia lëshon targa me denominime të Kosovës që nga viti 1999. Jo, për herë të parë ato trajtohen si targa ilegale.

Diskutanti i tretë tha si vijon: Kosova e filloi implementimin e marrëveshjes së vitit 2016. Është e pavërtetë, i nderuar. Kjo marrëveshje...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zëvendëskryeministër, të vazhdojmë me deputetët e tjerë, pastaj do të keni rastin po ashtu edhe minuta shtesë për t'iu përgjigjur secilit. Po, faleminderit!

Tash janë lajmëruar disa deputetë që u ka mbetur fjala nga më herët. Nuk po i thërras ata nëse nuk e kanë fjalën për këtë temë. Kështu që vazhdojmë atëherë me Xhavit Halitin.

XHAVIT HALITI: Faleminderit!

Unë i përshëndes edhe zhurmashinjtë, edhe ata që kanë për qëllim të dezinformojnë, por unë kam pritur që vërtet sot ose në ditë të radhës ta kemi një raportim serioz se çfarë ka ndodhur, të shpjegohen edhe detajet e takimeve në Bruksel, cilat janë problemet që kanë dalë në këto takime dhe çfarë duhet të bëjmë, qoftë së bashku për interesat e vendit, qoftë veç e veç.

Mendoj që kjo formë e komunikimit të zëvendëskryeministrit me deputetë, duke refuzuar dhe vetëm duke kundërshtuar deputetë të cilët janë të shqetësuar për këtë situatë që e kemi ose për marrëveshjen që e keni bërë, mua nuk më jep të kuptoj diçka serioze kur thotë: ti po gënjen, ti s'ë ke vërtet, ju keni tradhtuar, ju keni bërë këtë, jo atë. Ne këto gjëra i kemi dëgjuar edhe më herët nga Vetëvendosje. Ne kemi interes si vend, si qytetarë të Kosovës, si deputetë që ta marrim vesh të vërtetën e kësaj marrëveshje dhe çfarë duhet të bëjmë më tutje. Unë e di që e keni lënë gjashtë muaj, pas gjashtë muajsh të përfundojë kjo, ose të arrihet marrëveshje përfundimtare, por po ju them sinqerisht që detyrimi i Qeverisë do të ishte më i madh ose mbështetja e Qeverisë do të ishte më e madhe në qoftë se para se të shkojmë në Bruksel, të bisedojmë vetë me veten...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zgjatjani fjalën edhe pak derisa ta përfundojë z. Haliti.

XHAVIT HALITI: Para se ta shajmë njëri-tjetrin ose ta kritikojmë, ta gjejmë ndonjë mundësi për të komunikuar dhe për t'i hapur letrat. Unë e di se Qeveria nuk mund t'i thotë të gjitha. Unë e kam të qartë. Ne kemi marrë pjesë që njëzet vjet në bisedime edhe me Serbinë, e edhe me bashkësinë ndërkombëtare. Por, një mekanizëm që funksionon bashkë është mirë të krijohet dhe të shkojnë të përgatitur dhe besoj që fushatat në raportet Kosovë - Serbi nuk duhet të jenë evidente në sallën e Parlamentit në këto nivele që po e dëgjoj edhe zëvendëskryeministrin, por edhe neve që s'po mund ta dëgjojmë çka po thotë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën tash e ka Abelard Tahiri nga Partia Demokratike.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Në radhë të parë, nëse kryeministri do ta kishte respektuar këtë Kuvend dhe rezolutën që e ka miratuar, pas kësaj marrëveshje do të duhej ta thërriste një seancë ku do të duhej të raportonte pikërisht për këtë marrëveshje që u arrit në Bruksel. Është hera e parë që ne Qeveria jonë dhe delegacioni i Republikës së Kosovës bien pre e këtij presioni kaq të madh dhe brenda një periudhe 12-13-orëshe arrin ta pranojë një marrëveshje shumë të dëmshme qysh është kjo për legalizimin e targave serbe që lëshohen për Republikën e Kosovës. Pra, asnjëherë në asnjë marrëveshje këto targa nuk janë pranuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Është zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, i cili me nënshkrimin e tij ia mundësoi Serbisë të lëshojë targa PR, PZ, GL, UR etj. për Republikën e Kosovës.

Pra, kjo është hera e parë dhe kjo ka qenë kërkesë e kamotshme prej dy dekadave e Serbisë që Kosova të pranojë një gjë të tillë. Atyre u intereson të vijnë deri te ura e Ibrit. Nuk u intereson as Vushtrria, as Skenderaj, as Mitrovica, as Prishtina. Atyre u intereson veriu dhe ata e kanë bërë një hap të madh. Ata e kanë bërë një hap që neve na ka dëmtuar shumë. Ata e kanë bërë një hap që pozicionin tonë e kanë dobësuar. Prandaj, mendoj që pozicioni i këtij personi që e kemi zëvendëskryeministër duhet rishqyrtuar. Unë mendoj që nëse kryeministri do t'i bëjë një favor këtij vendi, këtë mund ta lë zëvendëskryeministër, po duhet ta tërheqë prej bisedimeve me Serbinë, sepse e ka bërë një dëm të madh. Dhe sot nuk po na thotë kurrgjë ndryshe, pos del dhe na ofendon në foltore. Flet të pavërteta, flet kështu, flet ashtu.

Prandaj, sot nuk thotë kurrgjë të kundërtën prej asaj që themi ne, sot del na ofendon.

Prandaj dëmi që i ka shkaktuar ky njeri vendit me pranimin e këtyre targave do të jetë i madh dhe me pasoja të mëdha. Faleminderit!

KRYETARI: Një kundër-replikë nga zëvendëskryeministri fillimisht.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BISLIM BISLIMI: Faleminderit!

Fillimisht për z. Haliti, pajtohem plotësisht me fjalimin tuaj. Edhe mendoj që kjo gjuhë do të duhej të ishte gjuha e komunikimit sikur të tre diskutuesit e parë të mos kishin pasur këtë fokus: “marrëveshja është më e dëmshme prej të gjitha marrëveshjeve të mëparshme, Serbia është futur me të dyja këmbët në Kosovë, janë legalizuar tabelat, hera e parë që janë legalizuar tabelat”.

Sikur në këto diskutime unë të kisha gjetur vetëm një fjalë të vetme të reflektimit dhe të dëshirës për bashkëpunim, krejt ndryshe do të ishte edhe diskutimi ynë, po nuk pashë asnjë pikë brengje në fjalime. Pashë vetëm tendencë për manipulim të foltores.

Sa i përket diskutuesit paraparak, arsyeja pse marrëveshja nuk është nënshkruar më 30 shtator, por është nënshkruar më 1 tetor ka qenë vetëm refuzimi i palës serbe që të pajtohet.

KRYETARI: Zoti zëvendëskryeministër dhe të tjerët e Qeverisë atje lart është ora me sekonda dhe mund ta kontrolloni shumë më mirë kohën tuaj nëse doni të jepni përgjigje më koncize.

Tash nga Lidhja Demokratike e Kosovës, fjalën e ka kryetari i Grupit, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit i nderuar kryetar i Kuvendit!

Më vjen keq për gjuhën që e përdor zëvendëskryeministri, po i drejtohem me titull zëvendëskryeministër, duke iu drejtuar deputetëve si “diskutantë”. Është zgjedhje e tij, në rregull është. Kjo është gjuha që ky ka vendosur në komunikojë me Kuvendin.

Unë i kam disa çështje. E para, çështja që ka të bëjë me targat ilegale KM, PZ, GL etj. në Marrëveshjen e 2015-tës janë konsideruar ilegale dhe është dashur të hiqen dhe nuk kanë pranuar që të diskutohet për to. Ky është dallimi.

Unë pata një pyetje konkrete për zëvendëskryeministrin, të cilën po ia ripërsëris. Ne kemi dakordim për të gjitha pikat. E vetmja pikë ku pala serbe nuk e ka dhënë pëlqimin ka të bëjë me veturat KM, në të cilat ata mendojnë që nuk do të duhej të aplikoheshin stikersat. Ne mendojmë që kjo është absurde, sepse ato tabela janë ilegale dhe nuk mund të nënshkruajmë marrëveshje që i favorizon. A janë këto targa ilegale, apo nuk janë ilegale? Nëse këto targa janë ilegale, qysh mund të hyjnë zyrtarisht në kufij të Kosovës?

Pra, nëse janë ilegale, duke nënshkruar marrëveshje me Qeverinë e Serbisë, i ke legalizuar. Pra, e ke legalizuar autoritetin e Qeverisë së Serbisë mbi territorin e Kosovës. Ky është problemi. Ato, është e vërtetë që janë sjellë nëpër Kosovë ilegalisht, sidomos në tri komunat në veri. Zotëri, ti po i quan ilegale, ndërkohë që ke nënshkruar marrëveshje me Qeverinë e Serbisë për t'i pranuar e legalizuar, sepse nëse është ilegale nuk mund të hyjë në kufi. E ke legalizuar autoritetin e Qeverisë së Serbisë në territorin e Kosovës, duke lëshuar targa për automjete për qytetarët e

Kosovës. Ky është problemi të cilin e ke thënë ti vetë me fjalë tuaja dhe sot me ofendime po kujton që na bën nervoz. Gabime e ke!

KRYETARI: Zëvendëskryeministri e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BISLIM BISLIMI: Për t'u dhënë fund të gjitha manipulimeve të pasinqerta që po i bëni me marrëveshjen, po e lexoj në tërësi. A po do ta demantoj manipulimin, apo s'po do? Dëgjoje!

Dy palët u dakorduan në pikat e mëposhtme:

1. Njësia e Policisë Speciale e vendosur për momentin në pikat kufitare Jarinjë dhe Bërnjak do të zhvendoset.

Veç dëgjo tash! Unë të dëgjova me kujdes, vetëm mbylle dhe dëgjo!

Do të zhvendosen njëkohësisht me barrikatat rrugore, duke filluar më 2 tetor 2021 në orën 8:00 dhe duke përfunduar para orës 16:00. KFOR-i do të vendoset në pikat kufitare Jarinjë dhe Bërnjak para fillimit të zhvendosjes së njëkohshme dhe do të qëndrojë aty afërsisht dy javë për të siguruar një ambient të sigurt dhe lirinë e lëvizjes.

2. Më 4 tetor 2021...

KRYETARI: Po urdhëroni edhe një minutë derisa ta përfundojë marrëveshjen zëvendëskryeministri.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BISLIM BISLIMI: Më 4 tetor 2021, në orën 8:00 do të aplikohet regjimi i afisheve sipas dakordimit në kornizën e dialogut të mbështetur nga BE dhe atë si masë e përkohshme deri në dakordimin për zgjidhjen e përhershme.

3. Do të themelohet një grup punues, i përbërë nga përfaqësuesit e BE-së, Beogradit dhe Prishtinës dhe do të udhëhiqet nga BE-ja, me qëllim të gjetjes së zgjidhjes së përhershme të çështjes së targave të veturave, bazuar në skandalet dhe praktikën e Bashkimit Evropian. Takimi i parë i Grupit punues do të mbahet në Bruksel, më 21 tetor 2021. Brenda gjashtë muajve nga data e mbajtjes së takimit të parë, grupi punues do të prezantojë formatin në nivel të lartë të dialogut gjetjet e tij mbi zgjidhjen e përhershme.

Ku përmendët tabelat KM... Po për atë që ne s'kemi pranuar të diskutojmë se kemi thënë se janë ilegale. Në marrëveshjet e juaja gjithkund thuhet status special për targat KM.

KRYETARI: Tash fjalën e ka deputeti Haki Abazi nga Vetëvendosja.

HAKI ABAZI: Faleminderit, kryetar!

Është paradoksale kjo ideja të paraqitesh në publik e në televizion sikur vërtet ka interes për diskutim serioz për marrëveshjen, ndërsa këtu në sallë bëhet zhurmë pikërisht për të mos lejuar debatin dhe të dëgjohen argumentet dhe përmbajtja e marrëveshjes.

Arsyeja pse e mora fjalën është t'u kujtoj deputetëve të opozitës që tentimet dhe fabrikimet e kanë sjellë Serbinë në dialog, edhe në pozitën për të krijuar kushte për njëzet vjet. A ju kujtohet tentimi i parë kur është vrarë polici Enver Zymberi, të cilin po hezitojnë ta përmendin kolegët deputetë, po janë pikërisht fazat kur Serbia ka ndërtuar pozicion në dialog kundër interesit të Kosovës.

Tjetra që duhet kujtuar deputetëve kolegë, është që sot po mbulohet shenja me katër S-të e Serbisë. Nuk po i vihet fusnota Kosovës ku është përmendur 1244 për të cilën po thuhet që asnjëherë nuk është përmendur deri tani. Në fakt, dialogun që e kanë ndërtuar në të kaluarën, ka bërë që 1244-ta të kthehet në fusnotë në emërtimin e Kosovës kur është fjala për raportin. D.m.th. të bëhemi seriozë që qytetarët ta kuptojnë të vërtetën që më nuk është Serbia ajo që flet për atë se çfarë duhet të japë Kosova, po dialogu është kthyer në problematikat, të cilat Serbia në mënyrë të vazhdueshme ia ka prezantuar Kosovës edhe në Bruksel. Faleminderit!

KRYETARI: Kalojmë në temën tjetër, sepse ishte po ashtu...Urdhëro! Nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala e ka fjalën për këtë pikë. Më vjen keq zoti Shala, nuk ka të drejtë askush që në këtë pikë të flasë më shumë se dy minuta!

Praktikat e mëhershme në Kryesi të Kuvendit kanë qenë të paligjshme dhe privilegjuese për nënkryetarët e Kuvendit. Nuk ka më ashtu. Po, urdhëro!

KUJTIM SHALA: Zoti kryetar, nëse dëshironi t'i ndryshoni praktikat të cilat nuk i ka Rregullorja, po që janë pjesë e marrëveshjes së kolegëve, deputetëve, përfaqësuesve të tyre në Kryesinë e Kuvendit, këtë duhet ta bëni në Kryesinë e Kuvendit.

Mund ta bëni edhe në sallë, sepse ju e interpretoni Rregulloren, por nuk keni të drejtë të flisni në emër të Kryesisë së Kuvendit. Kjo është çështja e parë. E dyta, nëse dëshironi t'i përmbaheni Rregullores, unë pajtohem, po duhet t'i përmbaheni edhe në rastin e kryeministrit dhe të ministrave, për shembull. Sepse kryeministri e merr fjalën dhe flet sa herë të dojë dhe ta zgjasë sa të dojë, dhe ka të drejtë të flasë vetëm dy minuta. Domethënë, ky është problemi.

Unë e kërkova fjalën që të flas pak më gjatë, jo pa arsye, dhe ju luta. Nuk thashë që kam të drejtë, pra, ju luta e kërkova, po duke e pasur parasysh praktikën që kemi ndjekur edhe në këtë legjislaturë. Faleminderit!

KRYETARI: As unë vet nuk kam qenë për besë në atë mbledhje të Kryesisë kur është vendosur në mënyrë si njëfarë marrëveshje xhentëlmene, le të themi, mes anëtarëve të Kryesisë, që të flasim më gjatë, 10 minuta pavarësisht në cilën kategori ndodhemi.

Mirëpo, në këtë rast krejt çka i kemi janë 6 minuta dhe ju m'i kërkuar 10. Gjashtë i kemi për të gjitha, që t'i përfundojmë ato që i ngrehu, për shembull, zoti Shala për gazin. Pastaj ishte tema e zotit Kervan nëse do të fillojnë shkollat dhe nga ministrja Arsimit priste përgjigje.

Sidoqoftë, mund ta bëjmë një përjashtim përtej 2 minutëshit për juve, por 5 minuta për shembull, nëse ju mjaftojnë.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Unë do të flasë vetëm për çështjen e marrëveshjes së fundit të Brukselit që vërtet e përbëjnë tri konkluzat të dakorduara. Pra, duhet të kemi parasysh edhe statusin e saj, por për këtë marrëveshje nuk mund të flasim si për një gjë të veçantë edhe pse është një akt i veçantë.

Kjo marrëveshje duhet të shtrohet në një rrafsh tjetër, në rrafshin e përfaqësimit të Kosovës në procesin e dialogut në këtë kohë, në muajt e fundit. Pse? Sepse kryeministri dhe Qeveria pretendojnë që për herë të parë në këtë proces, domethënë pas një dekade, Kosovën e kanë kthyer në një palë të barabartë.

I bie që deri këtu, Kosova s'paska qenë palë e barabartë. Dhe kjo është shumë e rëndësishme. Pra, ta kemi parasysh çka do të thotë status i palës në negociatat e kësaj natyre. E kam fjalën për formatin dhe për përfaqësimin. Kjo s'ka lidhje me përmbajtjen, po edhe e përmbajtja e akteve të tilla të bën të barabartë apo jo.

Të shohim në rrafshin e statusit të përfaqësimit nëse Kosova është e barabartë. A është Kosova e barabartë me Serbinë nëse kryeministri i Kosovës shkon në Bruksel dhe grindet me presidentin e Serbisë, pra flet si ai? Kjo s'të bën të barabartë. S'është kurrfarë rezultati. Përkundrazi, të nënkupton, sepse përfaqësuesi i Kosovës duhet të flasë ndryshe dhe duhet të na përfaqësojë neve.

Në fillim delegacioni i Kosovës nuk është marrë me aq seriozitet, përfaqësimi i Kosovës në Bruksel. Tani duhet të merret me seriozitet, sepse kur bëjmë marrëveshje të tilla dhe as nuk i

kuptojnë, kthehen në njerëz të rrezikshëm si funksione, jo si persona se nuk e di çfarë personash janë këta, e as s'më intereson. Pra, është punë për ta.

Në anën tjetër në rrafshin politik, po ashtu, pretendojnë që Kosova për herë të parë është e barabartë. E merreni e shikojeni atë tavolinë aty të nivelit më të lartë në të cilën diskutojnë për Kosovën, negociojnë për Kosovën dhe negociojnë Kosovën si në marrëveshjen e fundit, me Serbinë hisedarë, të gjithë ose janë neutral ose janë kundërshtarë të shtetit të Kosovës, përfshirë pozicionin e paqartë të kryeministrit të Kosovës, i cili edhe sot ankohet se si Kushtetuta e Kosovës nuk e lejon që të bëjë shtetin, kryeministër i të cilit është. Çfarë pale e barabartë ju? Ku e dëshmojmë barazinë në këtë rast? Vetëm në rastin e përfshirjes së Serbisë në çështjet tona. Po atëherë ajo nuk është palë.

Nuk janë dy palë as palët. Se në këtë rast statusi formal përballë përmbajtjes më nuk ka kurrfarë rëndësisë.

Ju jeni marrë vesh në Bruksel me Serbinë për çështjet tona. Jeni marrë vesh me Serbinë edhe për çështjen e KFOR-it. Pse? Pra, kthen një pjesë të territorit tënd, në kuptimin formal juridik, në një zonë sigurie neutrale. Po ju thatë që ne vendosim si shtet sovran, marrim vendime sovrane, i mbrojmë vendimet sovrane.

E si bën që në të njëjtën kohë i bëjmë thirrje bashkësisë ndërkombëtare që të ndërhyjë, e jemi sovran, e pastaj s'jemi sovran as përballë atyre, sepse marrëveshjen e bëjmë me Serbinë.

Pse duhet Kosova të merret vesh me Serbinë, pra që të çojë policinë në aksione të cilat janë të nevojshme e të domosdoshme që të garantojë rendin, sigurinë e të tjerë, që të garantojë zbatimin e ligjit? Pse duhet që Kosova të negociojë dhe të pajtohet me Serbinë për targa të cilat i bartin qytetarët tanë? E kam fjalën për serbët kosovarë.

Në rregull reciprociteti. Reciprociteti vihet me Serbinë, reciprociteti nuk mund të vihet me vetveten. Prandaj, merreni seriozisht këto çështje.

Kjo marrëveshje për mendimin tim, unë mund ta kem gabim, është shumë problematike dhe nuk ia dimë pasojat deri në fund. Dëshiroj të mos kem të drejtë zoti zëvendëskryeministër, po problemin më të madh e kam për përfaqësimin dhe për pretendimin që e keni ju për përfaqësimin, sepse kam frikë që në thelb s'po e kuptoni çfarë dëmsh po bëni. Pra, kjo është çështja.

E për tekstin e marrëveshjes, ne do duhej të pajtohemi me kolegët dhe me ju. Do duhej të flisnim ngadalë dhe me kujdes, dhe duhet të flasim edhe në këtë Kuvend dhe në institucione të tjera.

Ju jeni përgjegjës, por marrëveshjen e bëni edhe në emrin tonë. Por, ju duhet të keni durim dhe mirëkuptim që nëse neve s'na duket e mirë, nuk mund t'ju themi që është e mirë. Kaq ka kjo.

KRYETARI: Të kalojmë në temën tjetër, sepse nuk kemi kohë pastaj që t'ia japim fjalën ministres së Ekonomisë. Ta kemi një sqarim edhe për këtë çështjen e gazit, gazsjellësit.

Kemi të gjitha të drejtat zoti Hyseni, por edhe kohën e kemi të kufizuar.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sa i përket çështjes së infrastrukturës së gazit, dua t'i qartësojë disa gjëra.

Së pari, fondet e MCC nuk kanë qenë të alokuara për infrastrukturë gazi specifikisht, kanë qenë të alokuara për një program për Kosovën. Energjia është përzgjedhur si sektor për arsye se në vitin 2016, MMC si bashku me Qeverinë e Kosovës kanë bërë një hulumtim i cili ka treguar se energjia është sektor problematik që përbën një pengesë për zhvillim ekonomik në Kosovë.

Ka mundur të ketë edhe projekte të tjera, por qeveritë e kaluara e kanë përzgjedhur infrastrukturën e gazit si opsionin më të mirë sipas tyre.

Tani, projekti i dizajnuar nga qeveritë e kaluara dhe MCC, ka paraparë që gazsjellësi Shkup-Prishtinë, një gyp transmisioni me kosto 104 milionë dollarë, të nderohet me kredi nga BERZH-i, të cilën do ta merrte Qeveria e Kosovës dhe 20% grant nga WBIF.

Kosto në këtë fazë nuk ka qenë e qartë, sepse studimi i fizibilitetit ka qenë ende duke ndodhur dhe studimet e fizibilitetit që i përmendem më herët, janë ende duke ndodhur. Master-plani për shtrirjen e gazit, projekti i MCC, gjithashtu ka qenë duke e vazhduar studimin e fizibilitetit dhe gjithashtu një projekt fizibiliteti paralel, i përbashkët mes Maqedonisë dhe Kosovës është duket ndodhur aktualisht.

Si rezultat kosto e gazsjellësit nuk është e qartë. Parashihet me një kontigjencë 40%. Që do të thotë që kjo kosto 104 milionë dollarë mund të ngrihet deri në 145,6 milionë dollarë.

Prapë po e ceku, gazsjellësi nuk lidhet me projektin e MCC. Financimi për gazsjellësin nuk ka pasur të vijë nga projekti i MCC. Kjo është pjesë e cila mund të realizohet siç ka qenë e paraparë me BERZH-in dhe WBIF nëse ne vendosim.

Gypat e distribucionit për Shar-cem dhe Ferronikël, 4 milionë dhe 20 milionë dollarë, respektivisht. Kjo ka qenë e paraparë të financohej me grant të MCC. Në këtë pikë kemi pasur

dilema për arsyeshmërinë ekonomike. Nuk ka qenë e qartë nëse këto firma kanë interesim dhe sa do të zgjidhte problemin e tyre.

Javën e kaluar së bashku me ministrin Murati, personalisht i kemi takuar përfaqësuesit e Ferronikelit, të cilët na kanë njoftuar se vetëm për ngrohje do të mund ta përdornin gazin. Domethënë, të mbulonin vetëm 15% të kërkesës së tyre për energji elektrike.

Ndërsa ne po flisnim për 20 milionë dollarë të taksapaguesve amerikanë për ta dërguar gypin deri te Ferronikeli. Pastaj është paraparë një termocentral me gaz prej 250 MGW për base load apo kërkesë bazë dhe 98.5 MGW rezervë terciare.

Përfitimet janë se do të mbulonin një pjesë të kërkesës për energji elektrike base load dhe do të krijonte fleksibilitet në sistemin tonë duke ofruar rezerva terciare që do të mundësonin integrimin e BRE-ve në masë më të madhe se sa që i kemi aktualisht.

Mirëpo, këtu ka pasur mangësi ose paqartësi dhe dilema, dhe disa prej tyre do t'i qartësojë tani.

Së pari, kosto totale prapë. Prej koston 379 milionë dollarë, e cila është paraparë nga investim i Kosovës, grant nga MCC, 100 milionë dollarë, ndërsa 279 milionë dollarë apo 75% në pronësi të një investitori të huaj.

Kjo kosto kontigjencën e ka pasur 20%, që do të thotë që ka mundur të shkojë deri në 455 milionë dollarë. Nuk ka qenë e qartë se cili do të jetë efekti në çmimet për konsumatorët.

Sipas disa përllogaritje që i kemi marrë, 40 euro për 1MGW, ka qenë vetëm kosto e paraparë e gazit, që është më shtrenjtë 30% se sa kosto aktuale e prodhimit të energjisë që e kemi.

Do të thotë, është pritur që së paku dy herë të rritet çmimi i koston në krahasim me këtë që e kemi tani, mirëpo prapë kjo nuk është diçka që ka qenë e qartë dhe e matur në mënyrë rigoroze.

Nga ekspertët, kemi konsultuar ekspertë nga ZRRE-ja, KEK-u, KOSTT-i, ekspertë të pavarur nga Kosova, nga diaspora, të cilët i falënderojë shumë. Ekspertët na kanë thënë se të përdoret gazi për prodhimin e energjisë për base load, për kërkesën bazë, nuk është ekonomishtë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Keni edhe shumë, por ju lutem nëse mundesh për 60 sekonda diçka përfundimtare se çfarë do të ndodhë me këtë projekt.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Po provoj! Faleminderit!

Thashë që kosto do të ishte e lartë, nuk kemi pasur vlerësim të saktë. Investitorët të cilët janë intervistuar për investime potenciale, disa prej tyre nuk kanë shprehur interesim për investim fare, për arsye se nuk investojnë më në gaz, për shkak të politikave të shteteve të tyre ose politikave të veta.

Investitorët që kanë treguar interesim, kanë treguar interesim me kushte të pafavorshme. Kanë kërkuar kthim të investimit, por vetëm 10 vjet, duke e marrë parasysh riskun e investimit në gaz.

Kanë kërkuar një marrëveshje për blerje, power purchase agreement, për 10 vjet në një single buyer model, që është i ngjashëm me Kosovën e Re, të cilën e dimë se ku na ka sjellë, i cili nuk përputhet me obligimet tona ndaj...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, ministre!

Zëvendëskryeministrja Emilija Rexhepi, një përgjigje për zotin Kervan, dhe kalojmë në pikën tjetër.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se gospodine predsedniče,

Uvaženi kabinet Vlade,

Uvaženi narodni poslanici,

Želim samo da dam osvrt poslaniku Enisu Kervanu na mnoge nedostatke koje mi kao zajednica imamo u obrazovanom sistemu Republike Kosova već 20. godina, to je jedna od prioriternih strategija sa kojom se ja kao zamenica premijera za manjinske zajednice bavim se radnim sa našom ministarkom obrazovanja u vezi udžbenika, prevoda, lošeg prevoda pre svega nacionalnih grupa, predmeta i opštih predmeta je već 20. godina taj isti problem. Aktivizirali smo sve moguće institucije i očekujemo znači za 10. dana da udžbenici izađu iz štamparija i proslede se našim učenicima i na bosanskom, i na turskom jeziku.

Zatim imamo veliki problem oko naših autora koji se bave nacionalnim predmetima, odnosno njih isplaćeno za njihov rad. Tako da očekujemo od naše Vlade poseban fond koji bi trebao ovih dana da se njima isplati, obećano nam je od strane Ministarstva da će to biti u skorijom vremenskom periodu.

Takođe problematika oko rezervisanih mesta za upis naših studenata na javnim univerzitetima, posebno na Fakultetu Medicine. Vi znate da dok sam ja bila poslanik i svi mi koji smo ovde 20. godina govorimo o malverzaciji, i zloupotrebi, korupciji tih rezervisanih naših mesta da se iz druge zajednice upisuju studenti, i onda to smo sada ove godine predali Inspektoratu i čekamo da

se ta lista pre svega primljeni kandidata anulira, a naravno kasnije da se prime i svi naših studenti ne samo Bošnjaci i Turci, nego i pripadnici ostalih zajednica koji žive na Kosovu.

Takođe, imamo kao prioritet Ministarstva obrazovanja i moj lični pritisak na institucije jeste stvaranje divizije u okviru Ministarstva obrazovanja. Zna da mi nemamo nijednog službenika zaposlenog u Ministarstvu obrazovanja 20. godina već. Tako da se radi novi organogram koji će zaposliti po jednog pripadnika civilnog stafa našeg službenika u Diviziji koji će se baviti prosvetnim kadrom i koji će biti svih redova manjinskih zajednica.

Ono što je takođe bitno jeste da dobro je da se čuje vaš glas, dobro da govorimo o prosvetnim problemima, jer je obrazovanje stub svake zajednice, i ukoliko imamo problem obrazovanog sistema, u tolikoj meri smo integrisani u ovom društvu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Me kaq e mbyllim këtë pjesë. 10 minuta e kemi shkelur Rregulloren e Kuvendit, mjafton kjo.

2. Pyetjet parlamentare

Deputetja Arjeta Rexhepi ka pyetje, të cilat kanë mbetur nga seanca e kaluar. Ministrin e Kulturës, Hajrullah Çeku, nuk e kemi këtë.

ARJETA REXHEPI: Këtu është ministri, kështu që po vazhdoj me pyetjen.

KRYETARI: Erdhi ministri.

ARJETA REXHEPI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë të dashur qytetarë,

Me vite të tëra qeveritë e kaluara u kanë premtuar qytetarëve gjilanas ndërtimin e një stadiumi modern dhe sipas standardeve të UEFA-s, në qytetin e Gjilanit.

Një fushë e tillë moderne për të gjithë futbolldashësit është e domosdoshme në qytetin e Gjilanit, edhe nga fakti i pjesëmarrjes aktive në gara ndërkombëtare të dy ekipeve nga ky qytet, ajo e ekipit të Dritës dhe ekipit të Gjilanit.

Megjithatë, prolongimi i vazhdueshëm i punimeve dhe ngadalësia në finalizimin e saj paraqet një shqetësim serioz te qytetarët e Gjilanit.

Andaj, i nderuar ministër, kur parashihet të përfundojnë punimet në ndërtimin e stadiumit të ri të Gjilanit dhe sa po respektohen standardet e UEFA-s në ndërtimin e saj?

KRYETARI: Ministri e ka fjalën.

MINISTRI HAJRULLAH ÇEKU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

E nderuar deputete,

Faleminderit për pyetjen!

Stadiumi i Gjilanit është një nga problemet më të mëdha në infrastrukturën sportive çfarë e kemi gjetur në Ministrinë e Sportit.

Me dinamikën e punimeve dhe realizimit të pagesave nga viti 2017, kur është nënshkruar si kontratë, nëse vazhdon e njëjta dinamikë, na duhen të paktën edhe 20 vjet për të përfunduar ai projekt. Ne kemi ndërhyrë menjëherë, e kemi si një nga investimet më të rëndësishme që duhet të përmbillen sa më shpejt, kemi shtuar buxhet dhe kemi rritur dinamikën e realizimit të punimeve dhe do të bëjmë më të mirë tonë që stadiumi i Gjilanit të përfundojë brenda këtij mandati.

Ndërsa sa u përket standardeve të UEFA-s, stadiumi duhet të ketë edhe fasilite përcjellëse, për të cilat Komuna e ka përgjegjësinë si për ndërtim, ashtu edhe për respektimin e këtyre kriterëve. Ne do t'i rrimë gati Komunës, do të sigurohemi që ta respektojë MOU-në që e ka me Ministrinë e Kulturës dhe stadiumi kur të përfundojë, dhe i takon kategorisë së katërt, t'i respektojë të gjitha standardet e UEFA-s. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, a keni nevojë për ndonjë pyetje shtesë? Urdhëroni!

ARJETA REXHEPI: Faleminderit, ministër!

Por para një viti kryetari i komunës, Lutfi Haziri, ka deklaruar se projekti i stadiumit do të kalojë nën menaxhimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke i justifikuar kështu ndërprerjet e punimeve.

Pra, i nderuar ministër,

A është ky projekt tani nën menaxhimin e ministrisë tuaj?

Kryetari: Urdhëroni, ministër, fjala për ju.

MINISTRI HAJRULLAH ÇEKU: E nderuar deputete,

Nuk ka ndodhur asnjë ndryshim nga marrëveshja fillestare. Marrëveshja fillestare është që komuna e menaxhon dhe e zbaton projektin, ministria i ekzekuton pagesat, nuk ka ndodhur asnjë lloj ndryshimi. Nëse dikush po tenton të hedhë përgjegjësinë diku tjetër, atëherë duhet ta pyesni kryetarin e komunës. Po ministria e ka për detyrë t'i ekzekutojë pagesat, ndërsa Komuna duhet siguruar që projekti po zbatohet, kaq e thjeshtë është kjo punë.

Nëse ata nuk janë të aftë ta kryejnë këtë punë, të vijnë në ministri, le të na tregojnë që nuk mund ta kryejnë këtë punë, atëherë shohim edhe një zgjidhje alternative. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, e keni pasur edhe një pyetje tjetër.

ARJETA REXHEPI: Po kryetar, faleminderit!

Në raportin vjetor të punës për vitin 2020 të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore theksohet mungesa e vlerësimit të projekteve të trashëgimisë kulturore dhe domosdoshmëria që këto vlerësime të bëhen vetëm nga ky institucion.

Në Ligjin për trashëgimi kulturore, në nenin 5, pika 2. Obligon Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore të bëjë vlerësimin e projekteve të propozuara dhe të parashtruara nga institucionet e fushave përkatëse. Përderisa ministria është përgjegjëse për aprovimin dhe implementimin e këtyre projekteve në baza proporcionale nga buxheti i saj.

Andaj, i nderuar ministër,

A kemi praktika që vlerësimet e projekteve të propozuara për objekte të trashëgimisë kulturore e kanë bërë komisione të tjera funksionale brenda ministrisë dhe jo Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën për t'u përgjigjur.

MINISTRI HAJRULLAH ÇEKU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

E nderuar deputete,

Të falënderoj edhe për këtë pyetje!

Nuk besoj që ka ndonjë paqartësi, është fat i mirë që ky Kuvend para pak javësh e ka votuar përbërjen e re të Bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe përfundimisht mund ta aktivizojmë procesin e shpalljes së aseteve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme.

Rreth 50 dosje janë aktualisht duke u proceduar në Këshillin e Kosovës dhe është detyrë e atij bordi t'i shqyrtojë këto dosje dhe të na i kthejë në ministri me aprovimin që ne t'i shpallim në mbrojtje të përhershme. Pra, unë nuk shoh që ka ndonjë përzierje në kompetenca, ministria e kryen pjesën e vet të punës, që është përgatitja e dosjeve, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore e bën verifikimin përfundimtar të tyre dhe, në këtë mënyrë përfundimisht ne e shpallim trashëgiminë tonë dhe asetet e trashëgimisë në mbrojtje të përhershme të ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Rexhepi, pyetje shtesë?

Kalojmë te pyetjet që shtrohen për herë të parë në këtë seancë.

Deputetja Blerta, nuk është këtu. Kalojmë te deputetja Ariana Musliu-Shoshi, e cila i ka dy pyetje për zëvendëskryeminstren e ministren e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, e cila me sa po e shoh, nuk ndodhet këtu. Deputete, doni ta bëni pyetjen?

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Përshëndetje, kryetar!

Faleminderit për mundësinë!

Pasi që pyetjet e mia kanë një rëndësi shumë të veçantë sa i përket politikës së jashtme, atëherë do ta pres ministren që të vijë edhe në seancën e rashës dhe nëse nuk vjen, atëherë pyetjet e mia do t'i adresoj kryeministrit. Faleminderit!

KRYETARI: Tash deputeti Ramush Haradinaj e ka një pyetje për kryeministrin Albin Kurti.

RAMUSH HARADINAJ: Çështja ka të bëjë me importet nga Serbia, të cilat janë rritur ndjeshëm, pra importet nga Serbia në Kosovë në vitin 2019, në gjashtëmujorin e parë kanë qenë vetëm 3 milionë importe, në vitin 2020, në gjashtëmujorin e parë 54 milionë, ndërsa në gjashtëmujorin e parë të këtij viti, pra 2021, janë 132 milionë importe nga Serbia.

Njëkohësisht ky trend është në rritje dhe e dimë se shumë prodhues vendorë janë në vështirësi për shkak të masave dumping, subvencioneve që i bënë Serbia për shumë produkte të veta dedikuar eksportit në Kosovë. Ndërsa ajo që i ka ndodhur Kosovës është e kundërta, Kosova i ka hequr masat mbrojtëse për prodhimet vendore, rasti më i freskët është çështja e bllokave ndërtimore.

Pyetja është kjo: Çfarë masash ka marrë apo do të marrë Qeveria për mbrojtjen e prodhuesve vendorë, duke e ditur që importi nga Serbia është kërcënim për prodhuesit vendorë. Pse po i hiqni barrierat për këto produkte që stimulojnë importin nga Serbia, si rasti i bllokave dhe po lejoni që shtëpitë tona të ndërtohen me dhe të Serbisë dhe po e mundësoni dëmtimin e prodhuesve kosovarë. Pyetja i drejtohet kryeministrit.

KRYETARI: Kryeministri Kurti e ka fjalën për t'u përgjigjur.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Faleminderit, deputet Haradinaj, për pyetjen.

Të nderuar deputetë,

Krahasimi i vlerës së mallrave të importuara përmes serive kohore ka logjikë vetëm nëse krahasohet me vitin e fundit stabil. Viti 2019 ka qenë vit i bllokadës përmes tarifës prej 100%, përderisa viti 2020 ka qenë vit i rënies së përgjithshme të importeve si pasojë e problemeve me COVID.

Në raport me Serbinë, kësaj i janë shtuar edhe masat e reciprocitetit të zbatuara nga Qeveria jonë në pranverën e vitit të kaluar.

Viti i fundit që mund të trajtohet si stabil është gjashtëmuajori i parë i vitit 2018, periudhë kjo kur ju keni qenë në qeverisje, i nderuar deputet Haradinaj.

Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2018, kur nuk ka pasur lëvizje të mëdha në çmimet nëpër berëzat ndërkombëtare, Kosova ka importuar fiks 212.1 milionë euro mallra nga Serbia, kjo është jo më pak se 60% më shumë se sa vlera e importeve në gjashtëmuajorin e parë të këtij viti.

Krahas kësaj uljeje të ndjeshme të importeve nga Serbia, për të cilën unë pajtohem që duhet të ulët edhe më shumë dhe do të punojnë për uljen e mëtejme përmes masave që presim të ndërmarrim, unë dua t'ju prezantoj dy shifra të tjera, që mbasi ju bëjnë të kuptojnë në mirë dallimin në qeverisje.

Krahasuar me periudhën e qeverisjes suaj në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2018, ne kemi një rritje prej 38% të importeve nga Shqipëria dhe rritje prej 80% të eksporteve drejt Shqipërisë. Dhe, ky është synimi ynë afatgjatë, pra forcimi i bashkëpunimit tregtar me Shqipërinë.

Në vlerën e 80% është edhe rritja e vëllimit të eksporteve drejt Maqedonisë së Veriut, një aleat tjetër i rëndësishëm për vendin tonë.

Ne kemi strategji shumë të saktë se si duhet të duket peizazhi i marrëdhënieve tona tregtare në të ardhmen, vetëm duhet të keni durimin dhe besimin, nuk jemi në vitin e fundit të mandatit, por në muajin e shtatë të tij.

KRYETARI: Deputeti Ramush Haradinaj, a ke pyetje shtesë? Po urdhëroni!

RAMUSH HARADINAJ: E vërteta është se kur flisni për rritjen ekonomike, kryeministër dhe Qeveri, të gjithë i merrni shifrat më të afërta kohore, sidomos ato të pandemisë, pra kur s'ka pasur rritje ekonomike dhe i bëni krahasimet. Ndërsa, në rastin konkret, kur është për Serbinë, nuk ju pëlqen ky krahasim kohor, sepse po manipuloni me të dhëna ashtu si ju konvenojnë.

Ka diçka, pyetjen unë po e thjeshtësoj, po e lë rritjen e importit që ka mbërritur 132 milionë këta gjashtë muaj. A jeni ju në dijeni që ia keni hequr një masë mbrojtëse që ka qenë e dedikuar ta vështirësojë konkurrencën e bllokave të Serbisë e të mos ndërtohen shtëpitë, ta zëmë, në Has, atje larg në kufi me Shqipërinë, me dhe të Serbisë, kur ne kemi fabrika të bllokave edhe në Podujevë, edhe në Gjakovë, edhe e kanë më afër. Pra, çka bën Qeveria juaj, a do ta lëni këtë gjendje...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kryeministri Kurti e ka fjalën për një përgjigje.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Nejse, po flasim tash edhe për blloka, meqë është fushatë për zgjedhjet lokale. Vendimit i ka skaduar afati dhe ne duhet ta vlerësojmë ai vendim a e ka arritur qëllimin e vet dhe më pastaj, të marrim vendim të ri se a ta vazhdojmë e si ta vazhdojmë, kuturu, ad hoc, nuk veprojmë.

KRYETARI: Deputeti Luan Aliu e ka një pyetje për ministrin Armend Mehaj.

LUAN ALIU: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit, Konjufca!

I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar Kryeministër Kurti,

Kolege dhe kolegë deputetë,

Forca e Sigurisë së Kosovës është një nga institucionet që gëzon besimin më të lartë në mesin e qytetarëve të Kosovës.

Ky besim e bën këtë institucion shumë të dëshiruar nga ana e të rinjve dhe të rejave të Kosovës. Në çdo konkurs të hapur për pranimin e rekrutëve të rinj, interesimi për të aplikuar është i lartë. Megjithatë, janë raportuar disa raste, në të cilat aplikuesit kanë shfaqur shqetësimin e tyre rreth mungesës së vlerësimit dhe përzgjedhjes meritore të rekrutëve të rinj. Pra, i nderuar zoti ministër Mehaj, pyetja është: A është bërë ndonjë vlerësim nga Ministria e Mbrojtjes rreth këtyre shqetësimeve të pretenduara? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër Mehaj, urdhëroni, e keni fjalën!

MINISTRI ARMEND MEHAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Vëllezër e motra,

I nderuar deputet Aliu, transparenca dhe llogaridhënia para qytetarëve është parimi i cili më prin çdo ditë në punë. Detyrë imja si ministër i Mbrojtjes, këtë e kam çmuar këta shtatë muaj, kam insistuar që të vendos këtë parim në çdo kush në institucionet që drejtojmë që nga dita e parë e mandatit tim. Dëshmi është edhe lista e objektivave të mia strategjike, në të cilën objektivi me prioritet më të lartë është mbikëqyrja civile demokratike mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës, me llogaridhënie dhe transparencë. Në përmbushjen e këtij objektivi vetëm në 100-ditëshin e parë kam marrë 11 vendime e veprime. Ushtria e Republikës së Kosovës është e shenjtë, ajo do të jetë e pastër si kristal. Për proceset e kaluara edhe unë kam dëgjuar që ka ankesa, kanë hedhur dyshime për proceset e rekrutimeve, mirëpo unë i sugjeroj të gjithë të rinjtë e të rejtat e Republikës së Kosovës që nën udhëheqjen time do të ketë proces të drejtë, të barabartë, strikt, profesional në çdo rekrutim.

Tani shumë shpejt do të hapet konkursi për rekrutim më të madh që ka ndodhur ndonjëherë në Republikën e Kosovës. Do të pranojmë rreth 850 rekrutë të rinj, procesi do të monitorohet nga Kallxo.com, do të incizohen të gjitha me kamera, do të jetë bord profesional, i paanshëm, për t'i përzgjedhur më të mirët. Por, edhe një kërkesë dua t'ua dërgoj të gjithëve, nëse vëreni anime, joprofesionalizëm, nëse vëreni se dikush e favorizon dikë, dërgojeni tek unë ato informata, e unë ju garantoj që ata s'kanë vend brenda Ministrisë së Mbrojtjes, për këtë zotohem para juve e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Aliu, a ke pyetje shtesë?

LUAN ALIU: Jo, kryetar. Faleminderit, për këto sqarime!

KRYETARI: Në rregull! Tash kalojmë te pika tjetër, që është:

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

68 deputetë janë të pranishëm për momentin. Ju pyes, nëse keni ndonjë vërejtje për procesverbalin e seancës plenare, e mbajtur më 20 shtator 2021.

Nëse jo, konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare, e mbajtur më 20 shtator 2021.

I ftoj grupet parlamentare që t'i ftojnë deputetët e tyre të marrin pjesë në seancë. Jemi marrë vesh edhe në mbledhje të Kryesisë që kjo është një mbledhje shumë e rëndësishme, një seancë plenare shumë e rëndësishme, meqenëse njëra prej marrëveshjeve ndërkombëtare që do të votohet është edhe luftimi kundër pandemisë COVID-19. Ka qenë shumë urgjente për Kosovën, edhe deputetët do të ishte mirë që të marrin pjesë e ta kalojmë këtë marrëveshje, sepse nevojiten 80 vota për të.

Na duhen edhe 7 deputetë të marrin pjesë që të bëhen 80. Ju lutem, grupet parlamentare, më aktive! Po fillojmë me këto marrëveshje, në ndërkohë i presim deputetët të vijnë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-030 për ratifikimin e amendamentimit të Marrëveshjes së bashkëfinancimit për projektin "Programi mbështetës për ujësjellës dhe kanalizim në zonat rurale faza (dalëse) VI", ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës

Të nderuar deputetë, Komisioni FunkSIONAL për Buxhet, Punë dhe Transfere e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. E ftoj me këtë rast ministrin e Financave, zotin Hekuran Murati, që ta arsyetojë dhe ta paraqesë këtë projektligj.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në përpjekje të vendit tonë për të avancuar zhvillimin e qëndrueshëm të vendit dhe përmirësimin e infrastrukturës të sektorit të ujërave, zhvillimi i shërbimeve efektive të integruara të ujit, si në zonat rurale dhe urbane, paraqet një pikë shumë të rëndësishme.

Si rrjedhojë, në vijim të bashkëpunimit të mëtijmë me Qeverinë e Zvicrës dhe rëndësinë jetike të këtij sektori, e rëndësisë së veçantë është edhe Marrëveshja e bashkëfinancimit me Qeverinë e Zvicrës për projektin “Programi mbështetës për ujësjellës dhe kanalizim në zonat rurale, faza (dalëse) VI”. Programi e mbështet qasjen në ujë të pijshëm për zonat rurale, menaxhimin e qëndrueshëm të sistemit të ujit dhe ujërave të zeza në komunat e ndryshme të Kosovës dhe koordinimin më të mirë brenda këtij sektori. Qeveria e Zvicrës, si një ndër donatorët më të mëdhenj të sektorit të ujërave, ka mbështetur Kosovën në këtë sektor që nga viti 1999 me grante. Nga viti 2011 Qeveria e Kosovës i është bashkuar financimit të Programit mbështetës për ujësjellës dhe kanalizim në zonat rurale në fazën IV të këtij projekti dhe kjo marrëveshje është nënshkruar në vitin 2018. Amendamenti që prezantojmë sot para jush vjen si pasojë e faktit se gjatë implementimit të këtij projekti është hasur në vështirësi në disa komuna të caktuara dhe për këtë është vendosur në Komitetin drejtues të projektit që të ndryshohet shtrirja gjeografike e projektit dhe mjetet të ridestinohen.

Për shkak që këto, pra kanë qenë të cekura në formë eksplicite në Marrëveshjen e bashkëfinancimit, sipas Ligjit për marrëveshje ndërkombëtare është e nevojshme që të amendamentohet marrëveshja, në mënyrë që këto të reflektohen saktë, këto ndryshime. Gjithashtu, është e rëndësishme të ceket se ky amendamentim mundëson zgjerimin e shërbimeve të zbatuesit, në mënyrë që të lejohen një përfundim i ndërhyrjeve të planifikuara, kryesisht për zbatimin e punëve në infrastrukturë. Gjithashtu, do të realizohet ndërtimi i sistemeve të reja dhe të përditësuar rurale të ujit në komunat e Kosovës, të cilat pastaj edhe do të mund të integrohen nën menaxhimin e kompanive rajonale të ujësjellësit përkatëse.

Rrjedhimisht kjo do të mundësojë që qytetarët në zonat e mbështetura të përfitojnë nga qasja universale në furnizim me ujë të sigurt dhe shërbime të kanalizimit. Po ashtu, me anë të kësaj marrëveshjeje të amendamentimit, pra përveç ndryshimeve që u cekën më lart, Qeveria zvicerane i zoton edhe 572 mijë franga zvicerane shtesë apo ekuivalent 530 mijë euro, mbështetje në formë granti për këtë fazë. Kjo e rrit në total kontributin e Qeverisë zvicerane në projekt, në 7,67 milionë franga zvicerane. Meqenëse me marrëveshjen bazë fillimisht deri më tani kemi pasur 7,1 milionë franga zvicerane. Duke marrë parasysh rëndësinë e marrëveshjet të tilla dhe impaktin për sektorin e ujërave, e shtoj këtu edhe faktin që kemi të bëjmë me grant, ju ftoj që të votoni këtë projektligj. Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Tash fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Buxhet, deputeti Armend Muja, për ta arsyetuar raportin e këtij komisioni.

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Unë do të flas në emër të Komisionit për Buxhet, po të njëjtën kohë po ashtu po e prezantoj edhe qëndrimin e grupit parlamentar.

Fillimisht ky projektligj është trajtuar në Komisionin për Buxhet, Komisioni për Buxhet e ka miratuar pa ndonjë vërejtje. Të njëjtin ia rekomandojmë po ashtu edhe deputetëve të këtij Kuvendi.

Ndërkohë, sa i përket grupit parlamentar, unë mendoj që ky projekt, ndryshimet e vetme që i trajton ka shtesë, financim grant shtesë nga Qeveria zvicerane, mirëpo në anën tjetër, i trajton dy prioritete, të cilat ne fuqishëm mendojmë që duhet të trajtohen sa më shpejt. Ende ekzistojnë 400 mijë qytetarë të Kosovës që s'kanë qasje në ujë të sigurt dhe rreth diku 700 mijë që s'kanë qasje në kanalizim. Për këtë arsye, çdo financim shtesë e ka mbështetjen e grupit parlamentar, në të njëjtën kohë u bëjmë thirrje po ashtu edhe grupeve të tjera parlamentare që ta votojnë konform konsensusit që e kemi në kuadër të grupit punues për ujërat.

KRYETARI: Të gjithë deputetët që janë paraqitur, nuk e kanë tërhequr fjalën e tyre kur e kanë shtypur në pjesën e deklaratimeve jashtë rendit të ditës.

Tash, kanë mbetur vetëm Armend Zemaj, kurrkush tjetër nuk e ka kërkuar fjalën në emër të grupeve parlamentare. Zoti Ferat Shala nga Partia Demokratike e Kosovës.

FERAT SHALA: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet dhe jemi pro zhvillimit të këtyre investimeve, sidomos nga gjendja që vërtet e vlen që të investojmë në çështjet e ujit. Jemi për dhe do ta mbështesim! Faleminderit!

KRYETARI: Nga LDK, deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Vetëm desha të rikonfirmoj mbështetjen për këtë marrëveshje edhe është për t'u përshëndetur edhe qëndrimet pozitive që kanë edhe grupet tjera parlamentare, sepse kjo marrëveshje derivon nga viti 2018, sidomos edhe nga vetë ministri, i cili e arsyetoi në mënyrë shumë perfekte dhe besoj që kështu duhet të jetë logjika e debatimit, apo edhe e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Më mirë të them, duke anashkaluar inatet politike siç ka ndodhur në të kaluarën edhe kur janë dëmtuar qytetarët e Kosovës, sidomos nevoja për ujësjellës dhe kanalizim në shumë zona në

Republikën e Kosovës. Me një fjalë, Grupi Parlamentar e mbështet këtë marrëveshje, njëherësh edhe falënderon posaçërisht edhe shtetin zviceran sidomos në sektorin e ujërave që e ka mbështetur Kosovën në vazhdimësi dhe vazhdon ta mbështesë edhe më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka deputeti Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetar!

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, duke u nisur në mbështetjen e shtetit zviceran që pas mbarimit të luftës dhe duke i çmuar grandet qeveritare që shkojnë në favor të qytetarëve e mbështet dhe e përkrahim me votë. Faleminderit!

KRYETARI: Fidan Jilta nga Grupi Multietnik e ka fjalën.

FIDAN JILTA: Hvala poštovani predsedniče!

Kao Parlamentarna grupa multietnik dajemo podršku razmatranja Nacrta zakona i sporazuma o sufinansiranju projekta.

Program podrške za vodovod i kanalizaciju u ruralnim zonama između Vlade Republike Kosovo i Vlade Švajcarske, imajući u vidu da u našem prostorima gde žive Bošnjaci i drugi ne većinske zajednice imamo slične probleme sa vodom i kanalizacijom. Ja znam se da sa zajedničkom radu naćemo rešenje za ove probleme. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Por, në sallë i kemi vetëm 75 deputetë, megjithatë 76, dhe është me të vërtetë dëshpëruese, sepse seancën e filluam me 82 deputetë. Kështu që të shpresojmë që nuk është ai fenomeni i shëmtuar të vijnë e vetëm të nënshkruajnë për mëditje. Këto nuk janë marrëveshje partiake, këto janë marrëveshje në të mirë të qytetarëve të Kosovës, grupet parlamentare të gjithë i mbështetën ato pa asnjë dallim, kështu që deputetët që ndodhen në afërsi të Kuvendit apo në hapësirat tjera i lutim që të vijnë dhe të votojnë.

Kalojmë te marrëveshja tjetër, së paku që ta prezantojë ministri e ta dimë se për çfarë po bëhet fjalë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-031 për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit “Projekti Emergjent i Kosovës për COVID-19 - Financim shtesë”, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Buxhet, Punë dhe Transfere e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit i ka rekomanduar që ky projektligj të miratohet. E ftoj ministrin e Financave sërish Hekuran Murati, që ta paraqesë dhe arsyetojë këtë projektligj.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Duke pasur për qëllim adresimin e krizës së shkaktuar nga pandemia COVID-19 në sektorin e shëndetësisë, ne si Ministri e Financave, Punës dhe Transfereve pas negociatave dhe dakordimit me Asociacionin Ndërkombëtar për Zhvillim, që është pjesë e Bankës Botërore, kemi nënshkruar Marrëveshjen e financimit “Projekti Emergjent i Kosovës për COVID-19, financimi shtesë”.

Kjo marrëveshje ka vlerën totale prej 15 milionë euro dhe vjen si vazhdimësi e marrëveshjes bazë, të nënshkruar më 29 qershor të vitit të kaluar, e cila ka pasur për qëllim ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për reagimin ndaj pandemisë COVID-19. Marrëveshja bazë kishte vlerën 46 milionë euro, kurse financimi shtesë tani kap vlerën 15 milionë euro. Përmes kësaj marrëveshjeje do të mbështetet sektori publik shëndetësor dhe qëllimi kryesor mbetet vazhdimësia e përgjigjes ndaj pandemisë përmes financimit dhe ndihmës ndaj sistemit të shëndetit publik në Republikën e Kosovës.

Si pjesë e marrëveshjes fillimisht mbulohet përgjigja emergjente për COVID-19. Kjo përfshin forcimin e kapaciteteve për zbulimin, konfirmimin, raportimin dhe monitorimin e kontakteve të hershme të rasteve me COVID-19, pra forcimin e sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve dhe laboratorëve të shëndetit publik, si dhe pajisjen e laboratorëve të shëndetit publik me mjete diagnostikuese dhe materiale tjera konsumuese.

Si vazhdimësi, gjithashtu me këtë kredi mundësohet forcimi i kapacitetit shëndetësor, duke përfshirë sigurimin e trajnimit dhe udhëzimeve të përshtatura për punonjësit e kujdesit shëndetësor, sigurimin e pajisjeve mjekësore përfshirë pajisjet për diagnostikimin e COVID-19, renovimi dhe zgjerimi i klinikës së sëmundjeve infektive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës brenda hapësirës së saj ekzistuese për të përmbushur kërkesën e pritur për kujdes spitalor dhe kujdes intensiv. Gjithashtu, në këtë pjesë hyjnë edhe mbështetja për shërbimet bazike shëndetësore përmes prokurimit të barnave esenciale emergjente, në listën esenciale të barnave dhe pajisjeve medicinale, që do t’u ofrohen institucioneve shëndetësore për trajtimin e rasteve me COVID-19 dhe me gjendje të ngjashme.

Me anë të kësaj marrëveshjeje përfshihet edhe mundësia për prokurim dhe distribuim të vaksinave, që përfshin mbështetjen e sektorit shëndetësor të Kosovës në blerjen e vaksinës përmes Projektit COVID-19, si dhe forcimin e kornizës institucionale të Kosovës, në mënyrë që të mundësohet distribuimi i sigurt dhe efektiv i vaksinave. Si rrjedhojë, rol të rëndësishëm do të ketë edhe mundësia për shfrytëzimin e këtyre mjeteve për përmirësimin e sistemit të imunizimit në Kosovë dhe kapacitetit të ofrimit të shërbimeve përmes fushatave të komunikimit, forcimit të sistemeve të teknologjisë informative dhe shërbimeve të shpërndarjes, duke përfshirë ndër të tjera zhvillimin e një sistemi elektronik të mbikëqyrjes për sëmundjet infektive me fokus COVID-19, përditësimin e sistemit informativ shëndetësor të Kosovës në objektet e kujdesit

parësor shëndetësor dhe mbështetjen e zbatimit për një sistem monitorimi të efekteve anësore pas vaksinale.

Sa i përket kushteve të financimit, këto janë si në vijim: maturiteti është 30 vite, ku 5 vjet nga to janë greis-periudhë; interesi është në mes të 1,25 dhe 2%, varësisht pra prej tarifave të zotimit se si mund të sillen dhe shpejtësisë së disbursimit të mjeteve dhe duke konsideruar, pra marrë parasysh kushtet e volitshme dhe kemi të bëjmë me një marrëveshje me kushte të buta, si dhe nevojën emergjente për të mbështetur sektorin e shëndetësisë, kërkoj nga ju që sot ta mbështesni këtë projektligj, në mënyrë që Ministria e Shëndetësisë të ketë fonde dhe mjete të nevojshme në luftën kundër pandemisë COVID-19. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë. Tash e ftojme kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet, deputetin Armend Muja, që ta arsyetojë raportin e këtij komisioni.

ARMEND MUJA: Mirë! Atëherë, i nderuar kryetar, komisioni e ka trajtuar edhe këtë projektligj dhe në fakt me shumicën e votave e ka mbështetur e po ashtu, i ka rekomanduar këtij Kuvendi dhe deputetëve, që të njëjtin ta votojnë.

Pastaj, po vazhdoj pak edhe në kuptim të rolit tim të... po flas në emër të grupit parlamentar. Kryetar i Kuvendit, ne e mbështetim këtë projektligj dhe po ashtu, i bëjmë thirrje edhe grupeve parlamentare për disa arsye.

Arsyeja e parë është se një projektligj i tillë, po edhe financimi, ka qenë po ashtu i paraparë në kuadër të Buxhetit të Ligjit për ndarje buxhetore të vitit 2021 edhe më herët, pra në kuadër të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve ka qenë i paraparë.

E dyta është, kemi po ashtu një histori konsensusi sa u përket financimeve shtesë edhe në sesionin paraprak, kështu që i kërkoj opozitës që ta vazhdojë këtë traditë.

E treta është, mbi të gjitha trajton kërkesa parësore sa u përket mjeteve të punës së barnave dhe trajnimit të stafit në luftën tonë kundër pandemisë COVID-19. Unë mendoj se Kosova është duke u bërë si shembull në Rajon për administrimin e kësaj pandemie të vështirë dhe na duhet energjia dhe kontributi i të gjitha forcave politike për t'ia dalë mbanë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën nga Partia Demokratike e ka kryetari i këtij grupi, Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do ta mbështesë këtë marrëveshje, pra sa i përket përkrahjes së këtij projekti emergjent për Republikën e Kosovës, pra që lidhet me çështjen e

pandemisë COVID-19. Është hera e dytë që ne e përkrahim këtë Qeveri në një projekt të tillë, që ndërlidhet pikërisht me menaxhimin e pandemisë. Ka qenë edhe marrëveshje në sesionin pranveror, të cilën e kemi votuar. Po e votojmë prapë edhe këtë marrëveshje, pavarësisht që Republika e Kosovës ka pësuar një dëm jashtëzakonisht të madhe në humbjen e jetës së njerëzve gjatë dy muajve të fundit, gjatë muajit gusht dhe gjysmës së muajit shtator. Pra, kemi përjetuar një ankth të vërtet dhe kemi pasur një numër jashtëzakonisht të madh të vdekjeve dhe mund të them lirisht, nga ato që kam mundur të nxjerr prej statistikave, jemi vendi që kemi pasur vdekje më së shumti për kokë banori, edhe në rajonin tonë, edhe mund të krahasohemi me Bashkimin Evropian.

Është lajm i mirë që tashmë një ministër, i cili s'arriti as për së afërmi ta menaxhonte një pandemi siç duhet, ka dhënë dorëheqje, është larguar. Shpresojmë që ministrat që do të vijnë, do të japin në efektivitet më të madh dhe ne kur është në pyetje shëndeti i qytetarëve, gjithmonë do t'i përkrahim në cilëndo marrëveshje, sepse nuk i bëhemi opozitë projekteve që ndërlidhen direkt me mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Prandaj, ne ende s'kemi dalë nga ky rrezik dhe nuk e dimë në të ardhmen me çfarë lloj virusi do të ballafaqohet vendi ynë, cili do të jetë ai mutacioni i ri që do të mund ta godasë, si vendin tonë, si mbarë Botën, dhe mendoj që pikërisht për këtë Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të jetë më e vetëdijshme, më e vëmendshme dhe të marrë mësim nga dështimet e ministrit paraprak, të ketë një angazhim shumë më të fuqishëm në ngritjen e kapaciteteve, sepse sikurse ne që jemi zënë të befasuar dhe e gjithë bota, prapë mendoj që nuk duhet të rrinë neglizhentë, siç kanë ndenjur tre muajt e fundit, pavarësisht kërkesave që i kemi pasur në vazhdimësi që nga qershori, korriku, gjatë sesionit pranveror, që të merren masa dhe të kemi një menaxhim më të mirë të pandemisë. Askush s'e kemi ditur që mund të ballafaqohemi me variantin e ri të virusit COVID, pra variantin Delta, dhe askush nuk e dimë se me çfarë do të ballafaqohemi në të ardhmen. Por, ajo që e dimë është se nuk kemi parë angazhim të duhur të Qeverisë, pavarësisht vullnetit tonë si opozitë për t'i dhënë mbështetje.

Andaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do ta mbështesë me votë këtë marrëveshje dhe shpresojmë që Qeveria jonë të kthjelllet pak dhe ta ketë prioritet shëndetin e qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën nga Lidhja Demokratike e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Zakonisht marrëveshjet që kanë obligime financiare mendoj që specifikimi duhet të jetë më i saktë dhe më korrekt. Atë që e deklaroi ministri i Financave është pjesa bazë, ose bazike, e negociimit fillestar të kësaj marrëveshjeje dhe ratifikimit të saj dhe shpenzimit të 46 milionëve për nevoja emergjente.

Pjesa tjetër shtesë duhet të jetë, sigurisht se ministria e ka dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa duhet ta kishte në projekte konkrete, edhe pse vetë emërtimi “emergjent” kërkona qasje proaktive dhe emergjente, është e vërtetë, që të mos ndodhë ajo çfarë na ka ndodhur me variantin Delta, ku pasojat tash dihen dhe numri i qytetarëve që kanë humbur këtë betejë ka qenë ekstremisht i madh.

Andaj, specifikimet duhet të ekzistojnë sepse janë me kosto, janë me interes, por mendoj që disa që i tha edhe ministri janë të përmbushura, por absolutisht se është e rëndësishme përkrahja dhe ngritja e kapaciteteve, sidomos të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe instituteve rajonale, mbi të gjitha edhe të Klinikës Infektive, edhe pse shumë çka që e tha edhe ministri janë të përfunduara. Por, qasja inovative dhe përcjellja e virusit dhe luftës ndaj COVID-19 mbetet obligim primar dhe duhet të jetë një ndër top-prioritetet, që ndërlihet edhe me zhvillimin e ekonomisë.

Grupi Parlamentar sigurisht se e përkrah, por do të kërkoj nga pjesa e komisionit apo obligimet që janë buxhetore të shihen saktë projektet investuese, afatet, kërkesat dhe nevojat që janë në këtë investim shtesë, sepse me të drejtë e tha edhe kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, një pjesë aty ka qenë si pjesë buxhetore, është thënë se do të jetë një pjesë për mbulimin e kostos së vaksinave dhe neve na intereson saktë se ku po shkojnë dhe ku liferohen këto pagesa. Absolutisht, që jemi pro mbështetjes apo edhe një zgjerimi të frontit të përbashkët deri në eliminimin e plotë të pandemisë COVID-19. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tash nga AAK-ja, fjalën e ka deputeti Palë Lekaj.

PALË LEKAJ: Faleminderit, kryetar!

Ne si Grup Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës duke u nisur që Kosova ka përjetuar një periudhë bukur të vështirë edhe në shërbime shëndetësore, por edhe humbjen e jetëve të qytetarëve tanë, ne e kemi kuptuar drejt dhe do ta përkrahim. Por, mendoj se ka ardhur koha që punëtori shëndetësor, mjekët, stafi i mesëm, të trajtohen ashtu siç e meritojnë dhe në këtë drejtim unë kërkoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës që Ligji për paga të vijë sa më shpejt, që me të vërtetë mjekët të mos marrin lëmshë, as stafi i mesëm, por të trajtohen ashtu siç e meritojnë.

Dhe si përfundim, ne si grup parlamentar e mbështesim këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Bekim Haxhiu e ka kërkuar fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi të vetëdijshëm për situatën e rëndë nëpër të cilën ka kaluar vendi, por gjithsesi edhe prezencën e virusit ende në Kosovë dhe pandeminë në të cilën ndodhemi. Situatë të tillë normalisht që mbështetja për projekte të tilla është më se e domosdoshme, mirëpo para se të votojmë për çdo projekt do të ishte mirë të shikojmë pak për pasojat të cilat u shkaktuan.

Tani dua të rris vëmendjen edhe për një kthim prapa në Ministrinë e Shëndetësisë në kuadër të UNMIK-ut. Unë nuk e kuptoj se si mundet Ministria e Shëndetësisë duke e pasur një infrastrukturë të administratës complete me njësitë e saj administrative të rregulluara, t'ia bartë përgjegjësitë UNOPS-it. UNOPS-i sot në Ministrinë e Shëndetësisë i zhvillon aktivitetet e prokurimit dhe shërbimin e menaxhimit të projekteve. Kjo është shkelje e Ligjit të shëndetësisë, është shkelje e Ligjit të prokurimit, është bartje e përgjegjësisë dhe zhvatje e miliona eurove në kohë pandemie.

Tani blerja shumëfish e barnave më nuk mund të adresohet gishti te Ministria e Shëndetësisë po te UNOPS-i, sepse ministri ia ka bartur përgjegjësinë për blerje të barnave dhe menaxhimin e projekteve UNOPS-it, organizatë e Kombeve të Bashkuara, e UNMIK-ut. Si mund të ndodhë kjo? Unë pyes ku janë prokurorët. Si mundet me nga dy-tri oferta UNOPS-i e ta shmang e-prokurimin? Si mund ta shmangë e-prokurimin Ministria e Shëndetësisë? Cila është përgjegjësia? Pse janë miratuar ato ligje këtu? Cili është qëllimi? Më falni, cili është qëllimi kur një bar që kushton dy euro, blihet nga Ministria e Shëndetësisë tetë euro? Në kohë pandemie. Unë jua kam tërhequr vërejtjen edhe për ato vjedhjet në mandatin e parë. Edhe për vaksinat AstraZeneca, e për të cilat edhe ka filluar procesi i hetimit për ministrin e Shëndetësisë. Nuk mund të shkelet mbi ligjin kështu edhe të vini të kërkonin projekte milionëshe këtu e t'i zhvatni përmes UNMIK-ut atje.

KRYETARI: Ministri Murati e ka fjalën.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, kryetar!

Dua t'i falënderoj të gjitha grupet parlamentare pra për shprehjes e mbështetjes për këtë projektligj, kurse për të adresuar fjalimin e deputetit pra parafolës që ishte, UNOPS-i është paraparë si opsion alternativ për prokurime meqenëse deri më tani pra është parë që ka rezultuar, sipas informatave që kemi marrë nga Ministria e Shëndetësisë për një reduktim për barna specifike, kur është bërë prokurimi i barnave prej 30 deri 70 për qind në reduktim të çmimeve që kanë qenë paraprake. Pra d.m.th. bëhet fjalë për një stopim apo pengim të kartelit farmaceutik nëse mund ta quajë ashtu që në të kaluarën edhe ka mund të ketë marrëveshje për çmimet disa kompani për t'ia faturuar Ministrisë së Shëndetësisë më shtrenjtë sesa që është vlera e tregut.

Tash e kuptoj që për dikë mund të jetë shqetësim ndërprerja e praktikave të tilla dhe mund të ketë ankesa, mirëpo po besoj që kjo është në të mirën e qytetarëve, marrë parasysh që rezultati është se çmimet janë 30 deri 70 për qind më lirë sesa që janë prokuruar më herët.

Sa u përket procedurave, ato po besoj e dini që marrëveshja ndërkombëtare i mbivendoset legjislacionit vendor, meqenëse ratifikohet me dy të tretat në Kuvend. Mirëpo, duhet të flasim për rezultatin. Pra, rezultati është ky: qytetarët paguajnë më lirë për ato barna dhe për ato pajisje për shkak të këtij aranzhimi. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Bekim Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: I nderuar ministër,

Po besoj që e dini që në kohën kur PDK-ja ka udhëhequr me Ministrinë e Shëndetësisë është miratuar udhëzimi administrativ për çmimoren e blerjes së barnave dhe pajisjeve mjekësore ku përfundimisht është ndaluar abuzimi me blerje 300 deri 400 për qind më shtrenjtë dhe ka pasur çmime referente dhe do të duhej t'i nënshtroheshin asaj. Por, është e vërtetë i nderuar ministër, që bartja e përgjegjësisë së prokurimeve nuk është bërë për ta ndaluar zhvatjen, por është bërë për ta centralizuar zhvatjen dhe nuk është bërë për 30-70 për qind më lirë, po nëse ti konsideron që kjo është matematika, nëse një bari prej 2 euro kontraktohet në tetë euro e nëse kjo është 30-70 për qind më lirë veç vazhdoni, qytetarët janë ata që po na shohin edhe mua edhe juve dhe e dinë të gjithë.

Edhe për vjedhjet që kanë ndodhur prej maskave e dorezave deri në thasë të kufomave, kjo s'po ju mjafton, tash ia keni bartur për të vjedhur përmes UNMIK-ut. Edhe nuk e di a është ai UNMIK-u që ka qenë a është ndonjë UNMIK tjetër. A është ai UNOPS-i a është një UNOPS tjetër. Ai UNOPS-i që e keni kritikuar deri sot. Unë s'po e kuptoj. Keni folur shumë për bashkimin kombëtar, e tash po na dilni po na ktheheni në UNMIK. Nëse ju konsideroni që bashkimi kombëtar është edhe tabelat KM, veç vazhdoni, qytetarët po na shohim neve dhe juve.

KRYETARI: Një kundër-replikë, një minutë ministri, dhe po hyjmë në votim. Grupet parlamentare, mobilizohuni se prapë kemi rënë në 78 të pranishëm.

MINISTRI HEKURAN MURATI: D.m.th. kjo vetëm e konfirmon atë që para disa viteve apo muajsh, e ka thënë kryeministri Kurti, që sa herë të preket diku delli i hajnisë, përmendet o Amerika, o bashkimi kombëtar, o Ushtria Çlirimtare. Kjo vetëm sa e konfirmoi atë që e thashë më herët. Është prekur karteli farmaceutik me këtë aranzhman, kështu që normal që disa edhe mund të jenë shqetësuar. Faleminderit!

KRYETARI: Para disa minutave ishim 83 deputetë në sallë dhe një numër i caktuar i deputetëve e lëshuan sallën. Ju lutem grupet parlamentare, shkoni merrini deputetët e juaj në bufe.

Presim derisa z. Dreshaj ta përfundojë bisedën e tij me ministren e Arsimit. Mirë!

Po hyjmë në votime tash. Së pari po e votojmë Projektligjin 08/L-030 për ratifikimin e amendamentimit të Marrëveshjes së bashkëfinancimit për projektin Programi mbështetës për ujësjellës dhe kanalizim në zonat rurale (faza e gjashtë).

Kjo bëhet ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës.

Mbetemi në 81 deputetë të pranishëm. Mirë!

Të nderuar deputetë të pranishëm, ju lus që me ngritje të dorës të deklaroheni për këtë projektligj.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë konstatoj që të gjithë të pranishmit, 81 pro kanë votuar për këtë marrëveshje. Nuk ka kundër dhe abstenim e si rrjedhim pra Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 08/L-030 për ratifikimin e amendamentimit të Marrëveshjes së bashkëfinancimit për Projektin “ Programi mbështetës për ujësjellës dhe kanalizim në zonat rurale faza (dalëse) VI”, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës.

Kalojmë në votimin e marrëveshjes tjetër ndërkombëtare: *Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-031 për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit “Projekti Emergjent i Kosovës për COVID-19 - Financim shtesë”, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim*

82 deputetë tash janë të pranishëm.

Të nderuar deputetë, po ju lus pra që me ngritje të dorës të votojmë ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit “Projekti Emergjent i Kosovës për COVID-19 - Financim shtesë”.

Kush është për këtë marrëveshje? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë konstatoj që me 82 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi Ligjin nr. 08/L-031 për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit “Projekti Emergjent i Kosovës për COVID-19 - Financim shtesë” ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

Po punojmë edhe gjysmë ore para se të shkojmë në pushim, nëse pajtoheni.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve

Të nderuar deputetë,

Komisioni funksional për Legjislacion e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. Komisioni për Buxhet po ashtu e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka vlerësuar se ky projektligj nuk përmban kosto shtesë. Komisioni për Integritet Evropian e ka shqyrtuar Projektligjin dhe ka vlerësuar se projektligji nuk është në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, për të drejtat dhe interesat e Komuniteteve dhe Kthim e ka shqyrtuar projektligjin, por të njëjtin nuk e ka përkrahur.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion, deputetin Adnan Rrustemi që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e këtij Komisioni.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjin nr. 08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe komisioneve të përhershme ua ka dërguar për shqyrtim sipas kompetencës.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere e ka shqyrtuar Projektligjin nr. 08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe ka vlerësuar se projektligji nuk përmban kosto buxhetore shtesë.

Komisioni për Integritet Evropian e ka shqyrtuar Projektligjin për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe ka vlerësuar se projektligji nuk është në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Komisioni për të Drejtat dhe interesat e Komuniteteve dhe Kthim në mbledhjen e mbajtur më 19 korrik e ka shqyrtuar projektligjin dhe i njëjti nuk e ka përkrahur këtë projektligj.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, duke u bazuar në nenin 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22. 9. 2021 vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë për shqyrtim dhe miratim Projektligjin nr. 08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve pa amendamente.

Komisioni për Legjislacion i rekomandon seancës që të miratohet Projektligji nr. 08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve pa amendamente. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deri tash nuk është paraqitur ndokush nga grupet parlamentare. Tash e kemi të paraqitur deputetin Hajdar Beqa nga Partia Demokratike.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar,

Partia Demokratike përmes anëtarëve në komision, gjatë shqyrtimit të parë, por edhe në mes dy leximeve ka dhënë kontributin e vet. Realisht, shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk ka pasur ndonjë ndryshim. Është një ligj i cili realisht nga vetë emri d.m.th. ka të bëjë me përgjegjësi disiplinore, kurse është një ndryshim aty te suspendimi dhe pezullimi dhe është bërë ndryshimi aty ku thuhet te çështja vepra penale dhe disiplinore. Sepse kjo e rregullon më mirë dhe është propozim i Këshillit Prokurorial, realisht ky, i cili ndryshim garanton procesin e zhvillimit të procedurave disiplinore dhe ministria e ka sjellë këtë kërkesë të cilën e kemi përkrahur në komision dhe kërkoj nga kolegët deputetë ta përkrahim edhe tash.

U tha edhe nga raporti i komisionit që s'ka ndonjë kosto, po është një ndryshim teknik që është bërë në ligj e që ndoshta është dashur të jetë nga fillimi. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja ministre e Drejtësisë, a e dëshironi fjalën?

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: I nderuar kryetar!

Vetëm desha ta falënderoj deputetin Beqa për konstruktivitetin në votimin e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Si thua ti, një rast i rrallë ky a po? Pse e thatë? Zoti Beqa, me siguri që dëshiron që ta kthejë falënderimin.

HAJDAR BEQA: Zoti kryetar,

Ministre,

Realisht kur ka qenë plani legjislativ për vitin 2021, kam thënë është plan ambicioz. Fatkeqësisht, deri më tani edhe pse kanë kaluar e jemi në muajin e dhjetë, vetëm dy ligje Komisioni për Legjislacion i ka kaluar këtu.

Fatkeqësisht, të dyja janë ndryshime. Një ndryshim ka ndodhur në Kodin e Procedurës Penale edhe një ndryshim po ndodh sot, i cili, e dini edhe ju, që ka qenë kërkesë e Këshillit. Vetëm nëpërmjet ministrisë ka ardhur në komision, nëpërmjet komisionit po vjen në Parlament dhe po votohet.

Çdo gjë është e mirë, ne e kemi përkrahur edhe kur kemi qenë në pozicione të kundërta, kur ju ishit në opozitë e që bënit zhurmë, ne ishim pozitë. Por, nëse ke pasur propozime të mira edhe si opozitë, i kemi përkrahur në komision. Besoj që në këtë drejtim je e sinqertë. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë shumë! Urojmë që kjo frymë e bukur dhe konstruktive të vazhdojë edhe për çështje të tjera, jo kaq të thjeshta si kjo. Pra, i kemi 69 deputetë, 68 apo? Mirë.

Deputetë të nderuar,

Ju lus që me ngritje të dorës të deklaroheni për këtë projektligj, Projektligji nr.08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon? Në ndërkohë, meqenëse janë bashkuar edhe deputetët e tjerë në seancë, me 70 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi Ligjin nr. 08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Kalojmë në pikën e shtatë të kësaj seance e cila është,

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-029 për punimet nga metalet e çmuara

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe Kuvendit ia rekomanduar miratimin e këtij projektligji në parim.

E ftoj në këtë rast ministren e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, zonjën Rozeta Hajdari që ta paraqesë dhe ta arsyetojë këtë projektligj para Kuvendit.

MINISTRJA ROZETA HAJADARI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar zëvendëskryeministër Bislimi,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Në emër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si bartëse dhe hartues e këtij Projektligji për punimet nga metalet e çmuara, unë sot shkurtimisht po paraqesë arsyen, qëllimin, rëndësinë dhe fushën e rregullimit të këtij projektligji për punimet nga metalet e çmuara.

Arsyeja për hartimin e Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara, është përcaktimi i kushteve, mënyrës dhe veprimit të kontrollit të cilësisë të punimeve të punuara nga metalet e çmuara.

Gjithashtu, në këtë projektligj caktohen kërkesat teknike sipas standardit ISO 9202-2019, me të cilin përcaktohet shkala e pastërtisë, përbërjes dhe përmbajtjes së metaleve të tjera, pjesë prej metaleve jo të çmuara dhe jo metaleve dhe rregullon kushtet dhe mënyrën e ekzaminimit dhe shënjimit në harmonizim me shenjat ndërkombëtarisht të pranuar, si dhe detyrimet mbi shpenzimet për ekzaminimet dhe shënjimin.

Arsye tjetër e hartimit të këtij Projektligji për punimet nga metalet e çmuara, është se do të plotësohej edhe një standard i kërkuar që punimet duhet të kenë një nga shkallët e pastërtisë të përcaktuar me standardin ISO 9202-2019.

Arsye tjetër është emërtimi i sektorit të metaleve të çmuara nuk është i rregulluar me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës, duke krijuar kështu hapësirë të mosfunksionimit normal dhe përcaktimit të drejtë të detyrave dhe mandatit të funksionimit.

Gjithashtu, mos-pajisja e përpunuesit në Republikën e Kosovës me shenjën e përpunuesit, prodhuesit, përpunimet që i përpunojnë vet prodhuesit, shenja e përpunuesit duhet të jetë e autorizuar nga Agjencia e Meteorologjisë e Kosovës, kur dihet se kjo ka krijuar vështirësi në funksionimin e tregut si dhe ka zvogëluar efikasitetin e monitorimit dhe kontrollit adekuat të tij.

Pra, me këtë ligj, punimet kontrollohen dhe shënjohen me shenjën shtetërore para se të vendosen në treg.

Temat brenda këtij ligji nuk janë të harmonizuara, si për shembull, shenja e harmonizimit, shenja shtetërore, duke sjellë konfuzion në interpretim të ligjit. Tutje, masat ndëshkimore të përmendur në këtë projektligj janë të harmonizuara me Ligjin për kundërvajtje, të cilat masa në ligjin aktual kanë qenë të paqarta.

Me ligjin aktual, gjithashtu, ekziston hapësirë për përzierjen e kompetencave mes drejtorit të Meteorologjisë Ligjore dhe sektorit të metalit të çmuara për prishjen e punimeve nga metalet e çmuara, të cilat nuk i plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara me këtë ligj.

Dhe, ky projektligj është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren 9/2011 për punën e Qeverisë së Kosovës dhe është pranuar deklarata financiare nga Ministria e Financave, deklarata e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së, dhe nga ish-Ministria e Integritimit, tani agjenci që është. Po ashtu, projektligji i lartpërmendur është i harmonizuar edhe me “aqui” të BE-së.

Prandaj, duke e pasur parasysh rëndësinë e këtij Projektligji në fushën e punimeve nga metale e çmuara, mbrojtjen e konsumatorit dhe prodhuesve, nga keqpërdorimet e mundshme me cilësinë e punimeve nga metalet e çmuara, dhe duke e pasur parasysh se projektligji i propozuar është draftuar në përputhje me të gjitha standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe evropiane, unë propozoj që të shqyrtoni dhe të miratoni këtë projektligj në këtë seancë. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit, zonja ministre! Tash e ka fjalën kryetari i Komisionit Funkcional për Ekonomi, deputeti Ferat Shala, që ta arsyetojë raportin e këtij komisioni.

FERAT SHALA: Faleminderit, kryetar! Komisioni Parlamentar për Ekonomi ka shqyrtuar në procedurë të rregullt draft-ligjin nr.08/L-029 për përpunimin e metaleve të çmuara, dhe konsiderojmë që është një ligj i nevojshëm për ekonominë tonë, veçanërisht për sektorin e zejtarisë dhe të përpunimit, sektor i cili ka nevojë që të stimulohet dhe të sigurohet me draft-ligjin aktual, por edhe me një pjesë të akteve tjera normative nënligjore që do të rrjedhin pastaj.

Sigurisht që ligji do të krijojë kushte të favorshme për veprimtarinë e përpunuesve të metaleve, do të krijojë favore edhe në sigurinë e tyre, si dhe në legjitimitetin dhe legalitetin e veprimtarisë së tyre dhe produkteve të tyre, me gjithë komponentin e shtetit dhe të Qeverisë, praktikisht.

Në këtë relacion, komisioni parlamentar mbështet njëzëri dhe bëjmë ftesë që ky ligj të miratohet, duke llogaritur që në procese të mëvonshme të dëgjimeve publike me komunitetin e interesuar dhe me ekspertët e tjerë ta japim maksimumin e mundshëm edhe si komision, po edhe si grupe parlamentare. Andaj, edhe kërkojmë që të mbështet. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë. Radha e grupeve parlamentare. Nga Lëvizja Vetëvendosje, deputetja Jeta Stavoci. Ia kaloni fjalën deputetes.

JETA STATOVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne i kemi përcjellë diskutimet në raport me projektligjin në fjalë. Pra, projektligji merr për bazë praktikatat e mira të vendeve të ndryshme. Gjithashtu, e trajton çështjen mbi cilësinë e metaleve, e po ashtu, edhe komponentin mbi pastërtinë e këtyre metaleve.

Njëkohësisht, gjithashtu përmend edhe segmente të cilët kanë qenë problematike deri më tash, për aktorët e përfshirë në këtë industri.

Andaj, ne si grup parlamentar mbështesim këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Nga Partia Demokratike, deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Projektligjin nr.08/L-029 për punimet nga metalet e çmuara, dhe duke mbështetur të gjitha ato që u thanë edhe nga kryetari i Komisionit FunkSIONAL, Partia Demokratike i jep mbështetje këtij projektligji.

KRYETARI: Faleminderit! Përfaqësuesi i AAK-së, deputeti Pal Lekaj e ka fjalën.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar ligjin në fjalë, po ashtu, e kemi trajtuar edhe në komision, dhe i japim mbështetje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministre, nëse e dëshironi fjalën apo të kalojmë në votim? Mirë. Pyesim se sa deputetë janë të pranishëm për momentin, nëse ka kuorum Kuvendi që të hyjmë në votim?

Tre deputetë janë më pak se që na duhet kuorumi. I lusim grupet parlamentare që ta bëjnë edhe një përpjekje të fundit që para se të shkojmë në pushim ta kryejmë këtë votim.

59 deputetë janë aktualisht në sallë, na nevojiten edhe 2 deputetë. Për momentin i kemi 60 deputetë. Tash, nuk ka nevojë kaq shumë, se mos po bëhemi shumë! 70 deputetë u bënë tash.

Të nderuar deputetë të pranishëm,

Ju lus që me ngritje të dorës të deklaroheni për këtë projektligj. Pra, Projektligji nr. 08/L-029 për punimet nga metalet e çmuara.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, konstatoj që me 71 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi në parim Projektligjin nr. 08/L-029 për punimet nga metalet e çmuara.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë sipas Rregullores së Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

I kemi përfunduar 7 pika të rendit të ditës së kësaj seance. Na kanë mbetur edhe 5 të tjera, të cilat po synojmë që t'i përfundojmë në pjesën tjetër të ditës.

Tash, po e shpallim pushim deri në orën 15:00. Faleminderit!

* * *

Vazhdim i mbledhjes plenare, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Po e vazhdojmë seancën e sotme.

8. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit për vitet 2021-2025

Të nderuar deputetë,
Komisioni Funkcional për Integrim Evropian e ka shqyrtuar Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociimit për vitet 2021-2025 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e këtij programi.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi, që ta paraqesë dhe të arsyetojë Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit për këto vite, 2021-2025.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BESNIK BISLIMI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë dhe deputete të Kuvendit të Kosovës,

Më lejoni të paraqes para jush për miratim Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së për periudhën 2021-2025.

Ky program është dokumenti kryesor strategjik kombëtar për zbatimin e agjendës evropiane.

Qëllimi i Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit është zbatimi i detyrimeve të MSA-së dhe reformave të tjera për integrim në BE përmes përafrimit të legjislacionit vendor me “acquis communautaire” të BE-së dhe zbatimit të këtij legjislacioni, me fokus në reformë të politikave, reformë institucionale dhe ngritjes së kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për zbatim si dhe zbatimit në praktikë të legjislacionit dhe politikave të reformuara.

Këto reforma mbulojnë fushat e kritereve politike, atyre ekonomike dhe të “acquis communautaire”, pra janë në kuadër të kapitujve në tri blloqe.

Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së përmban gjithsej 242 masa afatshkurtra, prej tyre 109 masa legjislative dhe 133 masa zbatuese si dhe objektiva prioritare afatmesme.

Kostoja totale e zbatimit të programit për këtë vit është vlerësuar të jetë 47 milionë e 676 mijë e 792 euro, prej të cilave 44 milionë e 931 mijë e 171 euro janë nga buxheti shtetëror dhe 2 milionë e 745 mijë e 621 euro nga mbështetja e donatorëve, ku janë kryesisht Bashkimi Evropian dhe donatorët bilateralë.

Ky dokument nuk ka asnjë vakum buxhetor.

Masat afatshkurtra janë në pajtim me kornizën kohore të zbatimit të MSA-së, ato gjithashtu janë të ndërlidhura me konkluzionet të dala nga organet e Stabilizim-Asociimit, agjendën për reforma evropiane si dhe programin për reforma ekonomike.

Ky program është harmonizuar edhe me planet strategjike operationale të Zyrës së kryeministrit dhe ministrive të linjës, përfshirë edhe programin legjislativ të Qeverisë.

Hartimi i programit është udhëhequr nga departamentet për Integrim Evropian në kuadër të Zyrës së kryeministrit, si institucioni kryesor koordinues, në bashkëpunim me ministrinë dhe institucione të tjera përgjegjëse për secilin kapitull.

Më lejoni gjithashtu të nënvizoj rëndësinë e zbatimit të programit gjatë këtij viti dhe në ndërlidhje me Programin IPA 2 për mbështetje direkte buxhetore për reformën e administratës publike.

Kjo pasi që në kuadër të këtij programi kemi paraparë zbatimin e të paktën 80% të programit për këtë vit. Marrë parasysh rëndësinë e këtij dokumentit për zbatimin e MSA-së, ju propozoj që të njëjtin ta miratoni dhe për këtë ju falënderoj. Faleminderit!

KRYETARI: Ia japim fjalën deputetes Rrezarta Krasniqi, e cila është kryetare e Komisionit për Integrim Evropian, që ta arsyetojë raportin e këtij komisioni.

RREZARTA KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Integrim Evropian, si Komision Funkcional për shqyrtimin e këtij programi, në mbledhjen e mbajtur më 24 shtator 2021 ka shqyrtuar programin dhe të njëjtin e ka rekomanduar për miratim në seancë plenare.

Të nderuar kolegë deputetë,

Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së paraqet një kornizë gjithëpërfshirëse të reformave konkrete afatshkurtra dhe objektiva prioritare afatmesme, me prioritet për periudhën 2021-2025 për zbatimin e MSA-së përmes përafrimit të legjislacionit kombëtarë me atë të BE-së dhe zbatimit të legjislacionit të përafruar.

Bazuar në strukturën e kritereve të Kopenhagës dhe të MSA-së, të gjitha masat e prioritetit janë të ndara në tri blloqe: kriteret politike, kriteret ekonomike dhe standardet evropiane.

Po ashtu secili kapitull është ndarë në dy pjesë, pjesa e përshkruese dhe matrica e masave afatshkurtra.

Pjesa përshkruese përmbledh detyrimet e MSA-së dhe detyrimet nga mekanizmat e tjerë të aderimit të BE-së, gjendjen aktuale dhe objektivat e prioritetëve afatmesme.

Matrica e masave afatshkurtra përmban masat konkrete që do të ndërmerren për zbatimin në reforma, të ndara në dy kategori: masat legislative dhe masat zbatuese.

Lidhur me këtë program secili organ i administratës shtetërore do të jetë përgjegjës për zbatimin e tij në kuadër të fushëveprimit dhe kompetencave të tij.

Të nderuar kolegë deputetë,

Rol shumë të rëndësishëm jo vetëm në mbikëqyrjen e përmbushjes së obligimeve, por edhe përmbushjen e tyre ka edhe Kuvendi i Kosovës, përkatësisht komisionet e Kuvendit. Prandaj, me qëllim të përmbushjes së obligimeve që kemi në raport me këtë dokument si dhe me qëllim të mbikëqyrjes së përmbushjes së obligimeve nga ana e institucioneve në përgjithësi, ftoj kolegët e mi deputetë që secili në komisionet e tyre respektive të angazhohen në mbikëqyrjen e përmbushjes së këtyre obligimeve, sepse nga përmbushja e këtyre obligimeve varet edhe avancimi ynë në procesin e integritimit evropian. Faleminderit!

KRYETARI: Tash është radha e grupeve parlamentare. Nga Lëvizja Vetëvendosje fjalën ia kalojmë deputetes Arbëresha Kryeziu-Hyseni.

ARBËRESHA KRYEZIU-HYSENI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Dhe për ju kolegë deputetë,

Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit është dokumenti më i rëndësishëm për shtetin e Kosovës, përmes të cilit Qeveria e Kosovës merr përsipër zbatimin e detyrimeve që dalin nga MSA-ja.

Është programi i gjashtë me radhë që vjen si marrëveshje kontraktuale në mes të BE-së dhe Kosovës dhe që ka një gamë të gjerë të fushave që përfshihen në kuadër të këtij dokumenti.

PKZMSA përmban disa reforma që karakterizohen si afatshkurtra dhe që përfshijnë vitin 2021 si dhe objektiva prioritare afatmesme që mendohet që deri në fund të vitit 2025 të arrijnë përmbushjen e detyrimeve të tyre.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje mbulohet drejtësia, punët e brendshme, arsimi, tregtia, punësimi, energjia, mjedisi e të tjerë dhe qëllimi është që Qeveria e Kosovës të angazhohet në maksimum, në mënyrë që zbatueshmëria e detyrimeve që burojnë nga MSA të jetë në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, reforma këto që janë kërkesë e BE-së karshi nesh si shtet që synojmë anëtarësim në të.

Në prillin e vitit të kaluar u bënë pesë vjet nga hyrja në fuqi e MSA-së, zotimi i Kosovës para BE-së ishte që brenda një periudhe prej 10 vjetësh të zbatojë të gjitha dispozitat e MSA-së, në mënyrë që t'i hapim rrugë vetes drejt integritimit në BE. Por fatkeqësisht qasja e qeverive të kaluara dhe moszbatimi i reformave ka penguar avancimin tonë si shtet, përfshirë këtu edhe uljen e numrit të masave që kanë shkaktuar performansë të keqe.

MSA-ja ka obliguar Kosovën që të bëjë reforma në sektorin e sundimit të ligjit, ku është përfshirë luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe rezultatet e dhëna përgjatë dy qeverive, Kurti në këtë drejtim ka ndezur dritën jeshile sa u përket hapave konkretë që si shtet është dashur të bëhen në këtë drejtim.

Shqyrtimi i këtij dokumenti kaq të rëndësishëm, siç është PKZMSA-ja ka ardhur për miratim në Kuvend, pasi që Qeveria Kurti 2 e ka përshtatur atë edhe me prioritetet e saj.

Ne si grup parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e përkrahim, sepse masat e përcaktuara e përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve dhe e anëtarësojnë shtetin tonë drejt Bashkimit Evropian. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Partia Demokratike, fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në fakt, ne po diskutojmë sot një dokument tejet të rëndësishëm që është kontrata e parë ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe natyrisht ka një rëndësi të veçantë. Përderisa ne nuk kemi një qasje të veçantë e asnjë qasje serioze të kësaj qeverie në raport me procesin e integritimeve evropiane.

Ju e dini që ne e kemi ngritur disa herë çështjen e mungesës së Ministrisë së Integritimeve Evropiane, përderisa ne kemi një komision të përhershëm të Kuvendit, i cili natyrisht i raporton zëvendëskryeministrit që vjen herë për dialog, herë vjen që të diskutojë për çështjen e proceseve integruese.

Sidoqoftë, kjo po dëshmon edhe një herë që nuk është fare prioritet i kësaj Qeverie agjenda integruese dhe Kosova asnjëherë nuk ka qenë më e shthurur në raportet e saj me përfaqësues të Bashkimit Evropian.

Zoti kryetar,

Ne kemi diskutuar në komision, për dallim prej partisë, e cila dikur ka qenë në opozitë, e që nuk e ka votuar asnjëherë në komision këtë dokument të rëndësishëm të Marrëveshjes tonë me Bashkimin Evropian, ne kemi votuar, ndonëse e përfaqësojmë opozitën, jemi të vetëdijshëm se çka do të thotë procesi integrues për një shtet si Kosova dhe e ka marrë votën e opozitës në Komision për Integritet.

Si do qoftë ne kemi pasur edhe në komision vërejtjet tona, e kemi miratuar dokumentin, por do t'i përmend shkarazi disa prej çështjeve, të cilat i kam adresuar edhe në komision sa ka qenë zëvendëskryeministri Bislimi.

Pra Programi Kombëtar për Zbatim të Marrëveshjes Stabilizim Asociimit që është miratuar së fundi në Qeveri, e kam thënë edhe në komision se nuk u është nënshtruar plotësisht kriterëve dhe standardeve të konsultimit publik, duke qenë se hartimi i këtij dokumenti nuk është bërë në pajtim të plotë me Rregulloren për standardet minimale për procesin e konsultimit publik. Ky edhe një herë është një indikacion i qartë për një qasje jo të duhur dhe jo të hapur të qeverisë, e veçanërisht me hapin që do të duhej edhe Kuvendi t'u bëjë organizatave të shoqërisë civile që adresohen edhe në këtë dokument të rëndësishëm, do të thonë nëse vetëm i referohemi vitit 2019, rreth 75% të organizatave të shoqërisë civile nuk janë ftuar asnjëherë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për të marrë pjesë në trupa të përbashkët punues dhe këtë e parasheh dokumenti, kjo është vërejtje për ne, në fakt.

Aty thuhet se bashkëpunimi i Kuvendit me shoqërinë civile mbetet i kufizuar, pasi që shumë organizata të shoqërisë civile nuk kanë pasur mundësinë që të bëhen trupa të Kuvendit, janë 2-3 komisione tash së fundi që e kanë hapur këtë mundësi dhe mendoj që është një rast i mirë që organizatat e shoqërisë civile të ftohen dhe të jenë aktorë në procesin e punës tonë si Parlament.

PKZMSA-ja i kërkon Kuvendit emërimin e anëtarëve të bordit të institucioneve të pavarura bazuar në meritokraci e në profesionalizëm, për të shmangur kështu emërimet politike, duke përmendur kështu edhe një memorandum që ne si Kuvend e kemi me Mbretërinë e Bashkuar dhe një gjë e tillë është absurde, ju e dini.

Të nderuar kolegë deputetë,

Që Qeveria përgjatë gjashtë muajve të saj nuk ka lënë bord e s'ka lënë agjenci të pavarur pa e mbushur me të afërm, pa e mbushur me familjarë, me dajë, me nipa e me mbesa.

Prandaj, që në start ne këtu e shohim që po e shkelim me dy këmbë një dokument i cili nuk u duhet vetëm raporteve tona me Bashkimin Evropian, por në radhë të parë i duhet shtetit tonë.

Për më tepër, neni 120 i MSA-së e thekson domosdoshmërinë e ndërtimit të institucioneve, duke përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e procedurave të rekrutimit të bazuara në merita, të bazuara në transparencë dhe të bazuara në paanshmëri.

PKZMSA-ja parasheh reformën e sistemit zgjedhor, si një ndër prioritetet kryesore të Kuvendit, duke synuar kështu edhe rritjen e kontrollit financiar të partive politike, zgjatjen e afateve për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme, aplikimin për votim jashtë vendit.

Dy dokument parasheh një komision ad-hoc në Kuvend për ndryshimin e Ligjit për zgjedhjet të përgjithshme dhe Ligjin për financimin e partive politike.

Kolegë deputetë,

Ju e dini që në start të kësaj legjislature ne kemi pasur një tendencë të partive në pushtet që të sjellin ndryshimet në Ligjin zgjedhor, me një qasje tërësisht të përjashtuar për shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë. Për më tepër, opozita e ka kundërshtuar që në start, edhe kjo është një shkelje e këtij dokumenti dhe parimeve tona për një shtet ligjor dhe për një ligj që do t'i mundësonte Kosovës zgjedhje të lira, fer dhe demokratike.

Mbetet obligim i Kuvendit të Kosovës që përmes plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimit të sigurisë, po ashtu që të themelojë Agjencinë për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar si autoritet i Sigurisë Kombëtare.

Ne e kemi një komision përkatës parlamentar për siguri që do të jetë mekanizëm mbikëqyrës i kësaj agjencie dhe të njëjtit nuk do t'i nënshtrohen verifikimit të sigurisë.

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën thekson sërish se mbikëqyrja parlamentare e Forcave të Sigurisë së Kosovës dhe Agjencisë Kosovare për Inteligjencë vazhdon të jetë e pamjaftueshme, këtë e përmend PKZMSA-ja.

Po ashtu thuhet se anëtarësimi i Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare mbetet ndër prioritetet parësore të Qeverisë së Kosovës, në fakt, kolegë deputetë, realiteti është tërësisht ndryshe, sepse zyrtarë qeveritarë kanë suspenduar Kushtetutën dhe subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës, duke abstenuar nga e drejta për aplikim në organizata e agjenci ndërkombëtare, duke përfshirë këtu edhe UNESKO-n.

Gjithashtu, sipas PKZMSA-së, është thelbësore që Kosova të vazhdojë zbatimin në mirëbesim të të gjitha marrëveshjeve të arritura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Një çështje tjetër është se bashkëpunimi rajonal do të thotë në kuadër të dialogut politik që do të duhej të promovojë bashkëpunim rajonal efektiv gjithëpërfshirës. Kosova zotohet të vazhdojë nxitjen e bashkëpunimit dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë në rajon, duke përfshirë një rol të përshtatshëm të koncesioneve të ndërsjella.

Në pjesën tjetër flitet për infrastrukturën hekurudhore. Po ashtu flitet për projektin e linjës hekurudhore me Serbinë. Pra, nuk flitet për lidhjen hekurudhore me Durrësin ashtu siç po pretendon ministri i Infrastrukturës, zoti Aliu.

PKZMSA-ja po ashtu merret me lirinë e shprehjes e konstaton se është bërë përparim i kufizuar në adresimin e rekomandimeve të raportit të mëhershëm të Komisionit Evropian, duke e cilësuar si shqetësuese kërcënimin ndaj gazetarëve.

Kosova ka vazhduar të jetë e përfshirë nga një ambient i rëndë, i cenimit të lirisë së shprehjes dhe i një lufte të pakompromis ndaj atyre që promovojnë fjalën e lirë dhe prapë kjo bie ndesh me zotimet tona që i kemi bërë lidhur e këtë marrëveshje.

Pikë e rëndësishme e MSA-së është edhe energjia, ku detyrohet Kosova për të përafuar legjislacionin e saj me sektorin e energjisë të BE-së.

Diversifikimi i burimeve të energjisë, burimet e ripërtëritshme dhe zbutja e ndikimit mjedisor të dëmshëm nga prodhimi dhe konsumimi i energjisë, janë objektiva të cilat Kosova duhet t'i arrijë.

Ne po ashtu kemi edhe një aspekt tjetër, do të thotë që, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë çdo vit nga pasojat e ajrit të ndotur në botë vdesin rreth 7 milionë njerëz dhe kur dihet se në atë 6% e prodhimit të energjisë në Kosovë mbulohet nga termocentralet me bazë thëngjillin dhe linjitin, atëherë situata vazhdon të jetë tejet e rënduar dhe kërkohet reagim edhe vizion i qartë i Qeverisë, të cilin ne nuk po e shohim në horizont.

Ne kemi pasur zëvendëskryeministrin në komision për të diskutuar edhe për çështjen e gazit. Ku ai, në fakt, lidhur me projektin e Kosovës me investimin e MCC-së, fondeve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe zoti Bislimi e thotë një të pavërtetë të madhe rreth projektit të gazifikimit të Kosovës, duke deklaruar se gazi vjen në Maqedoni të Veriut nga Rusia, Azerbejxhani, pra nuk është gaz amerikan, pra është pak e çuditshme se çfarë deklaroi njeriu i dytë i qeverisë.

Ndërkohë që ne sot e kemi parë, në fakt para disa ditësh kryeministrin në seancë të Kuvendit, ku deklarohet se nuk është e thënë se ne do të duhet të marrim gazin nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Atëherë krejt çka mund të themi është se kjo Qeveri është thjesht duke i bërë dëm të pariparueshëm raporteve tona me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pra, gazsjellësin Trans Adriatik, i ashtuquajturit TAP, është antipod i Gazpromit rus në aspektin politik, në atë ekonomik dhe në atë të sigurisë.

Vetëm shtetet e Ballkanit Perëndimor gjatë një viti deri më tani kanë blerë gaz rus rreth 10 miliardë metër kub. Kjo gjendje me futjen e sistemit të TAP-it do të përgjysmohet dhe çmimi i gazit rus do të bie për 100 dollarë për 1000 metër kub gaz.

Qeveria gjithashtu e ka përçmuar në këtë rast përkushtimin dhe përcaktimin amerikan për ndarjen e 200 milionë dollarëve në kuadër të MCC-së për gazifikimin e Kosovës. Pra, është indikator i qartë se kjo Qeveri thjesht po deklarohet kundër raporteve tona fundamentale me aleatët tonë dhe kundër interesit të Kosovës.

Janë edhe disa pika të tjera, të cilat ne i kemi diskutuar në Komision për Integritet. Megjithatë unë do të ndalem këtu dhe po e them që për shkak të rëndësisë së këtij dokumenti të rëndësishëm, ne kemi dhënë votën tonë si parti opozitare...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Nga AAK-ja fjalën e ka deputeti Shemsedin Dreshaj.

SHEMSEDIN DRESHAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kur debatohen dokumentet të këtilla me rëndësi të veçantë për vendin dhe për integritetin, mendoj që është vendi që këtu kjo sallë të jetë plot dhe njëkohësisht e tërë Qeveria të jetë e pranishme.

Kjo edhe një herë dëshmon seriozitetin tonë që kemi në punë këtu dhe peshën që u japim integriteteve dhe zhvillimit përpara drejt Bashkimit Evropian të vendit tonë.

Përkundër të gjitha mangësive të shprehura deri më tani, ne si Grup Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do ta mbështesim këtë marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, fjalën e ka deputetja Vlora Dumoshi.

VLORA DUMOSHI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Programin Kombëtar të Zbatimit të MSA-së, rekomanduar për miratim në këtë seancë plenare nga Komisioni për Integritet Evropian.

Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah miratimin e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Tash nëse zëvendëskryeministri nuk e do fjalën, në shenjë falënderimi për juve që po e votoni këtë program, na nevojitet vetëm ta dimë numrin e deputetëve që janë të pranishëm dhe po hyjmë në votim.

63 deputetë janë të pranishëm në sallë.

Deputetë të nderuar, ju lus që me ngritje të dorës të deklarohen lidhur me Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për vitet 2021-2025.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, më informojnë që të gjithë deputetët, të cilët janë të pranishëm në sallë, 63, kanë votuar për, asnjë votë nuk është kundër, asnjë votë abstenim, kështu që konstatoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për vitet 2021-2025.

9. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për zbatimin e fazës së dytë të prioritetëve politike të dakorduara ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës, Agjendës për Reforma Evropiane

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Integrim Evropian e ka shqyrtuar Planin e Veprimit në bazë të zbatimit të fazës së dytë të prioritetëve politike të dakorduara ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës, që quhet “Agjenda e Reformave Evropiane” dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim, mirëpo bashkë me propozimin për ndryshim. Tash e ftoj përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës, zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi, që ta arsyetojë Planin e Veprimit për zbatimin të fazës së dytë të prioritetëve politike të dakorduara ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BESNIK BISLIMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Fillimisht ju falënderoj për votimin e Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Në vijim kam kënaqësinë të paraqes para jush Planin e Veprimit për zbatimin e fazës së dytë të prioritetëve politike të dakorduara ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës - Agjendës për Reforma Evropiane, apo siç njihet shkurt, Plani i Veprimit ERA 2.

Plani i Veprimit ERA 2 është rezultat i përpjekjeve tona të përbashkëta në nivelin më të lartë politik për të intensifikuar zbatimin e reformave kyçe, me qëllim të përmbushjes së detyrimeve

nga MSA-ja. Negociatat me Bashkimin Evropian për prioritete janë përmbyllur pasi kemi marrë detyrën, ndërsa pas kësaj, nën udhëheqjen e Zyrës së Kryeministrit është përgatitur Plani i Veprimit. Kjo është bërë në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë dhe institucionet e pavarura relevante dhe përgjegjëse për fushat që mbulojnë këto prioritete, si dhe me Komisionin Evropian. Dokumenti gjithashtu ka kaluar në konsultime publike në të gjitha nivelet. Qëllimi i Planit të Veprimit ERA 2 është që t'i jepet vëmendje më e lartë politike realizimit të reformave kyçe ekonomike për fuqizimin e sundimit të ligjit dhe konsolidimin e qeverisjes së mirë, të shërbejë si instrument për të shtyrë përpara zbatimin e MSA-së dhe reformave të tjera fundamentale, si dhe të avancojë më tej procesin e integritit të Kosovës drejt Bashkimit Evropian.

Plani i Veprimit ERA 2 pasqyron kontekstin dhe evoluimin e gjendjes, prandaj reflekton edhe ndryshimet e kontekstit tonë politik, si dhe merr parasysh ndikimet që ka pasur pandemia COVID 19. Në këtë aspekt, ERA 2 përmban masa për zbutjen e ndikimit ekonomik dhe social të pandemisë, si dhe ka një fokus të ri në shëndetësi. ERA 2 po ashtu ka një fokus shtesë në reformat me planin ekonomik dhe të investimeve të Komisionit Evropian, të miratuar më 6 tetor 2020, siç është transicioni i gjelbër. Ndërsa, në shtyllën e sundimit të ligjit ka fokus të ri në procesin e reformës zgjedhore, të drejtat themelore të njeriut dhe punë të brendshme.

Periudha e zbatimit të ERA 2 është dyvjeçare dhe përgjatë këtyre 2 vjetëve do të trajtohen çështjet në kuadër të tri shtyllave të qeverisjes dhe me përmbajtje si në vijim: Shtylla e parë: qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit përmes katër prioriteteve e 152 treguesve. Shtylla dy: konkurrueshmëria, klima e investimeve dhe zhvillimi i qëndrueshëm përmes gjashtë prioriteteve e 119 treguesve, si dhe Shtylla tre: punësimi, arsimit dhe shëndetësia, përmes 5 prioriteteve e gjithsej 67 treguesve.

Më lejoni në fund të theksoj se nga tani përpjekjet tona për përpilimin e këtij plani duhet të përcillen me përpjekje tona maksimale për zbatimin e tij. Kjo kërkon vëmendje të veçantë të të gjithë institucioneve përgjegjëse, në të gjitha nivelet, e po kështu edhe mbikëqyrje të procesit të zbatimit nga ana juaj, deputetë të nderuar. Gjithashtu nevojitet bashkëpunim i ngushtë i të gjitha strukturave institucionale me përgjegjësi për këtë proces në Zyrën e Kryeministrit. Bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës do të jetë kyç për zbatimin e këtyre prioriteteve dhe rrjedhimisht për zbatimin e MSA-së. Faleminderit për vëmendje dhe ju lus që të mbështetni edhe këtë Plan Veprimi. Faleminderit!

KRYETARI: Tash e ftojme kryetaren e Komisionit për Integrim Evropian, zonjën Rrezarta Krasniqi, për ta arsyetuar raportin e këtij komisioni.

RREZARTA KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju njoftoj se Komisioni për Integrim Evropian më 24 shtator 2021 e ka shqyrtuar Agjendën për Reforma Evropiane dhe e ka rekomanduar për miratim në seancën plenare.

Agjenda për Reforma Evropiane paraqet një rëndësi të veçantë jo vetëm në kuptimin e caktimit të prioriteteve dhe planifikimit, por edhe në kuptim të realizimit të këtyre prioriteteve që mundësojnë njëkohësisht edhe zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Avancimi i rrugëtimit apo i agjendës së vendit tonë në integrimin evropian ndërlidhet me zbatimin e MSA-së, ndërsa caktimi i prioriteteve përmes Agjendës Evropiane për Reforma, siç janë: sundimi i ligjit dhe reformat e administratës publike, rritja e konkurrueshmërisë ekonomike, arsimi dhe punësimi, sigurojnë një zbatim efektiv të MSA-së. Kjo agjendë është e ndarë në tri shtylla: qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, konkurrueshmëria, klima e investimeve dhe qëndrueshmëria, gjithashtu punësimi, arsimi dhe shëndetësia.

Andaj, zbatimi i Agjendës për Reforma Evropiane rrit më shumë përgjegjësinë për institucionet e Republikës së Kosovës, ku duke ushtruar apo zbatuar suksesshëm këtë agjendë, jo vetëm që vendi ynë përgatitet për hapa të tjerë në procesin e integritimit, por edhe në ngritjen e standardit për qytetarët e vendit tonë. Duke pasur parasysh rolin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe Komisioni për Integrim Evropian në procesin e integritimit evropian, në cilësinë e kryetares së Komisionit për Integrim Evropian ju siguroj që Komisioni për Integrim Evropian i Kuvendit të Kosovës do të luajë rol afirmativ për të siguruar përmbushjen e Agjendës për Reforma Evropiane, si dhe do të mbikëqyrë zbatimin e këtij dokumenti. Faleminderit!

KRYETARI: Tash, nga Lëvizja Vetëvendosje fjalën e ka deputetja Arbëresha Kryeziu-Hyseni.

ARBËRESHA KRYEZIU-HYSENI: Faleminderit, kryetar!

Qeveria e Republikës së Kosovës, në koordinim dhe negociim me Komisionin Evropian kanë hartuar prioritetet që priten të zbatohen nëpërmjet Planit të Veprimit për zbatimin e fazës së dytë të prioriteteve politike të dakorduara në mes të shtetit tonë dhe BE-së.

Ky Plan Veprim me afat të implementimit dyvjeçar ka për qëllim përcaktimin e veprimeve të reformave me prioritate që e dërgojnë vendin tonë drejt rrugës së integritimit evropian dhe si rrjedhojë e kësaj është një dokument që për objektivi kryesor e ka përmbushjen e detyrimeve që dalin nga MSA-ja, e për të cilat detyrime Kosova ka obligim në përmbushje dhe zbatueshmëri të saj, në mënyrë që t'i përafrohemi sa më shumë legjislacionit të BE-së, që është pra parakusht për shtetet që synojnë anëtarësimin në këtë institucion.

ERA 2 përmban gjithsej 130 veprime, 338 tregues dhe 15 prioritate politike të reformave të MSA-së dhe është hartuar duke u mbështetur në tri shtylla kryesore, për të cilat foli zëvendëskryeministri edhe më parë. Gjatë hartimit të këtij dokumenti si Kosova, po ashtu edhe Bashkimi Evropian, janë bazuar në reforma dhe përparime të arritura nga ne si shtet deri më tani,

e të cilat, për fat të keq, nuk kanë përmbushur pritshmëritë e aktorëve ndërkombëtarë dhe po ashtu, dhe atyre vendorë. Lufta kundër korrupsionit dhe mungesa e reformës në administratën publike kanë qenë vetëm disa nga dështimet e vazhdueshme, pasi që qeveritë paraprake nuk kanë ndërmarrë hapa konkretë për evitimin dhe parandalimin e këtyre dy dukurive. Shuarja e Task forcës antikorrupsion në Qeverinë e Avdullah Hotit pati ngjallur reagime të zëshme dhe direkte nga zyrtarët e Bashkimit Evropian, duke thënë se ky veprim ka nxitur shqetësime serioze rreth përkushtimit të Kosovës për ta luftuar korrupsionin.

Ndërkohë, në anën tjetër, miratimi i Projektligjit për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, miratimi i Projektligjit për deklarimin e prejardhjes dhe kontrollit të pasurisë së zyrtarëve publikë, miratimi i Projektligjit për Agjencinë Kundër Korrupsion, janë vetëm disa nga projektligjet e miratuara që tregojnë se kjo qeveri është e interesuar që edhe ligjërisht të veprojë drejt luftimit të korrupsionit, e që janë përshëndetur si veprime nga vetë zyrtarët e Bashkimit Evropian dhe të tjerë të shoqërisë civile në vendin tonë, si hap jashtëzakonisht i rëndësishëm në përmbushjen e masave që na i përcakton MSA-ja.

Po ashtu, mungesa e reformës në administratën publike dhe mosidentifikimi i masave të përmbushura përgjatë vitit 2020, si mungesë e të dhënave, ka qenë një tjetër thirrje e Bashkimit Evropian në drejtim të Kosovës. Dhe, në dokumentin e ERA 2 gjejmë një numër veprimesh që janë përcaktuar dhe kërkohet të trajtohen me prioritet dhe që pritet të ndikojnë pozitivisht në këtë drejtim. Meqenëse COVID-19 ka goditur të gjithëve pa përjashtim, ERA 2 ka një numër të prioriteteve që i ndërlihd pikërisht me dëmin që pandemia ka shkaktuar gjithandej, prandaj zbutja e ndikimit ekonomik dhe social krizës së krijuar dhe një fokus krejtësisht i ri në sferën e shëndetësisë, do të jenë ndër top prioritetet. Ne si grup parlamentar miratimin e këtij Plan Veprimi e konsiderojmë si tejet të rëndësishëm dhe të nevojshëm për vendin, për çka edhe do ta votojmë për dhe do të na mbetet të monitorojmë bashkërisht institucionet përgjegjëse që janë të obliguara të zbatojnë ERA 2 që ta bëjnë një gjë të tillë dhe të gjitha masat e nevojshme t'i ndërlihdin edhe me planet e punës së brendshme të tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Tash, është radha e Grupit Parlamentar të PDK-së, kryetari i këtij grupi, Abelard Tahiri e ka fjalën.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do ta mbështesë miratimin e këtij Plani të Veprimit, pra për zbatimin e MSA-së. Ne do t'i japim një shans kësaj qeverie duke miratuar këtë plan, mirëpo realisht duke parë trendin e qeverisjes dhe duke parë këtë ritëm të qeverisjes, dyshojmë që nuk do të arrijë as për së afërmi zbatimin e këtij plani. Ne do t'i japim një mundësi, do ta miratojmë këtë plan, mirëpo nëse e shohim pak këto shtatë muaj qeverisjeje, miratimin e agjendës parlamentare që e kemi pasur, agjendës legislative, më konkretisht, ligjet, të cilat kanë

qenë në këtë agjendë legislative për këtë vit, lënë për të dëshiruar jashtëzakonisht shumë, sepse diku as në masën prej 20% s'është arritur përmbushja e agjendës legislative.

Pra, kemi mbetur jashtëzakonisht mbrapa nëse shohim planin e qeverisë që e ka dërguar në fillim kur është votuar si qeveri dhe aty ku jemi sot, dhe nuk duam ta shohim qeverinë në të njëjtin trend edhe me implementimin e këtij plani, më konkretisht të ERA 2, sepse janë fonde të Bashkimit Evropian, të cilat janë të dedikuara për Republikën e Kosovës dhe të cilat shpenzohen bashkërisht edhe me institucionet e BE-së që janë në Kosovë, në bashkëpunim me institucionet tona dhe duam të shohim një efikasitet më të madh edhe në ato fusha që i përmendi zëvendëskryeministri, e në veçanti në fushën e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe në qeverisjen e mirë. Po ashtu, kam pritur pikërisht nga kjo qeveri që ta anulojë vendimin e Qeverisë Hoti, e cila kishte shfuqizuar Task Forcën që shërbente pranë Prokurorisë Speciale dhe besoj që anulimi i këtij vendimi do ta rikthente këtë task-forcë që t'i shërbente Prokurorisë Speciale, ashtu siç i ka shërbyer për më shumë se 15 vjet.

Prandaj, vendime të tilla, të cilat i kemi kritikuar bashkërisht sa ishim në opozitë edhe Lëvizja Vetëvendosje, edhe ne si Parti Demokratike, mendoj që do të duhej të anuloheshin dhe të rikthehej gjendja e mëparshme, siç ka qenë më herët, pra kjo Task Forcë të veprojë në kuadër të Prokurorisë Speciale, siç ka vepruar vite me radhë.

Pra, ju e dini, ndoshta kryetari s'e di a po i kujtohet që është anuluar një vendim i tillë nga Qeveria Hoti dhe pastaj, besoj që tash kjo qeveri do të duhej ta anulojë pikërisht atë vendim dhe ta rikthejë gjendjen e mëparshme, sepse ka qenë një Task Forcë dhe që besoj që ka dhënë rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë. Prandaj, thirrja jonë dhe kërkesa jonë drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës është që të jenë më dinamike në implementimin e këtij plani, në shpenzimin e këtyre fondeve që janë dedikuara për shtetin e Kosovës, për shoqërinë tonë nga taksapaguesit e Bashkimit Evropian dhe të tregohemi më efikas pikërisht edhe në thithjen e investimeve dhe fondeve të tjera që mund të jenë, që mund të vinë si grante pra, jo si kredi, si grante nga Bashkimi Evropian në këtë fazën e paraanëtarësimit.

Pra, t'i shfrytëzojmë maksimalisht këto instrumente që Bashkimi Evropian ka, këto fonde që ka për shtetet, të cilat janë në proces e sipër të anëtarësimit, mirëpo në qeverisje të ngathtë, në qeverisje, e cila s'arrin të përmbushë as planin e vet të punës, është vërtet vështirë të sigurohen fonde të tilla. Prandaj, ne, prapë po e ritheksoj, do ta miratojmë me votën tonë këtë Plan Veprimi dhe shpresojmë në një efikasitet më të madh nga Qeveria e Republikës së Kosovës në zbatimin e saj. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën po ia kalojmë Shemsedin Dreshajt nga AAK-ja, pastaj i kthehem kryetares së komisionit edhe një herë, për një plotësim që duhet ta bëjë.

SHEMSEDIN DRESHAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Të gjithë e dimë që krejt këto obligime, veprime të cilat i lexuat më herët i takojnë grupit të masave që i takojnë Marrëveshjes për Stabilizim Asociim.

Vërtet në shumëçka jemi shumë vonë dhe frikësohem që në këtë kohë kur po i miratojmë këto rekomandime dhe implementime të vendimit të programit ERA 2, do të mbesë shumëçka për të dëshiruar, për shkak të një pune të ngathtë dhe të ngadalshme në drejtim të programeve, të cilat paraqesin një strukturë jetike të integritit të Kosovës në Bashkimin Evropian. Ne si grup parlamentar, përkundër të gjitha këtyre vërejtjeve, jemi pro miratimin të kësaj marrëveshjeje dhe do të votojmë pro. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë! Tash, meqenëse na duhet ta bëjmë edhe një plotësim nga ana e kryetares së Komisionit për Integritet Evropian, ia kalojmë edhe një herë fjalën deputetes Rrezarta Krasniqi.

RREZARTA KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Kërkoj një ndryshim, matricat e treguesit me numër 1.1.b, 1.1.2 Projektligji për financimin e subjektit politik i miratuar në faqe 6, të afateve kohore K3 2021 të zëvendësohet me afatin kohor K4 2021.

Gjithashtu po flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, e përkrahim në miratim këtë plan. Faleminderit!

KRYETARI: Përfaqësuesi i Qeverisë, zëvendëskryeministri nuk e kërkon fjalën. Atëherë, na njoftoni, ju lutem, ta dimë se sa deputetë ndodhen në sallë aktualisht.

59 deputetë janë. Na duhen edhe 2 deputetë, i thërrasim nëse janë këndej pari, edhe grupet parlamentare i shtojmë që t'i ftojnë deputetët e tyre që të kthehen në sallë.

Në sallë ndodhen 61 deputetë për momentin. Kështu që, deputetë të nderuar, ju lus që me ngritje dore të përcaktoheni për planin e veprimit për zbatimin e fazës së dytë të prioritetëve politike, të dakorduara ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës për agjendën e reformave evropiane.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Më informojnë që të gjithë deputetët që kanë qenë të pranishëm kanë votuar për, prandaj konsideroj se me 61 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Planin e Veprimit për zbatimin e fazës së dytë të prioritetëve politike të dakorduara ndërmjet Bashkimit

Evropian dhe Republikës së Kosovës agjenda e reformave evropiane me ndryshimin e propozuar nga Komisioni për Integrim Evropian.

Nuk e di pse na ikën ata dy deputetë që erdhën! A kanë dëgjim publik, a? Epo mirë, t'i ftojme pra. Po vazhdojmë me pikën e dhjetë, që është:

10. Shqyrtimi i raportit me rekomandime në lidhje me raportin e auditimit të performansës “Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave joqeveritare”,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin në fjalë dhe i ka propozuar Kuvendit, që në lidhje me të gjeturat e këtij raporti t'i miratojë disa rekomandime. Për këto e ftoj kryetaren e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, zonjën Hykmete Bajrami, që t'i paraqesë dhe arsyetojë rekomandimet e këtij komisioni.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike në mbledhjen e mbajtur më 27 korrik 2021 e ka shqyrtuar raportin e auditimit të performansës “Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave joqeveritare”.

Ky raport ka për objektiv për të vlerësuar nëse procesi i financimit të organizatave joqeveritare është menaxhuar ashtu që të ofrojë transparencë të plotë, të shohim nëse ky proces është konkurrues dhe shkon në funksion të zbatimit të programeve dhe projekteve, të cilat u përgjigjen qëllimeve të synuara nga ana e institucioneve publike. Subjekt i këtij auditimi kanë qenë Zyra e Kryeministrit, Ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sportit, si dhe Komuna e Prishtinës.

Rezultatet e auditimit kanë nxjerrë në pah, se institucionet e audituara kanë hartuar plane në bazë të nevojave dhe i kanë harmonizuar ato me politikat programore dhe strategjitë në hartimin e objektivave strategjike për financim të organizatave joqeveritare, por megjithatë zbatimi i këtyre planeve është përcjellë me shumë mangësi që kanë rrezikuar llogaridhënien, transparencën, konkurrencën dhe arritjen e qëllimeve të synuara me financimin e organizatave joqeveritare.

Institucionet publike kanë realizuar financime direkte të projekteve të ndryshme pa thirrje publike, pa plotësimin e kriterëve dhe vetëm me vendime të kryesuesve të institucioneve publike. Pastaj, ka pasur raste kur ka pasur financim të organizatave që kanë përfituar fonde nga më shumë se një burim i financimit. Gjithashtu, vlerësimet e komisioneve kanë qenë të mangëta dhe

ka pasur raste, kur për shembull një organizatë pa qenë fare organizatë joqeveritare ka përfituar fonde nga institucionet publike.

Kështu që Zyra e Kryeministrit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe Komuna e Prishtinës nuk e kanë realizuar monitorimin e projekteve të financuara dhe as nuk kanë bërë përpjekje për të monitoruar projektet dhe kështu nuk kanë arritur që të mbajnë përgjegjësi për projektet e realizuara nga ana e organizatave joqeveritare. Ky raport ka rreth dhjetë të gjetura, të cilave institucionet duhet t'u përkushtohen me shumë kujdes. Pra, ka gjetur financime direkte pa thirrje publike, kjo komplet në kundërshtim me Rregulloren e Ministrisë së Financave dhe gjithashtu, pa plotësimin e kriterëve nga institucionet publike. Ka pasur përkrahje të OJQ-ve për projekte të njëjta, domethënë më shumë se një institucione publik ka përkrahur të njëjtin projekt. Ka pasur mangësi dhe dobësi gjatë zbatimit dhe përcaktimit të kriterëve në financimin e projekteve të zbatuara nga ana e organizatave joqeveritare, si dhe mungesë totale të transparencës. Ka pasur gjithashtu vlerësime të OJQ-ve nga komisionet pa plotësim të kriterëve, ka pasur dobësi në procesin e financimit të OJQ-ve nga institucionet publike dhe ka pasur raste kur është gjetur që, për shembull, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka financuar një operator ekonomik pa qenë fare organizatë joqeveritare. Dua të vë theksin, se raporti i performancës ka pasur si objektiv zbatimin projekteve të realizuara gjatë vitit 2019.

Zyra Kombëtare e Auditimit po ashtu ka theksuar se institucionet financuese publike nuk raportojnë mbi financimet e organizatave joqeveritare, pastaj Zyra për Qeverisje të Mirë nuk ka regjistruar fare të dhënat për financimin e OJQ-ve në bazën e të dhënave dhe gjithashtu, OJQ-të nuk kanë raportuar për zbatimin e projekteve për të cilat kanë përfituar dhe ka pasur mungesë të monitorimit pothuajse nga të gjitha institucionet publike.

Prandaj, komisioni kur ka shqyrtuar përpos rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë edhe një serë rekomandimesh, të cilat ne i paraqesim këtu dhe lusim deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që t'i votojnë këto rekomandime shtesë.

Rekomandimet janë këto:

- Që të zbatohet në tërësi dhe në përpikëri Rregullorja e Ministrisë së Financave nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të organizatave joqeveritare nga të gjitha institucionet publike, gjë që raporti i auditorit ka vërejtur që nuk po zbatohet.

Pika a. - të ndalohen menjëherë financimet e drejtpërdrejta.

- Zyra për Qeverisje të Mirë të njoftojë në baza vjetore kryeministrin dhe ministrin e Financave për institucionet publike, që përfshihen në financime të drejtpërdrejta.
- Një listë e tillë të jetë e publikuar edhe në platformën e Zyrës për Qeverisje të Mirë.

- Të dhënat dhe databaza të konsolidohen edhe më shumë për ta bërë një raportim sa më të plotë dhe të detajuar për projektet e financimit të organizatave joqeveritare.

Pika b. - të gjitha institucionet publike të adaptojnë platformën elektronike, që është në harmoni me kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Ministrisë së Financave mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të organizatave joqeveritare.

Pika c. - financimi i projekteve të ndryshme të OJQ-ve të bëhet në harmoni me strategjitë sektoriale të Institucioneve publike.

Pika d. - Në shpalljen e thirrjes për propozim të potencohet, se zyra a departamenti është i vendosur që në rast se vërtetohet konflikt interesi, pala e interesuar do të diskualifikohet nga gara dhe do të procedohet te organet kompetente. Në formularët e vlerësimit gjithashtu të shtohet një pyetje për verifikim dhe shmangie nga konflikti i interesit dhe në rast të nënshkrimit të kontratës të potencohet elementi i konfliktit të interesit.

Pika e. - raportimi për zbatim të projektit nga ana e organizatave joqeveritare të jetë obligim dhe pjesë e marrëveshjes. Në rast se OJQ-ja refuzon të raportojë e njëjta të futet në listën e zezë, përmes së cilës kufizohet financimi në të ardhmen për çdo institucion publik.

Dhe, si pikë përfundimtare, kemi thënë se në rast se Rregullorja e Ministrisë së Financave 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve është e pazbatueshme për disa fusha, Qeveria menjëherë të bëjë plotësim-ndryshimin e saj dhe e njëjta të votohet, jo në Ministri të Financave dhe Transfereve, por në Qeveri, në mënyrë që të jetë më e obligueshme për të gjitha organizatat buxhetore.

Edhe një herë, ftoj të gjithë deputetët e Kuvendit që të përkrahin këto rekomandime shtesë të komisionit e në rast se nga ju ka propozime edhe për rekomandime të tjera, ne mund t'i harmonizojmë dhe t'i përkrahim ato. Faleminderit!

KRYETARI: Nga grupet parlamentare nuk ka të paraqitur për të diskutuar lidhur me gjetjet që janë bërë në raportin e auditimit. Mirlinda Sadiku nga Lëvizja Vetëvendosje e ka fjalën.

MIRLINDA SADIKU: Përshëndetje për kryetarin e Kuvendit, nënkryetarin, të gjithë ju të pranishëm!

Organizatave joqeveritare veprojnë në promovimin e zhvillimit lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar përmes shërbimeve që ato i ofrojnë dhe zgjidhje të problemeve, qofshin ato shoqërore apo grupore. Numri i organizatave joqeveritare është rritur dukshëm nga viti 1999 dhe fokusi i tyre ka qenë të drejtat e njeriut, arsimit, shëndetësia, qeverisja e mirë.

Organizatave joqeveritare, edhe pse janë organizata të pavarura nga Qeveria, disa prej tyre janë më të vogla dhe janë më të vogla dhe veprojnë kryesisht në aspektin lokal brenda territorit të një komune, ku mbështetje marrin nga e njëjta komunë. Mirëpo, ka raste kur organizatat joqeveritare ushtrojnë aktivitetin e tyre në shumë komuna dhe përfitojnë mjete financiare nga më shumë se një komunë.

Kështu që, në vitin 2017 është miratuar një rregullore, siç e ceku edhe kryetarja, 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të organizatave joqeveritare nga Ministria e Financave, ku edhe janë të përshkruara kriteret për gjithë ciklin e mbështetjes financiare. Mirëpo, ka OJQ lokale që përfitojnë mbështetje edhe nga fondet e Bashkimit Evropian në kuadër të fondeve të quajtura IPA apo ndihma para anëtarësimit, ku përmes tyre synohet arritja e politikave më të mira të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Kurse, gjatë vitit 2019 totali i financimit të programeve të organizatave joqeveritare nga fondet publike ishte në vlerën 21 milionë euro.

Nga totali i financimit publik të organizatave joqeveritare përqindjen më të madhe të financimit e kanë ministrinë, pasuar nga komunat, rezervat shtetërore dhe nga Zyra e Kryeministrit. Auditimi që ka përfshirë kohën ku nga ministrinë financuesi më i madh është Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është me shumën 4,4 milionë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik me 4 milionë, Ministria e Arsimit me 1,7 milionë dhe Zyra e Kryeministrit ka financuar projekte me vlerë 516 000 euro, dhe 867 000 euro me vendim të Qeverisë nga rezerva shtetërore. E në aspektin lokal Komuna e Prishtinës ka mbështetur organizatë joqeveritare me shumën 651 956 euro e po ashtu, edhe Komuna e Ferizajt me shumën 642 000 euro.

Prandaj, subjekti i auditimit kanë qenë Zyra e Kryeministrit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komuna e Prishtinës dhe shtrohet pyetja, si u shpenzuan këto fonde? A kanë arritur qëllimin dhe për çfarë kanë qenë të dedikuara?

Vlen të theksohet po ashtu, se në kuadër të Zyrës së Kryeministrit është një OJQ, e cila ka përfituar fonde për dy projekte të ndryshme. Zyra e koordinatorit nacional për Kulturë, Rini dhe Sport ka financuar projektin me titull “Forcimi i kapacitetit të rinjve për të krijuar politika rinore në veri të Kosovës” me vlerën 14 000 euro, ndërsa Zyra e komisionerit për gjuhë ka financuar të njëjtën OJQ me projektin “Përmirësimi i përdorimit të gjuhëve zyrtare në punën e Policisë së Kosovës në veri të Kosovës” me vlerën 7 800 euro.

Shtrohet pyetja, a i kanë mësuar gjuhët zyrtare të Kosovës?

Nëse analizohet vlera e përbashkët e financimit publik për OJQ-të nga tri entitetet në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Zyra e Kryeministrit dhe Komuna e Prishtinës, kjo vlerë

përfaqësohet vetëm në masën 27% apo përafërsisht 1/3-a e financimit të përgjithshëm publik të organizatave joqeveritare gjatë vitit 2019.

Zyra e Kryeministrit përveçse është një ndër financuesit kryesorë publikë të OJQ-ve, është po ashtu përgjegjëse edhe për monitorimin, zbatimin, kriteret, standardet dhe procedurat për financim publik të OJQ-ve. Por, vlen të theksohet se në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit jo e gjithë shuma e financuar ka fokus të auditimit, pasi që shuma kryesore e financimit ka qenë në këtë ministri e ndarë për federatat dhe klubet sportive, të cilat janë të rregulluara me Ligjin për sportin dhe përjashtojnë implementimin e rregullores që e cekëm më lartë.

Ndërsa, lidhur me mungesën e publikimit të raporteve vjetore dhe dërgimin e tyre në Zyrën për Qeverisje të Mirë, sikurse kërkohet, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si financuesi më i madh i OJQ-ve nuk ka raportuar në lidhje me financimet e realizuara në vitin 2019. Shuma e fondeve të përfituara nga OJQ-të për projektet e financuara në fushën e sportit, rinisë dhe trashëgimisë kulturore në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit Qeveria ka qenë 4,4 milionë euro. Megjithatë, Departamenti i Kulturës ka hartuar raport vjetor për 2019-ën për të raportuar në Zyrën e Kryeministrit dhe këtë raport e ka përcjellë te Zyra e Sekretarit të Ministrisë së Kulturës. Mirëpo, Zyra e Sekretarit nuk ka bërë përmbledhje të të gjitha raporteve të departamenteve financuese të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe nuk i ka përcjellë tutje te Zyra e Kryeministrit.

Pra, Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit nuk ka bërë publikim të të dhënave mbi financimin e projekteve të OJQ-ve në ueb-faqe. Menaxhim duhet të bazës së të dhënave, arsyetimin e mungesës së resurseve dhe po ashtu, kjo zbehë edhe transparencën për procesin e financimit të këtyre OJQ-ve.

Auditimi ka nxjerrë shumë mangësi që edhe e rrezikojnë llogaridhënien, transparencën, konkurrencën në arritjen e qëllimit të synimeve në financimin e organizatave joqeveritare. Prandaj, institucioni që planifikon, jep financa publike për këto organizata joqeveritare duhet të përcaktojë qartë prioritetet e financimit, projektet dhe programet e OJQ-ve në bazë të strategjive nacionale, të përcaktojë kriteret dhe procedurat e qarta, në mënyrë që të mundësohet një trajtim i barabartë, jo diskriminues dhe vlerësim sa më real me qëllim të inkurajimit të konkurrencës, por po ashtu edhe ofruesit e mbështetjes financiare kanë edhe detyrë që ta monitorojnë në mënyrë të rregullt me qëllim që ajo të jetë konform në linjë me kërkesat e rregullores dhe po ashtu, të arrijë qëllimin edhe për çka është ofruar ajo mbështetje financiare. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Partia Demokratike fjalën e ka deputeti Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit kryetar!

Do të mundohem të jem i shkurtër. Realisht, u tha nga parafolësit, përshëndetje për të gjithë!

Ne e kemi shqyrtuar edhe në Komision për Mbikëqyrjen e Financave Publike raportin e auditimit “Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave joqeveritare”.

Siç u tha edhe nga kolegë deputetë, subjekt i auditimit ka qenë Zyra e Kryeministrit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komuna e Prishtinës. Realisht, të tria kanë pasur probleme të njëjta. Nuk është realizuar monitorimi i projekteve të financuara. Këto institucione nuk kanë bërë përpjekje minimale për të caktuar personin përgjegjës për monitorimin e projektit. Për më tepër, institucionet e audituara nuk kanë arritur të mbajnë përgjegjësi të organizatat joqeveritare për t’u ofruar një raport, se a janë kryer ato shërbime për të cilat në këtë rast kanë aplikuar.

Realisht, auditori në bazën e të gjeturave që u thanë edhe nga parafolësit, i ka bërë 9 rekomandime. Gjithsej nëntë rekomandime kanë të bëjnë me financimin direkt, pa thirrje publike dhe pa plotësimin e kriterëve nga institucionet publike. Ka qenë gjetja e parë e auditorit. Për të mos i lexuar të gjeturat dhe për të mos ju marrë kohë, se u thanë edhe nga kolegët, në këtë rast kryetarja e komisionit dhe kolegja në fjalë, ne kemi kërkuar si Komision për Mbikëqyrje të Financave Publike nga institucionet gjegjëse, në këtë rast ne jemi që të përkrahen organizatat joqeveritare por të ketë standarde, të ketë transparencë, të ketë mbikëqyrje, të ketë person përgjegjës dhe të ketë raport se a është kryer një projekt i caktuar, për të cilin ka aplikuar apo jo. Dhe të njëjtën kohë, është kërkuar nga komisioni që mos të kërkohej në disa institucione, megjithatë ndihmat që jepen nga institucionet me qenë transparente, konkurruese dhe me qenë e publikuar sipas Rregullores së Ministrisë.

Kurse, sa i përket, po e them këtë të fundit që tha deputetja nga Vetëvendosja, ndoshta e jona nuk është me e këqyr a kanë mësuar gjuhën, por të paktën a janë mbajtur trajnimet? A janë mbajtur kurset, sepse a mësohet gjuha a nuk mësohet, ne nuk e dimë. Megjithatë, nuk kemi raport se a janë mbajtur trajnimet, a janë mbajtur kurset, për të cilat kanë përfituar nga institucionet gjegjëse.

Megjithatë, ne e kemi përkrahur si Parti Demokratike edhe në komision rekomandimet e komisionit dhe kërkojmë nga kolegët deputetë, që t’i përkrahin këto rekomandime dhe konsideroj që janë në interes edhe të vetë OJQ-ve. Faleminderit!

KRYETARI: I fundit për diskutim është paraqitur në këtë pikë deputeti i Vetëvendosjes, Eman Rrahmani.

EMAN RRAHMANI: Faleminderit, kryetar!

Do të jem shumë i shkurtër.

Raporti i auditimit dhe performancës do të thotë se transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave joqeveritare në fakt është pasqyrim i një gjakderdhjeje financiare, e cila bëhet përmes financimit të OJQ-ve.

Vetëm gjatë vitit 2019 OJQ-të nga fondet publike kanë përfituar rreth 21 milionë euro. 45% e institucioneve publike nuk kanë raportuar e as nuk kanë bërë publikimin e raporteve të financimit të organizatave joqeveritare. Rreth 60% e projekteve të financuara institucionet publike i kanë kryer duke bërë financime direkte me organizatat joqeveritare. Pra, pa bërë publikimin e thirrjeve, ose siç njihet në publik, pa konkurruar hiç. 69% e projekteve të fituara nga organizatat joqeveritare nuk kanë raportuar se si i kanë shfrytëzuar ato mjete. Do të thotë, rreth diku 12 milionë euro nuk dihet se si dhe qysh janë shfrytëzuar, nga kush janë shfrytëzuar, në cilat projekte dhe ku kanë shkuar ato mjete? Natyrisht, që nëse këtë raport të performansës e sheh Prokuroria, ka bazë të mjaftueshme për të filluar hetimet, qoftë në institucionet publike që i kanë dhënë këto fonde, por edhe te shumica e organizatave joqeveritare, të cilat kanë përfituar dhe nuk kanë arsytuar asnjë arsytim se si i kanë shpenzuar.

Është shumë e rëndësishme që edhe vitet në vijim është vazhduar të financohen këto organizata joqeveritare, e që për besë edhe një pjesë e tyre vazhdojnë të financohen për shkak se nuk janë krijuar mekanizma që i përjashtojnë nga përfitimet këto organizata joqeveritare, të cilat nuk japin asnjë llogari se si i shpenzojnë këto mjete të taksapaguesve kosovarë.

Kështu që, është mirë të merren parasysh rekomandimet që kanë ardhur nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike dhe të kihet parasysh, që mos të ndodhin gjëra të tilla që kanë ndodhur deri tani, por të merren hapa nga institucionet përkatëse e të parandalohet një keqpërdorim i tillë i parasë publike. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk ka të tjerë deputetë që janë paraqitur për të diskutuar, kështu që 57 deputetë jemi në sallë. Nëse për një kohë mund të mobilizojnë grupet parlamentare deputetët e tyre? 4 deputetë na duhen që të votohen gjetjet dhe rekomandimet e komisionit.

Po e përfundojmë edhe këtë pikën e 11-të, pastaj e kemi vetëm një propozim nga grupet parlamentare për krijimin e një komisioni ad-hoc. Kështu që, ta përfundojmë edhe këtë pikë, pastaj t'i presim. Po ka premtime nga grupet parlamentare që disa deputetë do të vijnë.

11. Shqyrtimi i raportit në lidhje me raportin e auditimit të performansës, parandalimi dhe reagimi i situatave emergjente nga vërshimet

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin në fjalë dhe ia ka propozuar Kuvendit që t'i miratojë rekomandimet e tij. Me këtë rast e ftoj kryetaren e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, deputeten Hykmete Bajrami, që t'i paraqesë rekomandimet e komisionit.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Gjithashtu, Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2021 e ka shqyrtuar raportin e auditimit të performansës, parandalimi dhe reagimi i situatave emergjente, me theks të veçantë tek vërshimet. Ky raport i auditimit me anë të performansës është bërë për të vlerësuar nëse Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave dhe institucionet e tjera relevante kanë arritur ta krijojnë një sistem të përshtatshëm, i cili siguron në mënyrë efektive parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente me fokus te vërshimet në Republikën e Kosovës.

Subjekt i auditimit të këtij raporti kanë qenë Agjencia për Menaxhimin Emergjent në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, qendra e situatave në kuadër të Këshillit të Sigurisë së Kosovës si dhe Forca e Sigurisë së Kosovës. përderisa në nivel lokal, subjekt i auditimit kanë qenë Komuna e Gjakovës dhe Komuna e Vushtrisë, përkatësisht drejtoritë përkatëse komunale si dhe njësitë profesionale për zjarrfikje dhe shpëtim. Ky auditim ka përfshirë periudhën për vitet 2019 dhe 2020 deri në janar të vitit 2021. Rezultatet e auditimit kanë nxjerrë në pah se institucionet përgjegjëse në nivelin qendror dhe atë lokal nuk kanë arritur të krijojnë një sistem të përshtatshëm i cili siguron në mënyrë efektive parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente të vërshimeve dhe përmbytjeve në Republikën e Kosovës.

Mospërditësimi i planeve kyçe nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës, Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave dhe komunave për menaxhimin e situatave emergjente kombëtare dhe lokale, mungesa e burimeve njerëzore dhe teknike, mungesa e plani të një komunikimi të përbashkët, paqartësitë në ndarjen e përgjegjësive të koordinimit janë disa nga mangësitë të cilat vështirësojnë aktivitetet që ndërmerren në aspektin e parandalimit dhe reagimit të sistemit ekzistues të menaxhimit të emergjencave për rastet e vërshimeve.

Këshilli i Sigurisë së Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme nuk kanë arritur të përditësojnë dokumentet strategjike për reagim dhe menaxhim të situatave emergjente. Këto dokumente nuk janë përditësuar që nga viti 2010 dhe të njëjtat vazhdojnë të përdoren edhe sot.

Në analizën e rishikimit të sektorit strategjik të sigurisë në vitin 2014 është rekomanduar të bëhet rishikimi i Strategjisë së re të sigurisë dhe në po të njëjtin vit gjithashtu është rekomanduar që të bëhet hartimi i strategjisë së re e cila është iniciuar vetëm në vitin 2017. Mirëpo, një gjë e tillë në fakt nuk ka ndodhur deri në maj të vitit 2021. Strategjia nuk ka arritur të kompletohet dhe të miratohet si dokument final. Strategjia e sigurisë së Kosovës deri në momentin e miratimit të dokumentit të ri mbetet me dokumentin e vitit 2010, i cili në asnjë mënyrë nuk pasqyron rrethanat e reja në fushën e menaxhimit të emergjencave, sidomos duke marrë parasysh paqartësitë që ekzistojnë në ndarjen e përgjegjësive të palëve kryesore pjesëmarrëse.

Plani i reagimit në nivel kombëtar është hartuar në vitin 2010 gjithashtu. Ky plan deri më tani nuk është rishikuar dhe përditësuar asnjëherë. Për këtë qëllim janë dhënë rekomandime edhe nga qendra e situatave, edhe nga Ambasada Amerikane. Plani i reagimit kombëtar nuk ka gjetur zbatueshmëri në shumë intervenime të cilat janë bërë gjatë fatkeqësive të ndodhura gjatë periudhës së audituar. Gjatë auditimit janë vërejtur disa mangësi gjatë zbatueshmërisë së planit të reagimit kombëtar për vërshimet e fundit, e të cilat janë si më poshtë: paqartësi në ndarjen e përgjegjësive të koordinimit të aktiviteteve të institucioneve të nivelit qendror dhe lokal dhe kjo është shumë e shprehur, mungesë e një plani të qartë të komunikimit dhe sistemit të përbashkët të komunikimit mes palëve të përfshira në procesin e reagimit si dhe mungesa e përcaktimit të qartë të transferit të komandës së incidentit gjatë reagimeve të përbashkëta. Thjesht në situata të tilla, institucionet nuk i dinë përgjegjësitë e tyre.

Të dhënat historike mbi fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera nuk janë të plota. Databaza e fundit me të dhëna historike “Desinventar Kosova” është krijuar në vitin 2015, e cila pasqyron rreziqet kryesore nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Kosovë. Përmes kësaj databaze mund të planifikohen veprime më të mira të parandalimit duke analizuar trendet e katastrofës dhe ndikimet e tyre në një mënyrë sistematike. Databaza është plotësuar dhe përditësuar me të dhëna në vitin 2019 nga tetë komuna të cilat kanë dërguar informata mbi fatkeqësitë që kanë ndodhur, mirëpo nuk është plotësuar për tërë komunat e Kosovës, përderisa për vitin 2020 nuk ka të dhëna në këtë sistem i cili është në funksion dhe është i qasshëm vetëm brenda rrjetit qeveritar.

Mungesa e të dhënave për fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në Kosovë paraqet problem për vlerësimin e rrezikut në të ardhmen, duke mos qenë të informuar si ka ardhur dhe si kanë ndodhur fatkeqësitë. Për periudhën 2019-2020 nuk është bërë matje e nivelit të performansës së këtyre njësive dhe treguesve të përcaktuar. Megjithatë Njësia për Menaxhimin e Emergjencave ka zhvilluar vizita me qëllim të monitorimit të njësive të caktuara të cilat janë parë si të mjaftueshme për këtë qëllim, mirëpo nuk është bërë një matje e tillë e performansës për të gjitha njësitë kaq të rëndësishme për identifikimin e problemeve dhe shkaqet eventuale për planifikim në të ardhmen.

Me qëllim të rregullimit të mënyrës së menaxhimit të emergjencave, në raportin e auditimit janë dhënë 11 rekomandime për institucionet përgjegjëse. Prandaj, bazuar në këtë që thamë më lart dhe bazuar në të gjeturat e Auditorit, ne si Komision kemi paraqitur edhe një numër të rekomandimeve për faktin se me të vërtet Zyra Kombëtare e Auditimit këtë situatë e nxjerr tepër të pakëndshme dhe ne i dimë pasojat e vërshimeve për shumë qytetarë të Kosovës, sidomos në vitet e fundit dhe gjithashtu dimë edhe reagimin e institucioneve tona për t’i rikuperuar ato dëme të cilat natyrisht që po marrin kohë.

Komisioni, pas shqyrtimit të raportit, ka dhënë edhe këto rekomandime:

1. Këshilli i Sigurisë së Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme të përditësojë dokumentet strategjike për reagim dhe menaxhim të situatave emergjente. E thamë edhe më herët, punohet me dokumente të vitit 2010.
2. Agjencia për menaxhim të emergjencave të rivlerësojë dhe të përditësojë dokumentet për vlerësimin e rreziqeve dhe t'i përditësojë të dhënat historike mbi fatkeqësitë në nivel vendi.
3. Agjencia e menaxhimit të emergjencave të monitorojë aktivitetet e parandalimit dhe matjes së performancës të njësive profesionale në zjarrfikje dhe shpëtim.
4. Niveli qendror dhe lokal të sigurojë dhe të fuqizojë burimet njerëzore dhe ngritjen e kapaciteteve teknike të mjaftueshme për reagim ndaj situatave emergjente.
5. Të bëhet zëvendësimi i kapaciteteve teknike që janë në gjendje për reagim emergjent dhe të plotësohet numri me kapacitete në atë nivel ku mund të menaxhohen situatat e tilla.
6. Të funksionalizohet sistemi i përbashkët i komunikimit për të gjitha palët reaguese në mënyrë që të mundësohet koordinimi dhe reagimi i përbashkët mes njësive të ndryshme pjesëmarrëse në intervenim gjatë emergjencave.
7. Të definohet qartë statusi i zjarrfikësve, pagesat si dhe definimi i kompetencave të nivelit qendror dhe nivelit lokal.

Unë ftoj deputetët që të votojnë rekomandimet shtesë të Komisionit. Si informacion për të gjithë ju, si Komision për Mbikëqyrje të Financave Publike po u japim shumë rëndësi raporteve të auditimit të performancës, jo vetëm atyre të rregullsisë dhe gjithashtu kemi vendosur që pas shqyrtimit të raportit vjetor të auditimit, ne të merremi edhe me mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve në të gjitha institucionet, raportet e të cilave i kemi shqyrtuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Tash fjalën e kanë grupet parlamentare. Nga Lëvizja Vetëvendosje, Mirlinda Sadiku e ka fjalën.

MIRLINDA SADIKU: Ashtu siç e ceku edhe kryetarja e Komisionit, duke shqyrtuar këtë raport d.m.th. në lidhje me vërshimet, përmbytjet në Republikën e Kosovës, si mostër reprezentative ka qenë Komuna e Gjakovës dhe e Vushtrisë, Agjencia për Menaxhim Emergjent në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Qendra e situatave në kuadër të Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës për vitet 2019, 2020 dhe 2021.

Megjithatë kjo është vetëm si mostër, por ne kemi qenë dëshmitarë të gjithë se përmbytjet, përballja me vërshimet ka ndodhur edhe në shumë komuna të tjera të Republikës së Kosovës ku

dëmet fatkeqësisht kanë qenë të konsiderueshme. Gjithsesi shtrohet pyetja se sa janë të përgatitura institucionet relevante siç është Agjencia për Menaxhim të Emergjencave që të reagojë në situata të tilla dhe po ashtu edhe komunat.

Këtë vit Kosova po ashtu edhe për shkaqe të ndryshme ka pasur edhe zjarre të qëllimshme apo të paqëllimshme, por edhe për shkak të thatësirës është përballur edhe me shumë vatra të zjarrit, e që shumë herë kanë përfunduar edhe me viktima të njerëz, dëme materiale dhe djegie të sipërfaqeve të shumta të pyjeve të cilat fatkeqësisht përpos prerjes dhe degradimit, djegia ka lënë pasojë dhe vështir të rikuperohen edhe ndër vite.

Auditimi i bërë në këto dy komuna dhe në institucionet e lartcekura ka nxjerrë në pah shumë mangësi në sistemin e reagimit emergjent dhe po ashtu është konstatuar se a janë të gatshme komunat dhe a janë të kyçura të parat në reagimet e tilla emergjente. Vlen të theksohet se janë shpërfaqur shumë të gjetura të cilat nxjerrin në pah edhe aspektin e nevojës së përgatitjes së strategjisë kombëtare për reagim në emergjencë, ku në saj të raportit, strategjia e sigurisë është hartuar qysh në vitin 2010, mirëpo ende nuk është jetësuar as nuk është miratuar. Ajo që është evidente dhe mjaft e rëndësishme është se Kosova nuk ka strategji të reagimit emergjent, por duhet të theksohet se këtë nuk e kanë edhe një numër komunash që do të duhej ta kishin, e po ashtu edhe strategjitë sektoriale të cilat do të inkuoroheshin në kuadër të strategjisë nacionale. Po ashtu edhe dokumenti i vlerësimit të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në nivel vendi nuk është përditësuar qysh nga viti 2016.

Si për çudi, Kosova e ka pasur masterplanin për emergjencë qysh në vitet '60-ta e të '80-ta, mirëpo sot në shek. XXI, në vitin 2021 të mos kemi një strategji të tillë është e pafalshme. Kosova po ashtu është një zonë seizmike e cila përballlet shpeshherë edhe me tërmete siç është rasti në Anamoravë ku ka ndodhur në vitin 2002. Po ashtu edhe vërshimet kanë një kosto në ekonominë familjare, ekonominë bujqësore e të gjitha këto së bashku krijojnë edhe shpenzime për buxhetin e shtetit. Pra, përmbytjet e tokave, mbrojtja nga përmbytjet dhe rregullimi i regjimit ujor kërkojnë një qasje serioze dhe afatgjate. Ndër faktorët kryesorë që shpien deri te paraqitja e vërshimeve-përmbytjeve janë shtretërit e parregulluar të lumenjve, dëmtimi i shtretërve të lumenjve nga eksploatimi pa kriter i rërës dhe zhavorrit, ndërtimi i shtëpive, rrugëve dhe urave në vende që janë të rrezikuara nga vërshimet, hedhja e mbeturinave në lumenj, prerja e drurëve në afërsi të zonave vërshuese, mirëmbajtja e dobët e objekteve mbrojtëse, mungesa e mjeteve financiare për ndërtim të objekteve mbrojtëse të reja.

Gjithsesi është evidente se në rrethana kur ka emergjencë të vërshimeve, zjarreve, tërmete, përmbytjeve, atëherë institucioni i parë i cili i përgjigjet rasteve të tilla, pa dyshim janë zjarrfikësit, sepse një prej rekomandimeve që ka ardhur nga grupi i Lëvizjes është pikërisht definimi i statusit të këtyre punonjësve shtetërorë. Është me rëndësi të potencohet se në çfarë gjendje janë sot zjarrfikësit. Zjarrfikësit në vitin 2021 po edhe vitet e kaluara janë përballur me

intervenime të shumta. Po ju jap një argument faktik, vetëm zjarrfikësit e Komunës së Vitisë gjatë vitin 2021 kanë pasur gjithsej 608 intervenime. Vetëm në muajt korrik, gusht, shtator i kanë pasur 471 intervenime. Po ashtu, objekti në të cilin operojnë është në gjendje të mjerueshme dhe është filluar së ndërtuari në vitin 2017, por ende nuk është përfunduar sot.

Duke marrë parasysh se shpeshherë komunat ndihmohen në mes vete dhe mbulohet edhe Komuna e Kllokotit, e Ferizajt, e Kaçanikut, por po ashtu edhe Komuna e Junikut është përballur me shumë zjarre në terren dhe nëse kanë pasur reagime në të njëjtën kohë, vështir ka qenë mbulueshmëria e terrenit.

Gjithsesi zjarrfikësit në Republikën e Kosovës gjatë intervenimeve që bëhen në terren janë përballur dhe përballen edhe sot e kësaj dite me pajisje të stërvjetëruara të cilat nuk kanë siguri në rast të intervenimeve në zjarre, madje ata operojnë me vetura të viteve '70-ta dhe të '80-ta. Shkallët të cilat janë qenësore për të intervenuar në lartësi, nuk janë të testuara që paraqet rrezik për jetën e zjarrfikësve dhe sigurinë e tyre. Po ashtu konkludim i tyre është se një numër i madh i zjarrfikësve janë në moshë të shtyrë. Është evidente që komunat e vogla dhe të mesme u mungojnë edhe hidrantët e ujit, ku investimet kapitale që bëhen nëpër komuna, një gjë e tillë nuk është duke u marrë parasysh. Zjarrfikësit çka është shumë me rëndësi nuk kanë sigurime shëndetësore e si pasojë në raste të ndryshme të intervenimeve lëndohen dhe koston e shërimit e paguajnë ata. Zjarrfikësit duhet të kenë kontrolle të rregullta shëndetësore ashtu siç janë kontrollet për Forcat e Sigurisë së Kosovës dhe policët. Është fakt i pamohueshëm dhe shumë me rëndësi që edhe objektet e larta që po ndërtohen në Kosovë, objektet kolektive gjithandej Kosovës ndërtohen pa shkallë emergjente e në disa qytete, rrugët dhe hapësirat në mes të ndërtesave të larta janë aq të ngushta sa në rast zjarri a tërmet, intervenimi i zjarrfikësve është pothuajse i pamundur.

Është po ashtu shqetësuese se ka edhe shkolla që ndërtohen dhe nuk kanë shkallë emergjente. Po ashtu edhe komunat në investimet kapitale nuk është se i kanë kushtuar shumë vëmendje edhe trajtimit të ujërave atmosferikë. Zjarrfikësit nuk kompensohen për orët jashtë orarit të punës, për ndërrimet e natës, për festat shtetërore dhe koeficienti i tyre është më i ulët nga të gjitha kategoritë e punësuarë në vend. Se sa janë të vlefshëm këta punëtorë të shtetit na e tregoi më së miri zjarret e fundit që ndodhën në Kosovë po edhe në shtetin tonë amë të Shqipërisë. Pra, reagimi i shpejtë, efikas dhe me kohë mund të shpëtojë edhe jetë njerëzish por edhe pasuritë milionëshe të qytetarëve.

Po ashtu, edhe djegiet kanë degraduar malet tona dhe çka është më e rëndësishmja intervenimi i shpejtë i tyre mund të shpëtojë shumë sipërfaqe me pyje. Në shumë shtete kjo kategori e punëtorëve konsiderohen si më të rëndësishmit, duke i ranguar me policët dhe ushtarakët. Prandaj edhe zjarrfikësit në Republikën e Kosovës duhet të kenë vëmendjen tonë dhe të bëhet përfundimisht zgjidhja e statutit të tyre, sigurimet shëndetësore, mjetet motorike të kohës të

avancuara, pajisjet e standardizuara dhe të sigurta, sepse të gjitha këto bëjnë që ata ta kryejnë detyrën e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme.

Është mirë që njëherë e mirë të definohet statusi i tyre, sigurimi shëndetësor, pagesat, të definohen qartë po ashtu përgjegjësitë edhe të nivelit lokal edhe të nivelit nacional. 4 maji është dita ndërkombëtare e zjarrfikësve dhe është shumë me rëndësi të ceket se është momenti i fundit që kjo kategori e punonjësve të merr vëmendjen nga institucionet relevante dhe të trajtohet gjendja dhe statusi i tyre për çka edhe janë dhënë rekomandimet nga ne si Komision. Po ashtu, shumë me rëndësi të hartohet e miratohet strategji nacionale që do t'i identifikonte objektivat, kostot e inkorporuar dhe ato të strategjisë sektoriale në harmonizim të plotë me komunat. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Sa i përket këtij raporti të auditimit të performansës të bërë për të vlerësuar nëse Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave dhe institucionet e tjera relevante kanë arritur të krijojnë një situatë të përshtatshme e cila siguron në mënyrë efektive parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente me fokus të veçantë të vërshimit apo përmbytjet. Realisht, këto 11 rekomandime të Zyrës Kombëtare të Auditorit e qesin në pah situatën të cilën e kemi në terren si në nivelin qendror, po edhe atë lokal, pavarësisht se këtu i kemi pasur për bazë vetëm dy komuna, po mund të them se problemet e njëjta i kanë të gjitha komunat.

Të gjeturat e auditimit p.sh. te dokumentet strategjike për parandalimin dhe reagimin e situatave të emergjencës, Këshilli i Sigurisë së Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka arritur të përditësojë dokumente strategjike për reagim dhe menaxhim të situatave emergjente. Këto dokumente nuk janë përditësuar që nga viti 2010 dhe të njëjtat vazhdojnë të përdoren edhe sot. Realisht nuk kemi pasur. D.m.th. strategjia e sigurisë së Kosovës deri në miratim të një dokumenti tjetër, Kosova ka një strategji, një dokument që e ka hartuar dhe aprovuar në vitin 2010. I bie që nuk i bie tamam kërkesave që i ka tani qytetarët e Kosovës në rastet e emergjencave të tilla.

Gjatë auditimit janë vërejtur shumë mangësi, po janë disa mangësi teknike që mund të zgjidhen edhe pa pasur ndonjë investim kapital. P.sh. te paqartësia në ndarjen e përgjegjësive të koordinimit të aktiviteteve të institucionet në nivel qendror, mungesa e një plani të qartë të komunikimit dhe sistemit të përbashkët të komunikimit mes palëve të përfshira në procesin e reagimit, mungesa e përcaktimit të qartë dhe transferit të komandës së institucioneve gjatë reagimit të përbashkët. Realisht për të mos i përsëritur këto çka i thanë edhe kolegët, i kemi edhe në raport të auditimit. Kanë mungesa nga ato më elementaret, nga burimet njerëzore. Komunat nuk arrijnë të përmbushin numrin sipas ligjit të zjarrfikësit.

Te zjarrfikësit kemi problem edhe te mosha, kemi problem te pajisjet në të gjitha komunat. Këtu flasim për Komunën e Gjakovës. Në bazë të raportit, vetëm i posedon disa pajisje, 13 automjete, të cilat shumica ndoshta janë jashtë funksionit që janë dhënë donacion në vitin 1999. Realisht ato nuk i plotësojnë kriteret për përmbytyje apo për çështje të emergjencave, por as për zjarrfikësit.

Ka mungesë, u vërejt se në të gjitha komunat dhe në të gjitha institucionet kemi p.sh. te përmbytyjet e ujit, nuk kemi ekspert të kësaj fushe. Megjithatë Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike në harmonizim me raportin e Auditorit, në këtë rast të Zyrës Kombëtare të Auditorit Gjeneral i ka bërë rekomandimet dhe kërkojmë që institucionet gjegjëse t'i marrin për bazë këto rekomandime. Nëse edhe deputetë të tjerë kanë rekomandime të tjera apo institucionet vetë kanë rekomandime, ne duhet t'ua bëjmë disa kërkesa që realisht janë nga terreni, bazuar në raport, dhe në këtë fazë kërkoj që të përkrahet nga kolegët deputetë ky raport, po në të njëjtën kohë ky raport të mos mbetet vetëm në fazën e rekomandimeve, sepse me të vërtetë është një situatë e rëndë në terren.

Sigurisht, ashtu siç edhe u tha, zjarrfikësit kanë problem me statutin e tyre, a janë në nivel apo janë në nivel qendror, a paguhet për siguri apo nuk paguhet për siguri. Kanë problem me koeficientin apo edhe probleme më elementare. Faleminderit!

KRYETARI: Nga AAK-ja, fjalën e ka deputeti Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetar!

Sa po e shoh po përsëriten gjërat. Ne i dimë rekomandimet që i kanë dhënë Zyra e Auditimit, dhe nuk mendoj që ne të humbim kohë, por në përpikëri t'i përmbushim të gjitha institucionet, ato rekomandime.

Ne i dimë dobësitë edhe në komuna, edhe në njësinë qendrore, mirëpo ato të gjetura nga auditimi, mendoj që është një material që mund të shqyrtohet dhe të implementohet.

Prandaj, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, grupi parlamentar ynë i përkrah.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Eman Rrahmani.

EMAN RRAHMANI: Faleminderit, kryetar!

Do të jem i shkurtër dhe do të fokusohem vetëm tek të gjeturat që kanë të bëjnë me zjarrfikësit në këtë raport të auditimit.

Në Kosovë janë të punësuar 766 zjarrfikës, ku sipas ligjit në fuqi do të duhej të ishin të punësuar 1188 zjarrfikës apo 422 më shumë se sa janë tani. Kjo është jashtëzakonisht e rrezikshme për

vendin, për shkak që shumica e komunave në Republikën e Kosovës, nuk kanë kapacitete të mjaftueshme më shumë se sa për fikjen e një zjarri apo të aksidenti në të njëjtën kohë.

Zjarrfikësit, në këtë raport ka dalë që kanë 241 automjete, ku vetëm 96 prej tyre janë në gjendje të rregullt. Një pjesë e këtyre automjeteve kanë prishje të konsiderueshme, kurse pjesa tjetër është jashtë funksionit.

Zgjidhja e statutit të zjarrfikësve është ndër çështjet kryesore të cilat do të duhej që Ministra e Punëve të Brendshme të merret shumë seriozisht e shumë shpejt për ta zgjidhur këtë problem, për shkak që e pengon seriozisht funksionimin e zjarrfikësve në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Mungesa ose paqartësia e kompetencave mes AME-së dhe zjarrfikësve ka lënë vendin që për 17 vjet të mos punësohet asnjë zjarrfikës.

Mosha mesatare e zjarrfikësve është mbi 50 vjeç, kurse duke e parë trajtimin e tyre, nuk iu paguhen as orët shtesë të cilat këta zjarrfikës i mbajnë, ndërrimi i natës dhe trajtimet e tjera të cilat do duhej t'i bëheshin kësaj kategorie, ashtu siç bëhen në gjithë botën.

Andaj, mendoj që është shumë e rëndësishme që këto rekomandime të dalin nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, të merren seriozisht nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe organizatat tjera të cilat kanë ndikim në këtë pikë, në mënyrë që të zgjidhet problemi dhe t'i kushtohet një rëndësi e veçantë përgatitjes së tyre, për shkak se këtu kemi të bëjmë edhe me rrezikimin e jetës së njerëzve ose pamundësisë dhe paaftësisë për të vepruar në kohën e duhur për të intervenuar në zjarret dhe çështjet e tjera, ku kanë aktivitet zjarrfikësit.

Po e them edhe një herë se në pyetje është çështja e zgjidhjes së statutit të tyre dhe është çështje në të cilën duhet të intervenohet menjëherë, për shkak që nuk besoj që ka ndonjë institucion tjetër, ku për 17 vjet nuk e kanë pranuar asnjë punëtor.

Prishtina është qyteti ku ka mbetur me përgjysmim të zjarrfikësve dhe çdo vit, së paku deri në 10 shkojnë në pension dhe nëse vazhdon ky trend, brenda dy viteve nuk do të kenë mundësinë e intervenimit, thuajse fare në gjithë komunën.

Andaj, identifikimi i problematikave është shumë i qartë dhe besoj që duhet vepruar shumë shpejt ose thënë, menjëherë, për t'u zgjidhur këto probleme, ku janë adresuar mjaft mirë nga raporti i performansës nga auditori. Faleminderit!

KRYETARI: Dhe deputeti i fundit që ka kërkuar të diskutojë për këtë pikë është deputeti i Vetëvendosjes, Fitim Uka.

FITIM UKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk njoh katastrofë natyrore, dëmet e së cilës mund të kufizohen vetëm në aspektin financiar. Edhe një aksident i vogël veturash, mund të lë pasoja të pariparueshme në shëndetin mendor, dhe ajo që njihet si traumë psikologjike, mund të kushtojë më shumë sesa traumat fizike në rast se nuk trajtohet dhe nuk adresohet, e nuk merr vëmendjen e duhur nga ekipet e intervenimit institucional.

Një traumë psikologjike, në fakt, e ka potencialin për ta shkatërruar edhe shëndetin fizik, dhe kjo është arsyeja pse na duhet të ketë vëmendjen tonë, edhe për faktin e thjeshtë që një traumë psikologjike, mund të kthehet çrregullim të stresit post-traumatik, e të bëhet akoma më problematike.

Por, përkundër kësaj, në tërë raportin e auditimit të performansës për parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente, vërshimet më konkretisht, pasojat psikike nuk përmenden asnjëherë të vetme në kontekstin e ndihmës që duhet të pranojnë njerëzit e prekur.

Edhe kur e mendon që është trishtues fakti që qytetarët tanë nuk pranojnë ndihmë psikologjike edhe atëherë kur preken nga vërshimet, kupton pastaj që edhe ata që i ofrojnë këto shërbime, pra vet zjarrfikësit, nuk pranojnë vlerësim psikologjik, e aq më pak ndihmë psikologjike.

Ata i ekspozohen rrezikut të dyfishtë në momentin kur intervenojnë, por nuk e marrin as ndihmën minimale.

Siç thuhet tekstualisht në këtë raport, vazhdojnë të reagojnë në situata të ndryshme emergjente edhe pse nuk iu bëhet asnjë verifikim shëndetësor, qofshin ato verifikime fizike apo psikologjike. Dhe, reagimi në emergjenca të ndryshme mund të ketë edhe pasoja psikike, por këto intervenime nuk bëhen fare.

Pra, kjo e shpërfaqë njëlloj mentaliteti të përgjithshëm shoqëror që në opinionin tim nuk do duhej të kopjohej në politikat institucionale, dhe që shëndetin e kufizon vetëm në komponentën fizike.

Përderisa Organizata Botërore e Shëndetësisë bën thirrje dhe kërkon aplikim të ndihmës së parë psikologjike edhe në rastin e aksidenteve, e lëre më të katastrofave natyrore, është e pakuptimtë që një formë e tillë e intervenimit të mos institucionalizohet edhe në Kosovë.

Prandaj, besoj që të gjithë ju këtu e dini rëndësinë që e ka intervenimi i tillë. Sot, kemi qindra psikologë të papunë, të përgatitur mirë profesionalisht, që mund të bëhen pjesë e ekipeve të tilla dhe mund të japin një dorë të mirë ndihme.

Andaj, më duhet ta shfrytëzoj këtë mundësi që të bëj thirrje tek të gjitha institucionet, edhe tek ato të nivelit qendror edhe tek ato të nivelit lokal, që ta konsiderojnë konceptualizimin e intervenimit duke e futur edhe komponentën e shëndetit mendor në këtë nivel. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tash, përfunduar diskutimet, por më duket që kemi numër të pamjaftueshëm të deputetëve. 58 deputetë janë të pranishëm në sallë, na nevojiten edhe 3 deputetë ashtu që të mund të votojmë, e pastaj të dalim te pika e fundit, ta përmbyllim seancën.

I ftojme grupet parlamentare që për aq sa kanë mundësi t'i thërrasin deputetët e tyre ta bëjnë këtë gjë. Po presim nja dy-tre minuta dhe pastaj po vazhdojmë.

(Ndërprerje e incizimit)

Në ndërkohe edhe derisa të bashkohen 2 deputetë të tjerë, të cilët janë në një dëgjim publik dhe po kthehen në seancë.

Para se të kalojmë në pikën e fundit, meqenëse deputetët e nderuar u kthyen në seancë,

11. Votimi i raportit me rekomandime në lidhje me raportin e auditimit të performansës “Parandalimi dhe reagimi i situatave emergjente: Vërshimet”

Besoj që jemi 61 deputetë në sallë a po? Të votojmë për Shqyrtimi i raportit me rekomandime në lidhje me raportin e auditimit të performansës “Parandalimi dhe reagimi i situatave emergjente: Vërshimet”.

Ju lus që me ngritje dore që të deklaroheni për rekomandimet e komisionit.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Administrata më informon që të gjithë ata që kanë qenë të pranishëm, 61 deputetë kanë votuar për rekomandimet e komisionit, asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim. Kështu që konstatoj që me 61 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi i miratoi rekomandimet në lidhje me raportin e auditimit të performansës “Parandalimi dhe reagimi i situatave emergjente: Vërshimet”.

10. Votimi i raportit me rekomandime në lidhje me raportin e auditimit të performansës “Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave joqeveritare”

Po pra e kemi edhe pikën 10, e cila më herët ka mbetur për shkak të mungesë së kuorunit. E kemi pra votimin e rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur

me raportin me rekomandime në lidhje me raportin e auditimit të performansës “Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave joqeveritare”.

Ju ftoj që me ngritje të dorës të deklaroheni për këto rekomandime. Kush është për? Më thonë që të gjithë deputetë, pra 61, të gjithë ata që janë në sallë kanë votuar për këto rekomandime të komisionit.

Prandaj, konstatoj që këto rekomandime janë miratuar. Pra, me 61 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi i miratoi rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me *raportin me rekomandime në lidhje me raportin e auditimit të performansës “Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave joqeveritare”.*

Tash sa i përket pikës së fundit, dhe me këtë po e mbyllim seancën. Pika e fundit është:

12. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Ankesave të Mediave

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 29 shtator 2021, ka kërkuar nga grupet parlamentare që Kuvendit t’ia propozojnë kompletimin e këtij komisioni ad hoc, me deputetë për kryetar, për zëvendëskryetar, si dhe për anëtar të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 1 anëtar të Bordit të Ankesave të Mediave.

Deri më tash, Sekretari më njofton që vetëm dy grupe parlamentare i kanë propozuar përfaqësuesit e tyre në këtë komision ad hoc. Kurse tash kërkoj nga kryetarja e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, zonja Kusari-Lilam që të propozojë, në këtë rast, kryetarin, sepse këtë komision ad hoc e udhëheq Vetëvendosja, si dhe 4 anëtarë të tjerë nga ky grup parlamentar.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje propozoj për kryetar të komisionit ad hoc deputetin Fitim Uka, përderisa anëtarë të këtij komisioni janë deputetja Doarsa Kica, deputeti Njazi Isaku, deputeti Fitim Haziri dhe Arbëreshë Kryeziu-Hyseni.

KRYETARI: Hykmete Bajrami nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Lidhja Demokratike e Kosovës e ka 1 anëtar në këtë komision.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Ne për këtë Komision ad hoc e propozojmë deputetin Agim Veliun.

KRYETARI: Deputeti Agim Veliu. Nga Partia Demokratike, Hajdar Beqa apo Ariana Musliu-Shoshi. Po! Partia Demokratike i ka 2 anëtarë në këtë Komision ad hoc.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, kryetar!
Ne i propozojmë Mërgim Lushtakun dhe Floretë Zejnullahun.

KRYETARI: Lista serbe e ka propozuar deputetin Slavko Simiq për zëvendëskryetar të parë të këtij komisioni. Grupi Parlamentar i AAK-së e ka zëvendëskryetarin e dytë. A e keni emrin e tij. Urdhëroni zonja Bytyqi. E keni fjalën.

ALBANA BYTYQI: Faleminderit!
E kemi deputetin Shemsedin Dreshaj.

KRYETARI: Deputeti Shemsedin Dreshaj propozohet për zëvendëskryetar të dytë të këtij komisioni. Kurse Grupi Multietnik tashmë na ka njoftuar që e ka propozuar deputetin Fridon Lala për anëtar të komisionit, por dëshironi ta ndërroni a po?

Urdhëro, kryetar i grupit, zoti Kervan e ka fjalën.

ENIS KERVAN: Grupi Parlamentar Multietnik e zëvendëson zotin Fridon Lalën me deputetin Erxhan Galushi.

KRYETARI: Erxhan Galushi të jetë anëtar nga Grupi Parlamentar Multietnik.

Tani ta votojmë këtë Komision ad hoc, sepse jemi në sallë 61 deputetë. Ju lus që me ngritje dore... Po, lirisht deputeti Beqa. Kë e zëvendësoni me kë? Ju lutem në mënyrë zyrtare dhe me mikrofon.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, zoti kryetar!
Për shkak se zonja Zejnullahu është në agjendën e fushatës, është kandidate për kryetare të Komunës së Podujevës, Partia Demokratike e zëvendëson me Blerta Deliu-Kodra. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, në propozimet e Grupit Parlamentar të PDK-së, Floretë Zejnullahu të zëvendësohet me deputeten Blerta Deliu-Kodra. Dhe, me këtë përbërje... Hajdar, prit të votojmë, ku po shkon!

Sa deputetë i kemi në sallë, ju lutem?! 61 deputetë janë në sallë. Ju lus që me ngritje dore të deklaroheni për formimin e këtij Komisioni ad hoc.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Administrata më informon që të gjithë deputetët, pra 61 kanë votuar për. Kështu që, konstatoj që me 61 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e formoi Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 1 anëtar të Bordit të Ankesave të Mediave.

Ngarkohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 1 anëtar të Bordit të ankesave të mediave që të veprojë në përputhje me Ligjin nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Me këtë rast i mbyllim punimet e kësaj seance, e cila përfundoi. Mirupafshim në seancën e ardhshme!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë